



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
28 TETOR 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28. OKTOBRA 2010. GODINE

TETOR – OKTOBAR
2010

E enjte, më 28 tetor 2010, ora 10:00

Drejtën seancën: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Mirëmëngjesi! Po fillojmë. Mirë se keni ardhur!

Po fillojmë me pikën e parë:

1. Deklarime jashtë rendit të ditës

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, nuk është. Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pse sot dua ta ngrejë çështjen e Mitrovicës andej lumit Ibër, edhe pse kjo mund të tingëllojë si çështje e fushatës parazgjedhore, dua t'ju rikujtoj që kërkesa për ngritje të kësaj çështje është bërë më herët dhe duke qenë se Mitrovica andej Lumit Ibër do të ishte çështja e fundit që unë do të luajtsha me ndjenjat e mitrovicasve sot. Ka kohë që është mirëpritur me shumë shpresë nga mitrovicasit e asaj ane që Zyra e BE-së në Prishtinë ka filluar formulimin e strategjisë për veprimet e koordinuara në veri të Kosovës. Objektivat e qarta të kësaj strategjia janë: që Qeveria e Kosovës me mbështetësit e saj ndërkombëtarë do të krijojë një komunë të re në Mitrovicën e veriut nëpërmes zgjedhjeve nga mesi i vitit 2010, që qeveria e Kosovës do të mbajë zgjedhjet e saj komunale në tri komunat brenda këtij viti. Është paraparë që institucionet paralele të marginalizohen, si dhe EULEX-i të rritë praninë e tij në tërë Kosovën në veri për të forcuar në masë të madhe sundimin e ligjit me gjykatat më efektive, policinë e doganat. Po, sa nga këto objektivat e strategjisë u arritën, deputetë të nderuar. Natyrisht, fare pak, nëse mund të thuhet - fare pak. Fatkeqësisht, ne jemi duke u marrë me vetveten mu atëherë ku këto objektiva kërkojnë përqendrimin maksimal të koalicionit qeveritar për realizimin e tyre.

Çështja e gjykatave në Mitrovicë të veriut është mbi të gjitha çështje e të drejtave të njeriut. Ajo që është evidente që për funksionimin e gjykatës në Mitrovicë janë gjetur mjaftë gjyqtarë të kualifikuar serbë, por të cilët u lejuan fatkeqësisht të jenë objekt të kërcënimeve dhe frikësimeve nga elementet kriminale në veri. Këto elemente kriminale dita – ditës po e vështirësojnë jetën e qytetarëve në veri, pavarësisht përkatësisë së tyre. Edhe pse qysh nga marsi i këtij viti zoti Kermabo, së bashku me ambasadorin Italian, zotin Xhifoni, prematuan se do të sjellin urgjentisht gjyqtarët serbë dhe shqiptarë për funksionimin e gjykatës, deri më sot s'kemi asnjë hap përpara në këtë drejtim. Nga mos funksionimi i gjykatës në Mitrovicën andej Lumit Ibër, janë më së 20 mijë lëndë të pazgjidhura që shumë po e afektojnë jetën e qytetarëve, kurse është fare e paqartë, sepse gjyqtarët e mandatuar shqiptarë nga ish presidenti i vendit janë ende në pritje të detyrës nga ana e EULEX-it.

Kërcënim tjetër për mitrovicasit janë matrapazët tanë, që me çdo kusht po insistojnë dhe ndërmjetësojnë në shitjen e pronave të mitrovicasve me çdo kusht. Duhet shprehur admirimin për shumë familje të asaj ane, si ajo familja Mripa ...

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën. Në emrin tënd, apo në emër të grupit, Shkumbin? Mirë, ty të erdh rendi. Urdhëro!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e kam kërkuar ta marrë fjalën para dy javësh, sepse para dy javësh kemi pasur diçka tjetër në rend të ditës. Kam dashur t'i tregoj koalicionit edhe deputetëve që mos të nguten atë ditë për të votuar ose për t'i

shkaktuar dëm kaq të madh Kosovës, sepse kryeministri i Kosovës ka qenë i dehur, ka qenë i posa i kthyer nga Peja, ku e kemi parë të gjithë duke pirë birra, po e kanë mashtrua atje, i kanë dhënë birrë me konzervans shumë, nuk ka ditë cilën birrë po e pinë edhe ka ardhur i dehur në Kuvendin e Kosovës dhe sot dihet ku jemi si Kosovë, ku jemi me institucione, çfarë krize i kemi bërë. Ka shkuar te miqtë e zotit Haradinaj, të cilët me fushatë ka bërë paraprakisht, se ka thënë janë udbashë më herët dhe këta janë udbashët e Ramushit, po kur Ramushi shkoi në Hagë, deshi t'ia marrë ata miq, të mirë apo të këqij. Është fjala për Ekrem Llukën dhe zotin Kelmendi, Ramizin. Iu bënë shumë të mirë Hashimit mbasi shkoi Ramushi, që t'i fusë edhe atë në thesin e vet, duke dashur t'ia grabis ata miq. Kështu që, dihet mirëfilli se zoti Gërxhaliu, që është kryetar i Odës Ekonomike, nuk i ka besuar vetë dhëndrit të tij, zotit Hashim Thaçi, kryeministër i Kosovës, thoshte se Ramush Haradinaj po do ta bëjë Ramiz Kelmendin kryetar të Odës. Do të thotë, vetë dhëndrit nuk i besonte, po sa duhet t'i besojnë qytetarët. E dinë mirëfilli si ka shkuar. Ka shkuar te organizatat e veteranëve dhe invalidëve të luftës, e kanë mirëpritur se atje janë burra, po duhet ta dijë se zoti Haradinaj, kur ka hyrë për t'i vizituar këto shoqata, ka filluar prej Prekazit, prej Drenicës edhe e ka përshkuar tërë Kosovën, jo vetëm formalisht për të kërkuar vota. Po, në Kuvend e kemi Projektligjin për vlerat e luftës, për familjet e të zhdukurve dhe të gjithë dhe kjo qeveri ka thënë që jemi të gatshëm ta implementojmë nga 1 janari i vitit 2011. Personalisht, po edhe Grupi Parlamentar jemi të gatshëm që sot ta votojmë atë projektligj, ta vërtetojmë se a mundet zoti Thaçi dhe Qeveria e tij ta implementojë nga kjo datë. Por, po shihet se pas prishjes së këtij koalicionit, është e vetmja Qeveri në botë që sot kërkon ta shkarkojë vetveten. Këtë e kemi thënë si grup më herët, do të thotë e vetmja Qeveri në botë që sot kërkon ta shkarkojë vetveten. Po të japë përgjegjësi para qytetarit, do ta ndëshkojë këtë qeverisje, qeverisje të keqe që ka për t'u mbajtur në mend sa i ka kushtuar këtij populli. Mirëpo, desha t'i them se askush në Kosovë nuk ka për ta vlerësuar pozitivisht, as ato familje në të cilat thirrmi se kemi bërë diçka për ta, po ta shohim se si po shkon rrjedha në të ardhmen...

KRYETARI: Faleminderit!

I kisha lutur deputetë në vazhdim që vërtet ta lexojnë nenin e Rregullores së Kuvendit, e cila flet për çka bëhet fjalë, pse është futur kjo pikë e rendit të ditës, se nuk është mirë të keqpërdoret as Kuvendi, as foltorja. Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën, nuk është.

Deputeti Ismail Kurteshi.

ISMAIL KURTESHI: Përshëndetje, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët dhe Kabinetin qeveritar!

Unë sot desha ta rikthej edhe një herë këtu këtë çështjen e votimit të Strategjisë për privatizimin e postës dhe dilemës se a ka kaluar apo nuk ka kaluar ai votim. Për ta sqaruar këtë çështje, unë vetëm po e lexoj nenin 51 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku thuhet se Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit dhe në pikën 2 thuhet se prania e deputetëve në mbledhje verifikohet me sistem elektronik të votimit, me ngritje të dorës ose me thirrje të emrave. Kur është votuar për strategjinë, as nuk ka pasur ngritje të dorës dhe as nuk janë thirrur emrat, kurse bazuar në shënimet elektronike të cilat ne i kemi në duart tona, del se në momentin kur është votuar, në Kuvend kanë marrë pjesë, në punët e Kuvendit kanë marrë pjesë vetëm 50 deputetë. Pra, të gjitha këto fakte argumentojnë se votimi për Strategjinë e privatizimit të PTK-së nuk ka kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet, por po them, po thua diçka që s'është e vërtetë. Në sallë kanë qenë hiq më pak se 80 deputetë dhe e di mirë si bëhet prezenca e deputetëve në sallë. E keni sqarimin për këtë çështje, nuk është mirë ta keqpërdorni mikrofonin. Vazhdojmë. Dirata Maliqi e ka fjalën.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Kolegë deputetë, jemi dëshmitarë të krizës së thellë politike institucionale dhe të kolapsit total që kjo Qeveri e solli në vendin tonë. Dëgjojmë akuza të partnerëve ende të padivorcuar politikisht se korrupsioni e shkatërroi vendin tonë, se ky ose ai ministër i bllokoi 15 njohje. Çfarë ironie dhe mjerimi politik! Ku mbetën 100 njohje dhe për 100 ditë? Ku mbetën premtimet tani qesharake, por edhe tragjike të këtyre qeveritarëve ende të padivorcuar de jure? Kërcënimi i fjalës së lirë dhe rangimi si vendi më i korruptuar në kontinent, janë rendgeni i qeverisjes suaj. Këtë e thanë organizatat më prestigjioze ndërkombëtare. Andaj, bëjeni një akt moral, ju lutem, largohuni nga qeverisja dhe kërkonj falje qytetarit të Kosovës! Ju faleminderit, sidomos ju koleget e mia, urdhëroni, e keni rastin! Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputeti Naim Rustemi e ka fjalën.

DRITON TALI: A bën në emër të tij?

KRYETARI: Jo. Deputeti Mark Krasniqi e ka fjalën.
Regjia, fjalën deputetit Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, deputetë!

Përsëritje, për të gjithë!

Ne po bisedojmë këtu përditë edhe njëri - tjetrin po i përsërisim për gjëra të tjera, mirëpo edhe kur përsëritet, domethënë se ky është një problem me të cilin duhet të merret ky Parlament me seriozitet. Unë këtu po përmend vetëm në mënyrë telegrafike, sepse 3 minuta janë shumë pak për të thënë diçka për të shkoqitur, po them, problemin. Sovraniteti i Kosovës nuk është i plotë, madje e kemi vetëm në letër. Strukturat paralele, xhandarmeria serbe e shkel çdo ditë kufirin e Kosovës dhe i maltretojnë shqiptarët në rrethin e Kamenicës. Veriu i Mitrovicës është harruar këtu, sepse i kemi interesat partiake dhe personale më tepër se sa interesin e Kosovës. Eksterritorialiteti është domethënë heqje dorë nga pjesë e territorit të Kosovës dhe dhënia tjetërkujt që ta administrojë dhe ta shfrytëzojë si të dojë. Këto janë gjëra që nuk duhet t'i pranojmë në asnjë mënyrë, pa marrë parasysh a na imponon faktori ndërkombëtar a jo. Kur është interesi i Kosovës, i territorit, i sovranitetit, aty nuk duhet të pranojë askush asnjë gjë. Madje, këto gjëra duhet t'i vendosë Parlamenti e jo Qeveria.

Mandej, zonat mbrojtëse dhe këto të tjerat janë elemente të cilat janë si kancer në trupin shtetëror tonin. Lufta për interesa personale i ka mbuluar, i ka qitur në harresë interesat e shoqërisë edhe interesat e Kosovës, si shtet i pavarur. Të drejtat e barabarta, unë po them këtu çka flitet të një popull, të drejtat e barabarta duhet të jenë të barabarta për të gjitha komunitetet, jo vetëm për komunitetin serbë. Ne jemi për komunitetin serbë dhe për të gjithë që t'i kenë të drejtat maksimale të Evropës Perëndimore, por jo edhe të kemi dallime shumë të mëdha në mes të drejtave të komuniteteve tjera.

Mandej, regjistrimi i popullsisë është një gjë shumë, me shumë interes për Kosovën dhe për çdo shtet. Krejt është harruar. I kemi regjistrimet partiake, para së gjithash, edhe regjistrimet tjera, kuvendet e tjera, e kemi harruar një gjë që është esenciale për çdo degë të jetës, për çdo fushë të jetës sonë që e kemi këtu. Që 30 vjet nuk është bërë regjistrimi këtu.

Mandej, lufta kundër korrupsionit. Këtu po thuhet 100 herë - zero tolerancë për korrupsion, por unë kisha për t'ia shtuar - zero sukses për këtë luftë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Unë do ta shfrytëzoj rastin që edhe në emër tim, edhe në emër të deputetëve tju uroj 90 – vjetorin e lindjes!

(Duartrokitje)

Fjalën e ka deputeti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

Ne edhe më herët kemi ngritur një qetësim për rindërtimin e 44 shtëpive, që është bërë një memorandum i rrejshëm që është nënshkruar nga dy ministritë Rashiq. Ai memorandum është nënshkruar në vitin 2008 dhe vlera e atij memorandum ka qenë deri në 440 mijë euro. Prej asaj dite, edhe pse është nënshkrua ai memorandum, kanë ardhur i kanë vizituar komunitetet dhe faktikisht kanë luajtur me fatin e tyre dhe asnjëherë ai projekt nuk ka filluar që të bëhet rindërtimi i tyre. Ne kërkojmë që këto memorandume të rrejshme të mos përsëriten edhe në vitet e ardhshme, sepse e dini që tash në këtë kohë dimërore, edhe pse ndoshta ka mundësi të ndahen ato mjete prej 440 mijë euro, ne e dimë që nuk ... edhe vlerën. Por, Grupi i SLS-së këtë marrëveshje e ka nënshkruar vetëm që t'i shfrytëzon dy deputetë nga radhët PDAK-së, që 3 vite me radhë i ka shfrytëzuar për qëllimet e veta e jo në dobi të komunitetit ashkali, sepse këta dy deputetë i kanë votuar pjesëtarët e komunitetit ashkali e jo nga komuniteti serb. Prandaj, kërkojmë që këto gjëra të mos përsëriten, por gjithë çka dua ta ngrejë një shqetësim, sepse tash jemi në një sezon dimëror dhe ne kërkojmë nga Qeveria që na mbështet, ato shtëpi të cilat janë rindërtuar nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, ne e dimë që ato janë ndërtuar me buxhet të Republikës së Kosovës dhe ne jemi të njoftuar në shumë fshatra, ato shtëpi janë të zbrazëta, kurse në këtë sezon dimëror kërkojmë nga Qeveria që na mbështet, ato shtëpi t'i shfrytëzojë komuniteti ashkali përderisa të kalojë ky sezon dimëror, sepse me të vërtetë ky dimër do të jetë i përballeshëm për këta. Nuk e them në aspektin e uzurpimit të këtyre shtëpive që i ka rindërtuar komuniteti serb që 3 vite apo 4 vite, ato shtëpi janë rindërtuar, edhe një herë po e theksoj, nga buxheti i Republikës së Kosovës, por janë të zbrazëta në shumë fshatra. Ne edhe një herë e përsërisim, kërkojmë që në këtë sezon dimëror prej 4 muajve apo 5 muajve në ato shtëpi të vendosen, edhe pse nuk janë rindërtuar për komunitetin ashkali, romë, egjiptas, të vendosen ato familje të varfra e jo ato të mbesin ...të hapura ato shtëpi që 4 – 5 vite të mbesin pa asnjë njeri, të cilat janë rindërtuar. Ky është një shqetësim i qytetarëve, edhe pse këtu është i njoftuar i gjithë opinionin, sepse asgjë deri më tani nuk është bërë për komunitetin shkallë, sidomos sa i përket rindërtimit të shtëpive.

Dua ta ngrejë edhe një qetësim. Është Ligji për vetëqeverisje lokale, edhe këtu dëmtohen komunitetet ashkali, romë dhe egjiptas. Këtu është menduar vetëm për komunitetin serb, 10% aty shkruan, sepse do të jetë për ato komunitete që janë deri në 10%, kanë të drejtë të sigurojnë zëvendëskryesuesin nëpër komuna. Kjo në asnjë komunë nuk mund të realizohet, vetëm në komunën e Graçanicës, nëpër ato komuna...

KRYETARI: Faleminderit! Drita Kadriu e ka fjalën.

DRITA KADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Në fillim, desha një çështje ta theksoj rreth shfrytëzimit të mikrofonit për bartje në Kuvend të thashë e thënave, vërtet nuk i bën nder.

Çështjen të cilën unë do ta ngrejë se përkundër situatës politike në të cilën jemi, ne po vazhdojmë me detyrat tona dhe obligimet e rregullta dhe ajo që do të ngrejë sot është çështja për gjendjen e organizimit të sistemit shëndetësor sekondar në komunën e Mitrovicës. Me qenë se ka pasur një investim nga donatorët norvegjez në ndërtimin dhe meremetimin e 10 mijë metrave katrorë hapësirë, ndërsa Qeveria ka investuar 5 milionë euro pajisje moderne shëndetësore, këto hapësira të shëndetësisë sekondare nuk mund të funksionojnë për shkak të mungesës së madhe të kuadrit profesional, mjekë specialistë si dhe të kuadrit të

mesëm. Po dashur të flas për investime, në emër të punëtorëve shëndetësorë, të qytetarëve të Mitrovicës, të strukturave komunale të komunës së Skenderajt, Vushtrisë dhe Mitrovicës, të cilët e kanë mbështetur këtë kërkesë, si dhe në emër të deputetëve që gjenden në Kuvendin e Kosovës nga komuna e Skenderajt dhe Mitrovicës, e ngrejë këtë çështje me qëllim të marrjes së masave për ta bërë funksionalizimin e shërbimit dytësor shëndetësor në Mitrovicë. Arsyeja e mungesës së madhe të mjekëve specialistë, si dhe të kuadrit të mesëm është se deri më tani shërbime dytësore sekondare janë marrë në Qendrën kryesore të Mjekësisë Familjare në Mitrovicë.

Në takimin e organizuar në Mitrovicë më 14 shtator, janë paraqitur shifra të krahasueshme të shërbimeve sekondare të qendrave tjera të Kosovës si për buxhetin për mallra dhe shpenzime, ashtu edhe për nga numri i punëtorëve. Prandaj, besoj thellë që këto kërkesa nga Mitrovica do të trajtohen me prioritet, ashtu siç është rasti urgjent dhe i një rëndësie të lartë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Emrush Xhemajli, e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje, të gjithëve!

Më datën 14.10.2010, 5 subjekte politike: ADK, Partia Socialiste, Partia Social Demokrate, Bashkimi Demokratik dhe SDA i është drejtuar me shkrim Grupit Punues për Zgjedhje dhe kryetares së këtij grupi, që njëherësh është edhe kryetare e Këshillit Qendror Zgjedhor, me kërkesë dhe arsyetim të propozimit të tyre. Këtu nuk është fjala për çfarë propozimi, është fjala për shqyrtimin e kërkesës, megjithëse shqyrtimi i kërkesës dhe arsyetimi i saj ka qenë dashur të bëhet, për shkaqe të panjohura nuk është dhënë fare për shqyrtim atje më datën 21 dhjetor, atëherë kur është mbajtur mbledhja e grupit punues. Po, dihet që 5 subjektet politike që kanë adresua shkresa, janë subjekte politike të regjistruara në KQZ, kanë këmbim zyrtar të shkresave dhe të gjitha këto kanë 5 deputetë në Kuvendin e Kosovës. Është e qartë se zonja Valdete Daka është përgjegjëse pse është fshehur shkresa zyrtare e lartcekur, edhe pse ajo direkt nuk mund ta ketë fshehur, absolutisht nuk mund të përjashtohet prej kësaj përgjegjësie. Tash, pas kësaj, a mundet dikush të thotë që t'i besojmë se KQZ-ja me këtë formë të fshehjes së dokumenteve mund të jetë një organ që duhet t'i besohet për zgjedhjet e ardhshme, kështu që kisha për të thënë ushtruesi i detyrës i kryetarit të Kosovës duhet ta shikoj këtë çështje seriozisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Samaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryetar,

Të nderuar zotëri kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra dhe deputetë,

Kam qenë, jam dhe do të jem për institucione permanente, efikase, eficiente. Nuk do të isha angazhuar asnjëherë për shpartallimin qoftë të Qeverisë, qoftë të Kuvendit. Jam për ta qortuar, për ta kritikuar, po gjithmonë bona fidej, apo jo, e kësisoj. Në këtë rast e adresoj një kritikë të singertë, së paku kështu e konsideroj vet. Ekziston ndër të tjera një dispozitë e Ligjit të marrëdhënies së punës, ku thuhet ndër të tjera se nëse një pastrues, nëse një postier, nëse një nëpunës i kategorisë së parë do për ta braktisur marrëdhënien e punës, duhet ta lajmërojë eprorin, duhet të qëndrojë në punë aq sa është përcaktuar, minimalisht është një muaj ditë, ju lutem. Unë e qortoq me sinjeritet Lidhjen Demokratike të Kosovës që i tërhoq ministrat në mënyrë të paparë. Më ka interesuar kështu teoria dhe praktika parlamentare, nuk kam parë precedencë të tillë, ju lutem. Mund të ndodhë, mirëpo duhet t'i kryej punët, duhet se ka përgjegjësi, ajo është përgjegjësi majore, nuk është përgjegjësi minore. Prandaj, ju lutem, në këtë rast angazhohem edhe për një aksentim, që mos të angazhohemi për zgjedhje të ashtuquajtura të jashtëzakonshme,

kushtetuta si njeht ato, ai është një konstruksion arbitrar, po të bëjmë çmos t'i përgatisim si duhet, sepse garantojnë legjitimitet dhe legalitet të Kuvendit të ardhshëm edhe të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ibrahim Gashi e ka fjalën.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht që në vazhden e asaj që e tha profesor Smaka, edhe unë do të vazhdoj. Grupi Pasrlamentar i AKR-së ndjen një përgjegjësi institucionale që t'i thotë gjërat në institucionin më të lartë përfaqësues të vendit për situatën e krijuar në vend. Natyrisht, kjo ka terma të ndryshëm si krizë politike, si krizë institucionale, po e vërteta është se institucionet e Kosovës, të shtetit më të ri në Evropë kanë shkaktuar një shqetësim të opinionit i gjerë. Natyrisht, në praktikën e vendeve me demokraci të konsoliduar rëniet të qeverisë, zgjedhjet e parakohshme, të jashtëzakonshme janë praktika që kanë ndodhur shpesh dhe tash janë bërë të zakonshme po thuaj, përderisa për qytetarët e Kosovës situata e krijuar në vend nuk është e zakonshme, definitivisht është shqetësuese dhe, mbi të gjitha, përgjegjësia për këtë adresohet tek ne këtu, përkatësisht te institucionet që kanë derivuar prej këtij Kuvendi, e që janë Qeveria, përkatësisht me mekanizmat e vet ekzekutive.

Unë dua të nënvizoj disa fakte që shpeshherë na bëhen pyetje në opinion dhe nuk dimë t'u japim përgjigje. Nuk dimë të japim përgjigje në kuptimin e asaj që kjo krizë institucionale Kosovës nuk iu ka dashur dhe sigurisht që Kosova ka tash shumë pikëpyetje para veti.

Unë po i përmendi vetëm disa. Për shembull, janë bisedimet e paralajmëruara me Serbinë. Ne nuk e dimë se çfarë formati të bisedimeve do të kemi dhe a kanë legjitimitet institucionet e Kosovës për të hyrë në këto bisedime në një situatë të krijuar në vend.

Nën dy, janë deklaratat e zyrtarëve të lartë të partisë në pushtet lidhur me projektbuxhetin. Disa thonë që ka krizë të mos kalojë në këtë situatë, disa thonë që do të kalojë. Pastaj, edhe deklaratat jo shumë të sigurta të partnerëve të koalicionit se ne nuk do ta pengojmë kalimin e projektbuxhetit.

Pastaj, është çështja e shumë përfolur, përkatësisht shumë e aktualizuar me apo pa qëllim, çështja e privatizimit të Postë - Telekomit. Një çështje që e dimë gjithë ashikare që duhet të kalojë në këtë apo në legjislaturën e ardhshme për arsyet që, po ashtu, i dimë.

Është edhe diçka tjetër që është shumë shqetësuese për vendin, sepse vendi ka hyrë në një proces, si të them, të ndërkombëtarizimit të statusit të vet, në procesin e përafrimit me strukturat e BE-së dhe ato euroatlantike dhe si hap i parë në këtë proces është çështja e liberalizimit të vizave. Është shqetësuese që ne me premtimet që i kishim se në shtator do ta marrim strategjinë për përafrim në këtë proces, përgjigja ishte negative nga Brukseli dhe për këtë sikur situata e krijuar në vend e qet në plan të dytë përgjegjësinë që dikush e ka për këtë, domethënë për këtë ngecje.

Është edhe çështja tjetër që vendi ...

KRYETARI: Edhe dy minuta, se në emër të Grupit është duke folur.

IBRAHIM GASHI: ...është edhe çështja tjetër shumë e diskutueshme, a po shkon vendi drejt një vakuumi institucional dhe kjo do të provohet me ditët në vijim. Ne kemi një presidencë, institucionin më të lartë të vendit me ushtrues detyre, kemi një parlament, i cili është i diskutueshëm se a mund të krijojë shumicën për të marrë vendime për projektligjet që janë bazike në fund të vitit dhe që i kemi përpara dhe e kemi një qeveri, e cila është gjysmë qeveri, me 6 resorë jo funksionalë. Përballë kësaj situatë, lus kolegët deputetë që të reflektojmë në mënyrën më të përgjegjshme të mundshme që të dalim prej kësaj situatë. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe diskutuesi i fundit për sot, Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti president,

Të nderuar qytetarë të Kosovës dhe ju të pranishëm në këtë sallë,

Sot dua të kërkoj ndihmë nga të gjithë ju për kryeministrin e Kosovës, zotin Hashim Thaçi, i cili në seancën e fundit parlamentare premtoi se luftën kundër korrupsionit do ta zbres edhe në Kuvend. Ju lutem t'i ndihmojmë zotit kryeministrit në këtë drejtim, sepse ashtu siç tha zoti kryeministër, ka dyshime të bazuara që Kuvendi të jetë i korruptuar, ka shumë dyshime, duke filluar nga anëtarët e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, për të vazhduar te një numër i madh i deputetëve, të cilët dyshohet se janë të involvuar në krim dhe korrupsion. Bile, mos të futen në rend të ditës të mocionit për garancionin bankar të Kosmocellit prej 16.200.000 eurove, që vërteton edhe më shumë dyshimin. Andaj, t'i ndihmojmë zotit kryeministër që ta pastrojë Kuvendin nga të gjithë të korruptuarit, kushdo qofshin ata, duke filluar pra nga kryekuvendari, nga Kryesia e deri te deputeti i fundit. T'i ndihmojmë zotit kryeministrit, sepse nëse zoti kryeministër nuk pati hesap, nëse zoti kryeministër nuk pati llogari që ta luftojë korrupsionin në kabinetin e tij qeveritar, zotit kryeministër kurrë nuk do t'i kushtojë që ta luftojë korrupsionin në Kuvend, sepse edhe ashtu më shumë e gjysma e deputetëve të tanishëm me siguri nuk do të jenë në legjislacionin e ardhshëm, andaj edhe s'do të ketë ndonjë siklet zoti kryeministër për ta luftuar korrupsionin në Kuvend. Por, do të fitonte Kosova, nëse në asnjë aspekt jo, atëherë të paktën në imazh, ngase do të merrej si një fakt që më në fund diku në Kosovë po fillohet të luftohet korrupsioni dhe ndoshta Transparent Internacional vitin e ardhshëm do t'ia përmirësojë vendin Kosovës në ranglistën e vendeve më të korruptuara të botës, të paktën do ta listojë Kosovën me vendet e rajonit dhe jo siç e ka ranguar bashkë me vendet më diktatoriale të Azisë, të Amerikës Jugore dhe të Afrikës.

Të nderuar, ju lutem t'i ndihmojmë zotit kryeministrit, sepse zoti kryeministër ka mbetur i vetmuar në luftën kundër korrupsionit, ka mbetur komandat pa ushtri. Madje, zotin kryeministër në këtë luftë e ka braktisur edhe klubi i pensionistëve nga Brukseli, i njohur ndryshe me nofkën EULEX. Prandaj, të mblidhemi së bashku dhe t'i ndihmojmë zotit kryeministër, sepse ka nevojë për ndihmë tash o kurrë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Për seancën e radhës kanë mbetur: Sanije Aliaj, Gani Geci, Donika Kadaj dhe Gjylnaze Sylaj. Ky i fundit nuk pranohet, se është lajmëruar vonë. Jo, të fundit s'e përmenda, Naim Rrustemi ka qenë i fundit.

Deklaratë e bashkëngjitur

SANIJE ALIAJ: Deputetë të nderuar,

Më lejoni qe me këtë rast të prezantoj para jush angazhimin 10 vjeçar profesional dhe shkencor të profesorit shumë të respektuar gjerman Heinrich Oettel nga Universiteti Teknik i Freiberg-ut për përparimin e shkencës kosovare dhe ngritjen profesionale të kuadrove të reja të Universitetit të Prishtinës. Universiteti i Prishtinës prej vitit 2000 ka bashkëpunim aktiv ndërkombëtar me një Universitet gjerman – Technische Universität Bergakademie Freiberg. Ky bashkëpunim realizohet në kuadër të Rrjetit të Bashkëpunimit “Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve”, anëtar i së cilës është Universiteti i Prishtinës dhe Universitete tjera shqipfolëse të rajonit. Koordinator i këtij rrjeti të bashkëpunimit është profesori Heinrich Oettel, i cili me përkushtimin dhe angazhimin e vet profesional dhe shkencor ka arritur këto rezultate:

Qëndrime në Gjermani:

- 32 studentë kanë qëndruar në Freiberg dhe Mulheim an der Ruhr për punim diplome të nivelit Bachelor me diku rreth 6400 orë pune për udhëheqje;
- 86 studentë nga niveli Bachelor dhe ai pasuniversitar kanë qëndruar në Freiberg për praktika profesionale me rreth 540 orë mësim;
- 15 studentë kanë qëndruar në Freiberg për kualifikime pasuniversitare (disa prej tyre më shumë se një herë);
- 16 mësimdhënës Universitar kanë qëndruar në Freiberg për kualifikime dhe bashkëpunim;

Organizime në Rajon:

- 4 disertacione dhe 7 magjistratura të përmbyllura bashkërisht;
- 11 ligjërata të mysafirëve me përafërsisht 500 orë mësim;
- 10 Workshope me tema për shkollim dhe bashkëpunim të kuadrit Universitar;
- 7 shkolla verore me kohëzgjatje nga 2 javë – pjesëmarrës mbi 150 studentë;
- 6 simpoziume “Materialet dhe përdorimi i tyre” – mbi 400 pjesëmarrës;
- Investime materiale
- 50,000 euro mjete nga DAAD për pajisje laboratorike, libra, kompjuter, etj;
- Prof. Oettel si udhëheqës i projektit për themelimin e Laboratorit Qendror, me angazhimin e tij ka siguruar rreth 450,000 euro për këtë laborator – financim i Konferencës së Rektorëve të Evropës.

Ky informacion i është ofruar Kuvendit të Republikës së Kosovës, në radhë të parë për të falënderuar Universitetin Teknik të Frajberg-ut, e në veçanti prof. Heinrich Oettel, për mundësinë e ofruar në ngritjen profesionale dhe shkencore të studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Shembulli i Universitetit të Frajberg-ut dhe prof. Heinrich Oettel, të ndiqet edhe nga Universitetet tjera Evropiane për t'i ndihmuar studentët e Republikës së Kosovës, në ngritjen e tyre profesionale.

Ju falënderojmë prof. Heinrich Oettel!

RYETARI: Koha për deklarime të lira përfundoi. Vazhdojmë me pikën e dytë të ngjashme.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputet, do ta lexosh pyetjen?

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qeveria e Kosovës është duke punuar me përkushtim që t'ju krijojë hapësira të mjaftueshme shkollore, sportive dhe ambient të pastër sipas standardeve ndërkombëtare për zhvillim normal të procesit arsimor me qëllim të avancimit të procesit edukativo arsimor. Pyetja ime është: Duke marrë parasysh investimet që po ndodhin në arsim, sa është duke u punuar me ngritjen e cilësisë në nivel më të lartë dhe në çfarë mase janë pajisur shkollat tona në të gjitha nivelet me pajisje moderne, teknologji informative dhe laboratorë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ismail Kurteshi, pyetje për ministren Justina Shiroka Pula.

Regjia, fjalën deputetit Ismail Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryetar!

Pyetjen po e lexoj, se ministrja nuk është këtu që disa herë, kurse këtu e kemi përfaqësuesin e Qeverisë, kryeministrin, i cili edhe ashtu ka deklaruar se do t'iu përgjigjet të gjitha pyetjeve.

Zonja ministre,

Ju keni konstatuar se bazuar në nenin 121 të Kushtetutës së Kosovës, privatizimi i boksive të Kosovës paraqet shkelje të Kushtetutës, pasi që minierat kur nuk kanë qenë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Ju po ashtu e keni njoftuar opinion se për këtë shkelje shumë serioze ia keni tërhequr vërejtjen AKP-së, keni njoftuar kryeministrin dhe Parlamentin e Kosovës.

Zonja ministre,

Cili është efekti i reagimeve të juaja, a keni marrë përgjigje nga AKP-ja, kryeministri dhe Kuvendi, a është ndërprerë procesi i privatizimit? Nëse procesi i privatizimit nuk është ndërprerë, cilët janë hapat e mëtejshëm që ju si ministri, por edhe Qeveria do t'i ndërmarrë në pengimin e këtij privatizimi antikushtetues? Çka mund të bëjë Kuvendi në pengimin e këtij privatizimi antikushtetues? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ministrja nuk është këtu, nuk ka interesim nga qeveria të përgjigjen.

Vazhdojmë. Deputeti Ismail Kurteshi, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Ministri nuk është këtu, mund ta bëni pyetjen.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër,

AKP i ka filluar procedurat e privatizimit të boksive të Kosovës bazuar në ligjin se i mundëson AKP-së privatizimin apo likuidimin e ndërmarrjeve shoqërore, por resurset minerale asnjëherë nuk

kanë qenë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Neni 121 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës lejon vetëm dhënien në koncesion të minierave, por nuk lejon shitjen e tyre.

Zoti ministër,

Cilat janë hapat që ka ndërmarrë ministria e juaj ose qeveria për pengimin e shkeljes së Kushtetutës nga agjenti i juaj, AKP?

Zoti ministër, Sindikata e Amortizatorëve kanë deklaruar se amortizatorët kanë shkuar në shitje me shumë defekte procedurale, se janë avulluar 65 mijë metra katrorë, gjegjësisht 4 kate të ish Bankës së Lublanës në Prishtinë dhe zyrat e përfaqësive në Beograd, kurse ju, zoti ministër, i keni filluar procedurat e privatizimit të PTK-së para se ta merrni dritën e gjelbër nga Kuvendi. Edhe kjo është padyshim shkelje e rëndë e Kushtetutës, si e arsyetoni këtë veprim dhe shkeljet tjera gjatë privatizimit? Ju faleminderit!

KRYETARI: Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Driton, doni ta bëni pyetjen?

DRITON TALI: Zoti president, unë pyetjen e kam bërë edhe për kryeministrin, nëse kryeministri është në disponim të përgjigjet, me dëshirë do t'ia bëja. Ka qenë në origjinal për kryeministrin apo ministrin Ahmet Shala, se ka të bëjë me pensionistët. A mund t'ia bëjë pyetjen kryeministrit?

KRYETARI: Unë e pash vetëm emrin e fundit, po qenka, mund t'ia bësh pyetjen edhe kryeministrit.

DRITON TALI: Faleminderit!

Pyetja ka të bëjë, zoti kryeministër, me 60 mijë pensionistët, për të cilët gjatë fushatës të vitit 2007 patët premtuar se do të bëni çmos për t'u kthyer pensionet e tyre të cilët i mori Serbia. Pyetja është: Çfarë ka bërë Qeveria Thaçi për kthimin e pensioneve të mbi 60 mijë pensionistëve, të cilët kontribuan në ish Jugosllavi, apo mbase po pritni apo keni pritur që nëna natyrë ta zgjidh problemin e tyre, se edhe ashtu kemi të bëjmë me pleq. Keni bërë diçka konkretisht apo veç, po them edhe një herë, keni pritur që nëna natyrë ta zgjidh atë problem, apo ka qenë një prej atyre farë premtimeve të juaja të shumta që nuk i realizuat. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, keni përgjigje për këtë pyetje?

Vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Doni ta lexua pyetjen, deputet.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryetar,

Me qenë se zotëri Shala nuk është këtu, s'po e shoh të arsyeshme që ta ngrejë pyetjen dhe në këtë kontekst, ju lutem, për hir të klimës që është, që nuk mund të pritet ndonjë përgjigje kualitative, edhe një pyetje e kam, e tërhiq tash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pyetjen e ke pasur për ministrin Bajram Rexhepi.

Kalojmë në pyetjen e fundit, deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Ministri s'është këtu, mund ta bëni pyetjen.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Mbase prej fillimit të mandatit e deri në përfundim të mandatit asnjëherë Qeveria nuk arriti të jetë komplet këtu për të qenë llogaridhënëse, t'ju përgjigj pyetjeve të deputetëve. Prandaj, ftoj kryeministrit t'i përgjigjet pyetjes sime, të tregojë se ka një Qeveri "të përgjegjshme".

Pyetja ime ka të bëjë me realizimin e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës në Maqedoni, të cilët kanë vështirësi të mëdha në realizimin e këtyre të drejtave dhe të cilët po shpenzojnë shuma të konsiderueshme të parave, energji dhe kohë për t'i realizuar këto të drejta dhe kjo bëhet gjithnjë në mënyrë individuale. Me qenë se është përgjegjësi e Qeverisë që të kujdeset për qytetarët dhe të mundësojë realizimin e të drejtave të qytetarëve të Kosovës që kanë punuar në Republikën e Maqedonisë, unë e pyes kryeministrin, në mungesë të ministrit Rashiq, se çfarë ka bërë Qeveria që të mundësojë realizimin e të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës që të marrin pensionet nga Republika e Maqedonisë? Faleminderit!

KRYETARI: Pyetja ka qenë e adresuar për ministrin Rashiq. Kryeministri nuk është i gatshëm të përgjigjet edhe pyetja nuk i është drejtuar.

Pyetja e fundit, deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin apo ministrin Ahmet Shala. Fjalën, deputetit Driton Tali.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti president!

Zoti kryeministër,

Problemi i eksportit të patates në Shqipëri zanafillën e ka më herët, mirëpo këtë vit është radikalizuar dhe kjo është, sipas disa informatave që unë i kam, është se firma Agnagrup, me pronar Vasil Naçin, ka blerë produktin e patates nga Serbia dhe Maqedonia dhe ajo ndërmarrje, përmes lidhjeve politike dëshiron që ta mbajë monopolin në tregun e Shqipërisë dhe kjo e dëmton direkt kultivuesin tonë të vyeshëm të patates. Sa për hir të argumentit, e ceka se çmimi i patates është 12 centë për kilogram, kurse patatet e Kosovës Dogana e Shqipërisë i tatimon me 24 centë për kilogram, pra më shumë se 100%.

Nuk është vetëm problemi i patates. Edhe më keq është çështja me rrushin, ku rrushi i Kosovës nga doganat e Shqipërisë tatimohet deri 300% , kurse qumështi i Kosovës është e pamundur të eksportohet në Shqipëri, sidomos gjatë stinës së verës, kur në Kosovë prodhimi i qumështit rritet, kurse në Shqipëri ka nevojë. Andaj, pyetja është: “Çfarë po ndërmerr Qeveria për ta zgjidhur problemin e patates së Kosovës në Shqipëri, por edhe të produkteve të tjera bujqësore të cilat Kosova mund t'i eksportoje në Shqipëri? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Parlamentit dhe president në detyrë!

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj të sqaroj para jush dhe gjithë qytetarëve të dashur të Republikës së Kosovës se në pyetjet paraprake nuk u përgjigja sepse nuk desha të jem pjesë e fushatës elektorale paraprake, apo pyetjet elektorale që u parashtruan, por pyetja e zotit Tali, e dyta, ishte një pyetje jashtëzakonisht serioze, me të cilën jam duke u marrë personalisht dhe do të përgjigjem para të gjithë qytetarëve.

Ju informoj se Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë seriozisht çështjen që kërkon, do të thotë, për të zgjidhur sa i përket eksportit të produkteve bujqësore të Kosovës drejt Shqipërisë dhe presim që shumë shpejt kjo gjendje do të zgjidhet. Unë kam diskutuar dhe kontaktuar edhe me kryeministrin e Shqipërisë, zotin Sali Berisha, po ashtu janë zhvilluar edhe takime tjera në mes të përfaqësuesve të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë. Si rezultat i kësaj, është arritur pajtimi që të zvogëlohet vlera referuese e produkteve të eksportuara nga Kosova drejt Shqipërisë dhe tani mbetet vetëm të kryhen procedurat administrative sa i përket rregullimit të kësaj çështje. Unë kam vizituar

edhe vet personalisht, sepse kam qenë i preokupuar rreth kësaj çështje, edhe fermerët në Vushtrri, prandaj, Qeveria e Kosovës vazhdimisht është në kontakt me shtetet fqinje për të lehtësuar procedurat dhe për të krijuar një ambient të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe shtimin e eksporteve bujqësore të Kosovës.

Sa i përket pyetjeve tjera elektorale, besoj që shumë shpejt e keni krijuar ambientin që të kemi ballafaqime debatesh, por besoj që Parlamenti nuk është ambienti për fushatë elektorale. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: faleminderit!

Do të thotë, nuk kemi pyetje të reja. Po, pyetje shtesë, më fal Driton, urdhëro, pyetje shtesë. Jo, desha të them se edhe unë pajtohem me atë, nëse ashtu qysh the ti, vërtet është më shumë se absurd.

DRITON TALI: Zoti kryeministër,

Unë e përmenda emrin e kompanisë pa hezitim, pa ekuivoke, nuk është ndonjë problem që kanë mbi para 200 shekujve, por është një problem shumë korrupsion, kisha për të thanë, me pasoja ose ishte dashur...të lirë deri kaq. Sa i përket pyetjes së parë, nëse ti mendon se 60 mijë pensionistë që kontribuan tërë jetën e tyre është fushatë elektorale, atëherë më falni!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Shqipëria është shtet i pavarur, Kosova është shtet i pavarur dhe vendimet e shtetit shqiptar unë nuk jam këtu që t'i kontestoj apo mbështes apo favorizoj, unë nuk mund të komentoj vendimet e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Obligimi ynë është të thellojmë bashkëpunimi me shtetin shqiptar dhe me të gjitha vendet tjera të rajonit. Edhe një herë besoj që do të krijohen rrethana, por i keni krijuar rrethat për një atmosferë elektorale, që do të ketë mundësi secili t'i shpreh opinionet dhe, natyrisht, edhe vizionin e vet për të ardhmen, por dëshiroj që Parlamenti të mos bëhet arenë elektorale para se të fillojë fushata elektorale. Prandaj, nuk do të jem pjesë e këtij debati elektoral. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Unë po i konfirmoj dy prezencat: fizike dhe elektronike. Sipas prezencës elektronike, në sallë janë 95 deputetë, sipas prezencës fizike, janë 81 deputetë. Desha t'ju lajmëroj se po e bëni shumë prezencën, prezenca fizike është edhe jo elektronike.

Pra, konstatoj se në sallë janë 82 deputetë, erdhi njëri ndërkohë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të vazhduar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe neni 42 i Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit i ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotshme plenare.

Ndërkohë, në pajtim me nenin 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni, ka propozuar me shkrim amendamentimin e rendit të ditës. Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotin Bahri Hyseni, që ta paraqet arsyetimin për amendamentimin e rendit të ditës.

BAHRI HYSENI: faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me nenin 42 pika 2, në pajtim me nenin 49 pika e parë dhe në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Punës së Kuvendit, kërkon nga Kuvendi që të vë në propozim plotësimin e rendit të punës në këtë pikë të rendit të ditës:

- Të shqyrtohet në parim plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit ekzistues zgjedhor, me numër 03/L-073.

Çështja e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë është çështje mjaft e domosdoshme duke marrë parasysh se ligji aktual zgjedhor gjatë zbatimit në praktikë ka hasur në dilema të mëdha. Dilemat kanë qenë rreth kompetencave të vetë Komisionit Qendror Zgjedhor, si një organizëm i cili me kushtetutë organizon zgjedhjet në Kosovë. Dilemat tjera kanë qenë rreth kompetencave dhe përgjegjësi të KZAP-it që ka ekzistuar. Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit e qartësimit të këtyre kompetencave ka ekzistuar një grup i punës, i cili është përbërë nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike, nga Shoqëria Civile dhe nga anëtarët e përfaqësive apo përfaqësive diplomatike që i kemi në Kosovë dhe bashkërisht jemi pajtuar që në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi të dalin propozimet për ndryshimin dhe plotësim e ligjit aktual. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi mbrëmë vonë është takuar në përbërje të plotë dhe unanimisht ka vendosur që Kuvendit të Kosovës t'i propozojë plotësim - ndryshimet për Ligjin aktual zgjedhor. Prandaj, duke marrë parasysh që Ligji me këto ndryshime do të sjellë një pozicion shumë më të mirë që të kemi zbatim më praktik, do t'i qartësojë kompetencat e organeve që sapa i përmenda dhe do të rregullojë edhe mënyrën e votimit dhe procedimit, kërkoj që të futet si pikë e parë e rendit të punës.

Kurse sa i përket propozimit të dytë të Komisionit për Legjislacion, që ka të bëjë pas një shkresë që ka ardhur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Agjencia kundër Korrupsionit dhe pas përfundimit që ka marrë edhe kryetari i Kuvendit dhe Kryesia që të shqyrtojë mandatin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, konsideroj që kjo pikë e rendit të punës të mos propozohet sot në seancë dhe ekziston një arsye kushtetuese rreth propozimit nga radhët e minoriteteve. Ne kemi një dilemë që sapa u dëgjua edhe me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Kandidati i propozuar nga radhët e minoriteteve si Shadije Murat Gërguri, si gjyqtare e dekretuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, është dekretuar si boshnjake, kurse në arsyetimin që e kemi para vetes në Komision, e ka mbushur biografinë si shqiptare. Për të mos ardhur deri te shkelja kushtetuese, te neni 108 i Kushtetutës, kërkoj që kjo pikë e rendit të punës të shtyhet për një seancë të ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në rend të ditës nuk ka qenë, ne e heqim nga rendi i ditës atëherë, se s'ka qenë hiq, kështu që veç për të parën jemi.

Para se të votohet për plotësimin e rendit të ditës me Shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, kërkohet deklarimi i deputetëve për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit.

Për shmangie nga Rregullorja kërkohet miratimi i dy të tretave të votave të deputetëve të pranishëm në mbledhje plenare. Prandaj, e qesim këtë mocion në votim.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 76 vota “për”, 3 vota “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi vendosi për shmangien nga Rregullorja e Punës së Kuvendit.

Ne këtë pikë të rendit të ditës, nëse jeni dakord, pas miratimit të Procesverbalit të mbledhjes plenare të 14 tetorit, e fusim si pikë të katërt të rendit të ditës. Jeni dakord? Me një votim formal, kush është “për”. Faleminderit! A ka “kundër”? Nuk ka.

Pasi unë e kam edhe një kërkesë, por megjithatë ju jeni ata që do të vendosni, unë do të kërkoj deklarin e shefave të grupeve parlamentare. Ne e kemi një rekomandim nga Bordi i Bankës Qendrore për shkarkimin e guvernatorit të bankës. Është pika e katërt, tash vjen e pesta e rendit të ditës. Nëse jeni dakord që këtë t’ia lëmë Kuvendit tjetër, e mos të merremi ne, megjithatë unë po kërkoj deklarin e grupeve parlamentare.

Në emër të Partisë Demokratike, deputeti Ramë Buja e ka fjalën.

Shefat e grupeve e kanë fjalën, flasin në emër të juaj. Urdhëro, Ramë!

RAMË BUJA: I nderuar zoti kryetar,

I nderuar zoti kryeministër, ministra prezentë,

Të respektuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, unë jam kundër kësaj që të hiqet nga rendi i ditës dhe të mos votohet sot për shkarkimin e guvernatorit të bankës për arsyet që i dimë të gjithë bashkë dhe ndiej të panevojshme t’i sqaroj këtu një për një, e ka shumë për tu sqaruar. Unë jam që të mbetet në rend të ditës dhe të votohet sot shkarkimi i guvernatorit të Bankës Qendrore.

KRYETARI: Mirë, faleminderit!

Në emër të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri, e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Kryetar, unë mendova që edhe nja dy muaj i kemi, ky Kuvend, sidoqoftë zoti kryetar, për këtë kërkesë së pari ishte dashur ndoshta të bisedojmë kur të vijë në rend të ditës, edhe ne si grup parlamentar jemi që të mbetet në rend të ditës.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Mendojmë se është pakëz e çuditshme edhe për të diskutuar për këtë temë. Definitivisht që nuk është dashur të mbetet, ka qenë dashur të u kryhet më herët kjo punë, e jo të mbetet për seancën e fundit ose ndoshta edhe parafundit të kësaj legjislature. Sidoqoftë, nëse na ka mbetur t’i përfundojmë punët shpejt e shpejt, tash e përfundojmë edhe këtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të AKR-së, deputeti Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, kërkon që kjo pikë e rendit të ditës të mbetet dhe sot të vendoset për guvernatorin e Bankës.

KRYETARI: Mirë. Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i LDD-së, përkrahë që sot të mbetet pikë e rendit të ditës- Rekomandimi i Bankës Qendrore të Republikës të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYTARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

I mi smo za to da ova tačka dnevnog reda bude danas završena i da se razmatra.

KRYTARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Slobodan Petroviq e ka fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

I Poslanički klub Samostalne liberalne stranke se pridružuje ostalim političkim partijama da se danas glasa...

KRYTARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integrime, kush e do fjalën?

Branislav Grbić e ka fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedniče!

Uvaženi premijeru,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Parlamentarna grupa za Integracije takođe je saglasna da ova tačka dnevnog reda ostane za razmatranje danas.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, mbetet në rend dite. Vazhdomë sipas rendit të ditës.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 tetor 2010

Para deklarimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 14 tetor 2010, më lejoni të bëj një konstatim, përkatësisht deklarim lidhur me pikën e 7 të mbledhjes plenare, më 14 tetor 2010-

Shqyrtimi i rekomandimit për Propozim- strategjinë dhe vendimin e Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë-Telekomit të Kosovës.

Vendimmarrja e deklaruar në mbledhjen plenare, është kontestuar nga një numër i deputetëve, nga fakti se me rastin e deklarimit të miratimit nuk është konstatuar numri i deputetëve të pranishëm në sallë.

Në ndërkohë, mbi bazën e këtyre vërejtjeve, të gjithë deputetëve të Kuvendit, ua kam adresuar njoftimin se vendimi nuk është materializuar, ndërsa me qëllim të arritjes të një konsensusi të plotë në mes të gjitha grupeve parlamentare, për këtë çështje, në interes të vendit, kam propozuar që ky dokument të kthehet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Andaj, e vë në votim procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 tetor 2010, me vërejtjen e deklaruar.

Kush është për?

Vërejtje ke në përmirësim në procesverbalin e mbledhjes së 14 tetorit 2010, që vendimi për privatizimin e Postë-Telekomunikacionit, do të thotë hiqet nga rendi i ditës dhe i kthehet seancës.

Kush është për përmirësimin e procesverbalit?

(Reagim nga salla)

KRYETARI: Po është procesverbal. A e keni lexuar procesverbalin? Po, atëherë, ne po e ndryshojmë, me atë ndryshim, do të thotë, nuk ka kaluar.

Kush është “për”? Ju faleminderit!

Kush është “kundër”? Katër veta janë për privatizimin e Postës, megjithatë nuk shkon.

(Reagim nga salla me duartrokitje)

Shumica absolute, do të thotë e miraton procesverbalin me vërejtjen me deklarimin e lexuar më parë.

Konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 tetor 2010, me konstatimin se nuk është miratuar Propozim- strategjia dhe vendimi i Qeverisë së Kosovës për privatizimin e Postë-Telekomunikacionit dhe ky dokument do të rikthehet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. A e kuptuat tash? Ju faleminderit!

Në rend dite kemi pikën e 19, që u morëm vesh të jetë pika e katërt e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. O3/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hysenin, që në emër të Komisionit, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

Fjala është shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. O3/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër i vendit,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi, duke u bazuar në rregullat e punës së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2010, si Komisioni i përhershëm dhe komision funksional, duke u bazuar në fushë veprimtarinë e vet, ka hartuar ndryshimet dhe plotësimet për Ligjin zgjedhor aktual numër 03-L-073.

Arsyen për ta ndryshuar dhe plotësuar ligjin, thashë paraprakisht ka qenë se ligji aktual ka pasur shumë gabime gjatë interpretimit në praktikë nga dy organet më të rëndësishme që i organizojnë zgjedhjet në Kosovë, Komisioni Qendror Zgjedhor dhe organi për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave. Me qëllim që t'i eliminojmë këto parregullsi, që ligjin ta bëjmë sa më të zbatuar në praktikë, ju e dini që është formuar një grup i punës nga të gjithë përfaqësuesit e subjekteve politike, nga shoqëria civile, nga përfaqësuesi i Kuvendit të Kosovës, dhe në këtë grup kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga bashkësia ndërkombëtare.

Pas një pune të gjatë, kemi rënë në ujdë që të ndryshojmë dhe plotësojmë diku më 15 nene të reja, projektligjin apo ligjin ekzistues. Më pastaj, Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi ka marrë për obligim që këto ndryshime dhe plotësime t'i bëjë në formë të neneve të cilat i kemi sot para vetes. Unë po i adresoj vetëm disa nga çështjet për të cilat i kemi bërë ndryshimet. Së pari kemi rregulluar qartë kompetencën e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe kompetencën e KZAP-it, i cili nuk do të jetë në të ardhmen si KZAP, por do të jetë një panel për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave, i cili në përbërjen e vet do të ketë 10 gjyqtarë, prej të cilëve 9 do të emërohen nga gjykatat e qarkut në Kosovë, kurse një do të emërohet nga Gjykata Supreme e Kosovës, kryesues i këtij Komisioni do të jetë nga gjyqtari i Gjykatës Supreme të Kosovës.

Dilema që ka qenë rreth asaj që Komisioni për Ankesa t'i përsërisë vendvotimet dhe qendrën e votimit apo të urdhërojë apo të udhëzojë Komisionin Qendror që të përsërisë qendrën e votimit, më nuk do të ekzistojë, sepse tani me këtë plotësim-ndryshim, Komisioni do të ketë të qartë në kompetencë se do të jetë vendimtar nëse merr vendim për të përsëritur një qendër të votimit.,

Do të ndryshoj edhe çështja e votimit. Të gjithë qytetarët e Kosovës do të kenë mundësi të votojnë për subjektin politik dhe do të kenë mundësi të votojnë deri në 5 kandidatë. Nëse qytetarët do të votojnë edhe kandidatin e gjashtë, atëherë votat do t'i shkojnë vetëm subjektit politik, por jo edhe kandidatëve të cilët qytetarët kanë votuar.

Plotësim-ndryshimi për ligjin ekzistues nuk ka implikime buxhetore. Implikimet buxhetore janë ato të cilat kanë ekzistuar edhe në Ligjin ekzistues edhe më tutje do të mbetet votimi me kusht edhe pse Komisioni Zgjedhor ka marrë parasysh që në zgjedhjet e fundit, ka pasur shumë dilema rreth votave me kusht. Votimi jashtë vendit do të mbetet me gjithë një përkushtim më të madh që do të ketë Komisionin Qendror Zgjedhor rreth rishikimit të listave aktuale ekzistuese.

Sa i përket deklaratës se është në pajtim me Asquis Communautaire, deklarojmë se edhe grupi punues edhe Komisioni për Legjislacion, kanë pasur qëllim që Kosova të ketë zgjedhje demokratike, me qëllim që të hapen rrugë që këto zgjedhje t'i monitorojnë edhe vëzhguesit ndërkombëtarë edhe vëzhguesit vendorë, nga organizatat tona vendore, jemi pajtuar unanimisht edhe në Komisionin për Legjislacion që të mos ketë gjë as për vëzhguesit ndërkombëtarë as për organizatat vendore. Duke marrë parasysh që këto ndryshime do ta rregullojnë dhe do ta bëjnë më të zbatuar Ligjin për zgjedhjet, do t'u japin mundësi që qytetarët e Kosovës të vendosin me vullnet se cilin subjekt

politik do ta votojnë dhe cilin kandidat, meqë është fjala për zgjedhjet e përgjithshme, unë i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës, që ta aprovojmë në parim. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr z.Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani sipas radhës, hapi debatin për diskutim në parim. Si fillim kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Buja.

RAMË BUJA: Ne si grup Parlamentar e mbështesim këtë Projektligj që do të shkoj në lexim të parë dhe natyrisht si grup e votojmë unanimisht.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar i LDK-së, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i përkrah këto amendamente të këtij ligji zgjedhor. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke pasur parasysh që nuk kemi zgjidhje tjera në këtë moment, duke pasur parasysh, është dashur të përshpejtohet edhe puna në grupin punues edhe në Kuvendin e Kosovës, duke rrezikuar që të shkojmë në zgjedhje të jashtëzakonshme shumë shpejt, neve nuk na mbetet gjë tjetër pos të pajtohemi që këto ndryshime të cilat janë paraparë të kryhen, të paktën të kemi diçka më ndryshe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar i AKR-së, zoti Smaka.

RIZA SMAKA: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Parimisht e pranojmë, mirëpo janë përvjedhur shumë lëshime edhe formulime të papërshtatshme, që medoemos do të duhej të eliminohehin, ja ndër të tjera, po e zëmë.

Te neni 1, ZAP-i, panel është term, panel a e dini çka është, perde, njëfarë çka po di unë, kemi emra “këshill” po e zëmë, hajde nuk po duam komision, komision qe, kështu me radhë. Mirë, por këtu është fjala kësisoj, nuk është përcaktuar është apo nuk është organ administrativ apo gjyqësor, se prej aty varet më pastaj edhe mjeti juridik edhe procedura. Supozohet, ama pse të supozohet, duhet të shprehet që është organ administrativ i shkallës së parë edhe është dashur edhe duhet medoemos të theksohet se është i instancës së parë.

Këto janë sugjerime parimore që, në pjesën e dytë, në leximin e dytë ose bie fjala, herë përdoret termi “apel”, që nuk shkon në gjuhën shqipe dhe nuk ka nevojë, herë “ankesë”. Madje, madje, jo në tekstin, por në të njëjtën dispozitë edhe me siguri krijon, mund të krijojë dilema të panevojshme. Më pastaj, bie fjala te neni 110, paragrafi 2:” Subjekti politik që nuk është kandidat i pavarur, e parqet listën e kandidatëve në përputhje me nenin 27, mandej neni 29 dhe rregullat e

KQZ-së”, rregullat janë akte juridike nënligjore. Kjo është çështje substanciale ligjore, nuk mundet, nuk mund të koncedohen këto tema të akteve nënligjore, se do të bëhej arbitrarizëm. Pse të mos rregullohet me një aline, bie fjala. Te neni, ju lutem, ky është te neni 11. Kjo është një dispozitë suptile, shumë sensitive edhe qartazi në kolizion me Kushtetutën. Kur është fjala 30%, na duhet të gjejmë instrumente, mekanizma, forma, baza tjera e jo të favorizohet. Si mund të jetë, po e zëmë, deputetja me 100 vota apo me 300 vota, ndërsa për ... kërkohej 13.000 vota. Absolutisht, diskriminim që nuk qëndron edhe kushdo që do ta kontestonte, do ta nulte këtë dispozitë. Nuk është zgjidhje e mirë. Jemi për ta favorizuar femrën, sidomos në Kosovë, po se na duhet të krijojmë kushte të barabarta e jo që me vota diskriminatore, në mes disfavorin e mashkullit që femra të favorizohet, madje jashtëzakonisht si me thënë me diferencë të papranueshme edhe të pa irracionale.

Te neni 10, do të duhej zotëri kryesues që fillimisht të caktoheshin zëvendës-anëtarët e jo në qoftë se anëtari i KZAP-it për shkaqe të ndryshme do të dështonte, më pastaj që do të pritej sipas propozimeve këtu, do të duhej të pritej që kryetari i Gjykatës Supreme në procedurë e tjera e tjera, do të duhej në fillim ti caktonte edhe anëtarët edhe zëvendësit, mungon anëtari për shkaqe e arsyeshme apo të paarsyeshme, zëvendës- anëtari menjëherë në mënyrë që ta kemi një efikasitet shumë të nevojshme, të mos krijojmë apriori vakume juridike dhe kontroversa që mund ta pengojnë, a mund të qëllojë, mund të ndodhë edhe qëllim jo i mirë e më pastaj që të pezullohet procedura aq e nevojshme për t’u proceduar me kohë e mirë si duhet.

Do të isha angazhuar që te neni 11 ose të jenë 10, asi 11 ose 9 e jo 10. Pse 10? Më të parën herë mund të ndodhë që ndahen votat 5 = 5. Më pastaj, në qoftë se do të shkohej atje se vota e kryetarit do të dominonte, do të ishte antikushtetutare, kryetari jo vetëm kryesues, është i pari ndër të barabartit, ka vetëm një votë, ose 11 ose 9 a kurrësi 10.

Ja po e zëmë te neni 11, paragrafi 8, alineja 4: “Mund të apelohej vendimi a në të njëjtën dispozitë thotë është ankesa, e kështu me radhë edhe përfundimisht neni 11, paragrafi 5. Vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm, i detyrshëm për t’u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se apeli i lejuar parashtrihet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme përcakton ndryshe. Si mundet Gjykata Supreme të përcaktojë ndryshe, ose po e zëmë të vendosë, e miraton ose e refuzon edhe kur e miraton, ajo çështje është res juridicata, obligative. Përfundimisht, angazhohem që këtu ka edhe tjera vërejtje, do të ketë edhe vërejtjet e sugjerimet e tjera, duhet medoemos të eliminohen edhe duhet të qartësohet, teksti të jetë i kuptueshëm i qartë, konciz edhe të jetë në koherencë me terminologjinë e legjislacionit aplikativ të sotëm në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, i mbështet amendamentet e propozuara për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, zoti Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedavajući!

I mi takode u načelu prihvatamo sve predložene amandmane kao i ostale kolege koje su naveli, znači. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, zoti Petroviq.

SLLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedavajući!

I Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke se pridružuje, znači podržavamo predložene amandmane, s tim imamo jednu sugestiju da u članu 14. prevod na srpskom nije identičan kao na engleskom i albanskom, i imamo sugestiju da se to na vreme promeni. Naime, u članu 120. tačka 1. menja se, zamenjujući tačku b) gde kaže: „pre sertifikacije izbornih rezultata, IVZM izvorno veće za žalbe i molbe, može po sopstvenoj nahođenju, u posebnim okolnostima poništiti rezultate određenog izbornog centra i da naloži CIK-u da ponovo glasanje bude u biračkom centru“. Treba da bude „Izbornog centra“, u mesto Izbornog centra da bude „u Biračkom mestu“, da ako na jednom biračkom mestu budu nepravilnosti, da se ne ponište izbori u celom biračkom centru. Znači, samo tu imamo sugestiju, na albanskom i engleskom je dobro, samo na srpskom prevod je loš. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Besoj se duhet pasur parasysh vërejtjet dhe mendoj, që sipas procedurës, ne do ta miratojmë me procedurë të përshpejtuar në bazë të asaj që e diskutuam. Mirë është që të bëhen amendamentet sot dhe sot komisionet t'u japin zgjidhje.

Në emër të Grupi Parlamentar për Integrim, zoti Baliq, më duket është paraqitur.

NUMAN BALIQ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I mi ćemo takode kao Parlamentarna grupa za integraciju podržati predložene izmene Zakona o opštim izborima, sa jednom vrlo kratkom napomenom da s obzirom da se ove godine po prvi put izvan Kosova glasa, osim elektronskim putem i putem pošte, biće, postojaće mogućnost glasanja u ambasadama, da se onaj deo Zakona koji se tiče glasanja na opštim izborima van Kosova, da se sprovede što je moguće bolje u ambasadama Kosova koje postoje u Evropi i svetu. Hvala lijepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tani radhën e kanë deputetët sipas paraqitjes. Po ua jap me radhë, kështu siç janë.

Deputeti Bujar Dugolli e ka fjalën.

BUJAR DUGOLLI. Ju faleminderit, kryesues!

Unë do të flas për këtë ligj se konsideroj që është ligjet, ndër ligjet themelore për funksionimin e institucioneve të Kosovës dhe demokracisë në Kosovë. Si deputet i pavarur jam shumë i shqetësuar se si po trajtohet ky ligj që është ligj themelor i shtetit, i demokracisë kaq në mënyrë sipërfaqësore kur dihet se për këto ligje shumë shtete bëjnë debat publik, ndoshta deri në 6 muaj për të ardhur deri te rezultatet më të mira, me qëllim të zhvillimit të mirëfilltë të demokracisë dhe pluralizmit.

Ne i dimë praktikat se si janë ndjekur në të kaluarën, sa i përket ligjit zgjedhor dhe si janë imponuar disa rregulla që nuk janë kompatible me rendin dhe me gjendjen në Kosovë, por këtu vërehet që shumë nga partitë që kanë marrë pjesë në këtë grup punues, i kanë realizuar disa interesa të veta dhe fatkeqësia qëndron se edhe minoritetet për shkak se i kanë vendet e rezervuara, nuk brengosen shumë se si do të jenë, sepse e kanë atë vend të rezervuar dhe nuk ju intereson fort për demokracinë dhe për pluralizmin e vërtetë.

Është prapë shqetësuese, që ky shqetësim nuk i adresohet as Qeverisë as Kuvendit, por i adresohet pushtetit tjetër që është pushteti gjyqësor i cili pas gjithë degradimeve që kanë ndodhur në sistemin zgjedhor në të kaluarën, nuk ka ndërmarrë asnjë hap për t'i ndëshkuar keqbërësit dhe keqpërdoruesit e votës së lirë qytetarit dhe prapë hyhet në zgjedhjet pa u ndërmarrë asnjë hap edhe pse e dimë se ka lëndë të përgatitura dhe nuk është ngritur asnjë aktakuzë ndaj keqpërdoruesve të votës së lirë të qytetarit. Hezitohet të ndahen zonat zgjedhore në Kosovë, që për mendimin tim, do t'i begatonim edhe institucionet e Kosovës edhe Parlamentin dhe garën në mes individëve, që janë të fortë në zonat përkatëse dhe kështu do të sjellim një elitë në Parlamentin e Kosovës, domethënë, as me këto ndryshime, nuk është bërë ndarja e zonave zgjedhore si kërkohet shumë. Shumë nga partitë të cilat janë në Kuvend, nuk fals për partitë e mëdha, por për partitë që janë të vogla, nga frika që të mos deklarohen se gjëja nuk është rrezik pragu prej 5%, hezitojnë ta mbështesin uljen e pragut në 3%, duke mos u lejuar edhe subjekteve tjera që janë jashtë Parlamentit, që të përfaqësohen në Kuvendin e Kosovës. Unë këtë e konsideroj si një monopol të subjekteve të përfaqësuara në Kuvend që nuk e hapin zemrën për t'u lejuar qoftë nismave qytetare, qoftë subjekteve të reja politike që të përfaqësohen, po pragu prej 5% e ngulfat demokracinë dhe pluralizmin.

Konsideroj që Komisioni funksional duhet ta ketë parasysh dhe të marrë për bazë edhe kërkesat që i kanë ardhur deri tash, qoftë nga shoqëria civile, por edhe nga subjektet që janë në formim e sipër.

Është folur shumë për listat e hapura dhe ne nuk kemi me të vërtetë lista të hapura në këtë sistem zgjedhor, por kemi numra të cilët mund të deshifrohen ndoshta në emra, por prapë për qytetarin e Kosovës, është shumë sistem i komplikuar.

Çështjet e ndëshkimit të organizatave joqeveritare, konsideroj që duhet të rregullohen me akte nënligjore dhe mos të penalizohen organizatat që mbikëqyrin procesin zgjedhor dhe ato penalizime që mund të jenë në marrjen e licencave, për shembull të rregullohen me akte të tjera dhe jo me ligj. Edhe pse konsiderojmë se ndoshta janë bërë disa hapa, siç është çështja e organit të shqyrtimit të ankesave, eliminimi i KZAP-it, dhe krijimi i një organit tjetër, mendoj që është një eksperiment i cili nuk premtan që do të zgjidhë ndoshta shumë çështje, por megjithatë t'ia lëmë kohës ta shohë se a ka pasur të drejtë, Komisioni, grupi punues për këtë çështje apo jo?

Pasi që nuk janë ndarë zonat, nuk është ulur pragu, nuk ka ndryshim në aspektin e listave të hapura, nuk di pse ky grup punues lejon 5 dhe nuk i lejon 10 të votohen, për shembull, pse e kanë ndryshuar këtë praktikë? Ajo që ishte një më herët, që ishte i aprovuar një ligj dhe mos t'i japë mundësinë as të provohet se si funksionon ai ndryshim i mëhershëm, por ndërrohet ende pa hyrë në zgjedhje parlamentare. Konsideroj se shumë njerëz të cilët e kanë bërë këtë ndryshim, janë të frikësuar që nuk kanë autoritet dhe të gjitha votat i marrin në krah të liderit të partisë. Unë mendoj që, në rast se është bërë ndryshimi në 5, atëherë pse nuk është mbetur në 10 pra, por po shkohet në 5, kur dihet se një zonë zgjedhore nuk ka fort mundësi të zgjedhjes.

Unë i dhashë këto vërejtje duke qenë shumë i vetëdijshëm se këto vërejtje nuk do të merren parasysh, por dua edhe në këtë Kuvend, në këtë institucion të qytetarëve të Kosovës, t'i shpreh këto shqetësime dhe të jem një zë i atyre të cilët nuk mundin të përfaqësohen tani në Kuvend dhe këto shqetësime që konsideroj që janë shumë të drejta dhe do të duhej që grup i punues apo Komisioni funksional t'i marrë parasysh sa i përket pragut që mundet të ndodhë dhe disa çështjeve që i potencova. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Përsëritet kolegjë deputetë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Nuk ka dilemë që rëndësia e këtij projektligji është shumë e madhe, sepse aty shprehet ose ne do të kodifikojmë rregullën ku do të shprehet vullneti i qytetarëve për të ndërtuar institucionet, Qeverinë dhe qeverisjen e vendit dhe sa më mirë që e projektojmë, e ndërtojmë këtë, aq më mirë do t'i kemi pra edhe rezultatin apo çka derivon nga kjo.

Prandaj më lejoni veç në parim t'i them tri a katër çështje, të cilat mendoj që ndoshta kanë pasur mundësi të bëhen, e tash në ndërkohë a ka, nuk e di?

E para, mendoj që për t'u zgjedhur deputetë, të gjithë duhet të jemi në listë të barabartë. Nuk është dashur pra të ketë favore për askënd, pavarësisht çfarë pozite mban në parti. Do të ishte mirë për ta kuptuar këtë si demokraci dhe si mundësi të barabartë. Gara për t'u bërë bartës i listës, ju e keni kuptuar edhe zgjedhe komunale, edhe në këto zgjedhje është ajo që mendoj e favorizon pa asnjë arsye dike. Është kryetar partie, mirë se është, ka benifite dhe funksione tjera, por këtu duhet të zgjidhemi si deputetë dhe të jemi të barabartë para qytetarit, pse të ketë favore? Pra të mendohet kjo dhe të shihet që në listë pra të barabartë para Kushtetutës, para votuesit, para tyre... Mirë. Nëse është ashtu, atëherë në rregull.

Tjetra është ajo që ka të bëjë me, nëse e lejon Kushtetuta, pra nëse ka pasur mundësi, nëse e lejon Kushtetuta gjithnjë po e them, sponzoruesi, çështja e zonave që u përmend këtu. Ka qenë mirë pra, sepse e kemi pasur debatin, vërejtjet kryesore që dy-tri vjet që ka të bëjë, ka të bëjë me atë përfaqësim që do të ishte shumë më i mirë, shumë ma parimor në mundësinë e zgjedhjes nga elektorati, pra një ndarje në zona zgjedhore, nuk është ndonjë si të themi një telashe e madhe për shkak të regjistrave që nganjëherë jemi mbuluar me ta, sepse edhe ashtu, ata ekzistojnë nëpër qendra komunale dhe ka pasur mundësi që 5 deri në 7 zona zgjedhore, pra të bëhet vendi, në mënyrë që përfaqësuesit të jenë më afër atyre që i zgjedhin dhe gara mendoj që do të ishte më korrekte dhe më fer edhe për atë votuesin por edhe për kandidatin që vendoset pra të garojë në kuadër të partive politike. Dhe dy çështje të tjera, pra është çështja e asaj që po ashtu u potencua, mendoj që më korrekte dhe më e drejtë ka qenë të votohet vetëm një kandidat. Pse të votohen 5, pse të votohen 10, pse të bëhet ky problem brenda partisë? Ne i kemi provuar këto dhe realisht ka pastaj garë brenda partisë që aspak nuk është fer. Lista e hapur një kandidat, po fillojmë një garë tjetër e cila i jep shumë më shumë shans njerëzve, strukturave, skemave që janë në parti, ta mbikëqyrin, ta kontrollojnë dhe thjesht ta fitojnë garën pa meritë, kjo nuk i kontribuon demokracisë. Realisht është ashtu. Këto i kemi parë, në qoftë se nuk dom t' i përcjellim ose, në qoftë se e harrojmë pak atë histori të zgjedhjeve që i kemi pasur, unë mendoj që nuk është mirë. Prandaj, që të jem sa më demokratik, është më e drejtë kjo që pra të kemi një votë, vetëm një kandidat e jo pesë, dhe e fundit në qoftë se mbetet kështu këtu nga ana e sponzoruesit, unë kam atë parasysh edhe te neni 7, bie fjala, në të njëjtën pikë kur thotë: që, në qoftë se një fletëvotim ka mbi 5 të rrethuar ose të vendosur, të votuar, ai t'i shkojë partisë, gjegjësisht mos të bëhet e pavlefshme. Unë mendoj që duhet të bëhet e pavlefshme. Nuk ka nevojë ta marrë partia, sepse po janë ata njerëz të partisë të cilët po e bëjnë këtë dallavere te kutia dhe po e shohin se aty nuk janë votuar, 2 veta kanë mbetur zbrazët, po t'ia fusin edhe nja katër- pesë, pse i kanë jaranët e vet aty edhe krejt kjo po i bën të pabarabartë njerëzit e tjerë që janë po ashtu.

Pra, nuk kemi nevojë të lëmë hapësirë për manipulime. Nuk ka asgjë në besim. Jeni të bindur që asgjë nuk ka në besim, sa më shumë që të themi lini këtë punë në besë, dijeni se dallaveret janë më të mëdha, prandaj nuk ka nevojë. Fletëvotimi nëse i ka 6, nëse i ka, nëse mbetet ashtu, unë po them një le të mbetet nëse donë sponzoruesi, por nëse bëhen, atëherë nuk ka kuptim kjo. Janë votuar 10 mbrapa dhe thuhet t'i shkojë partisë. Pse a nuk e ka ditur, ai e ka ditur. Kjo është taman ajo kurdisja te kutia. Po ndahen aty pastaj te kutia ata që po e vëzhgojnë, po e kontrollojnë, thonë merri ti të PDK-së, bënë çka të duash, merri të LDK-së bënë çka të duash, ti të Aleancës bënë çka të duash, e po t'ia futin pastaj e po i mbushin kutitë.

Në qoftë se po ndërtojmë pra projektligj, është mirë që sa më pak mundësi të lëmë për manipulime në vendet e caktuara. Prandaj, unë mendoj që këto 4 vërejtje t'i kemi parasysh dhe mendoj që nuk janë të mundimshme që t'i marrim për t'i shkruar dhe në parim unë e përkrah, sepse kemi nevojë dhe mendoj që Bahriu dhe kolegët e tjerë e dinë këtë punë, ndoshta edhe më mirë se unë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Përsëndetje të gjithëve,
Ka ardhur Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Kuvend. Normalisht se i duhet vendit që të kishte ardhur, ndoshta edhe më herët, por është fakt se për këtë projektligj, nuk është dhënë afat që të punohet nga ana e deputetëve.

Tash është leximi i parë, por ne e dimë se kjo dje ka ardhur në kuti edhe nuk jep ndonjë farë mundësie sa duhet për përpunim të duhur. Unë kam një amendament lidhur me nenin 111 rreth pragu zgjedhor. Ne të gjitha ligjet kur i kemi bërë në Kuvendin e Kosovës kemi thënë me krenari se po i adaptojmë njësoj me standardet e ligjeve të Bashkimit Evropian dhe ne të gjithë e dimë se sipas ligjeve të Bashkimit Evropian, pragu zgjedhor është standard evropian të jetë 3%, ndërkaq kisha apeluar që të mos bëhet përjashtim vetëm në këtë ligj, të mos ndiqet standardi evropian, por të ndiqen standardet tjera, pra këtu është propozuar 5% qysh nuk është sipas ligjeve të Bashkimit Evropian dhe të bëhet 3% në pajtim me to.

Në shumë sfera nuk i keni arritur kushtet ndoshta që me ligj t'i sanksionojmë rregullat për çështje të caktuara, megjithatë i kemi shënuar në ligje. Ndërkaq, këtë mund ta bëjmë, ta realizojmë në praktikë dhe nuk ka ndonjë problem. Rreth kësaj unë e kam bërë një amendament, përveç kësaj, pragu për të cilin po flasim u jep mundësi, jo vetëm qysh po thuhet subjekteve që s' e arrin pragu, por iu jep mundësi ideve të reja që të vijnë në shprehje edhe të hyjnë në Kuvendin e Kosovës, të përfaqësojnë në mënyrë të plotë qytetarët e Kosovës edhe kjo ka vetëm të mira për vendin dhe nuk ka asnjë të keqe dhe nuk e di pse duhet të insistohet në 5%. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Driton Tali e ka fjalën.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!
Unë e përkrah amendamentin e zotit Xhemajli, por do të doja edhe ta shtoja një rresht, domethënë, ku thuhet - së paku 3% nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për

Kuvend”, të shtohet edhe, “kurse për kandidatët e pavarur të jetë pragu natyral, pra të jetë 1%. Nëse me të vërtetë jemi për pluralizëm, nëse me të vërtetë jemi për demokraci, duhet edhe individëve, qytetarëve të Kosovës të cilët mendojnë dhe kanë ambicie, donë të bëjnë diçka që t’u jepet mundësia si të pavarur dhe çdo kund në botë është standardi për qytetarët që dëshirojnë të kandidohen ta kenë pragun 1%. Po them edhe një herë, kjo krejt varet nga ndërgjegjja jonë se çfarë Parlamenti dëshirojmë të kemi, dëshirojmë të kemi një Kuvend ku me të vërtetë të flitet ndryshe, apo dëshirojmë të kemi një Kuvend të dirigjuar nga kushdo qoftë për t’u marr vesh për cilëndo çështje, kjo është tash po them, në bazë të ndërgjegjes tonë ta vendosim. Unë edhe një herë po i lus kolegët që ta përkrahim amendamentin e zotit Xhemajli me propozimin që për kandidatët e pavarur, të ulet në pragun natyror. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!
Deputeti Rexhep Hoti e ka fjalën.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Mendoj se sot është një ditë e veçantë, pavarësisht se si do të shkojnë rrjedhat që ne kemi mundësinë në mënyrë të hapur të bisedojmë për një ligj shumë të rëndësishëm.

E para, ligji është nëospërputhje me standardet e Bashkimit Evropian, për të cilën ne po kërkojmë të shkojmë atje dhe nuk kam fare mirëkuptim për të gjithë ata aktorët e jashtëm të cilët e përcjellin ligjin dhe i lënë këto parregullsi brenda ligjit. Ne veçanti e kam fjalën për pakicat brenda Parlamentit, të cilat realisht po diskriminohen në mënyrë shumë të turpshme. Pse e them këtë? Në qoftë se ne e krijojmë përvojën e krijimit të dy partive të mëdha dhe për t’i gllabëruar të vegjlit, kam përshtypjen se është shumë shpejtë për Kosovën dhe është një rrugë shumë e rrezikshme.

Pajtohem plotësisht që të partitë, të hiqet pragu, por duhet ta them për hir të publikut se pragu 5% ka ardhur si rezultat i një njeriu i cili për të shitur mend, ka kërkuar që të jetë 5% dhe ai është shefi i partisë ORA dhe me njerëz të tillë ja ku kemi ardhur. Prandaj, nuk ka nevojë sot t’i shes njerëzit e partisë nesër parti të mëdha, por ne duhet ta zbresim pragun në 3%.

Në procese demokratike të Kosovës, aktualisht kanë hyrë në garë dy partitë shumë të rëndësishme. Unë e kuptoj se për arsye pragmatike, asnjëra nga këto parti, nuk guxon të kërkojë 3%. Nuk do të ishte prej neve e nderhme që ne ta lëmë 5%, kur e dimë se gjasat se ato dy parti të futen në Kuvend, janë shumë të vogla. Unë konsideroj që është shumë e rëndësishme që t’i jepet një shans, atyre u urojmë të fitojnë na 10% ose 20, por ne duhet ta zbresim pragun. Vërejtje shumë serioze kam sa i përket numrit 5 të kandidatëve. Me qenë se ne po e shkelim standardin evropian, edhe po veprojmë si në Azi, nuk jemi të gatshëm të shkojmë një votë, një deputet, qysh është në Bashkimin Evropian, të paktën 5 vota që e thanë edhe diskutuesit tjerë, në qoftë se ka më shumë se 5 vota, nuk duhet të jetë i vlefshëm fletëvotimi as për partinë, sepse 5 numrat e parë do të bëjnë masakër, sepse gjithkush është i interesuar t’i merr shumë më shumë vota, prandaj brenda partisë të shet qellëm dhe të thotë unë i kam marrë kaq vota. Ne nuk kemi kurrgjë kundër që 5 numrat e parë të partive të mëdha e të vogla, të fitojnë vota shumë, por ato t’i fitojnë në mënyrë të nderhme. Edhe mendoj se kjo duhet të hiqet.

Kisha konsideruar, kisha kërkuar prej parlamentarëve, deputetëve që janë këtu në Kuvendin e Kosovës, tash e shumë vite, të kenë konsideratë për këto çështje edhe t’i bëjmë si duhet se është në nderin e të gjithë neve. Edhe vërejtjen e fundit do ta përkrahja plotësisht propozimin e Driton

Talit, kandidati i pavarur, më sa unë e kuptova nuk është mirë i definuar. Në qoftë se është 5%, kjo është absurd. Kandidati i pavarur duhet të vijë në përpjesëtim me vota që do të kishte për t' i marrë një deputet kur ato ndahen. Ju faleminderit, zoti kryesues, dhe konsideroj se këto çështje vërtetë do të merren në mënyrë serioze, sepse jemi duke shkuar drejt Evropës, e Evropa nuk na pranon me këto masakrime të votave. Ju faleminderit, shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kohë ka akoma për amendamente. Është leximi i parë i ligjit.

Fjalën e ka deputeti Ismail Kurteshi.

ISMAIL KURTESHI: Ju faleminderit, kryesues!

Unë i kam disa propozime konkrete nëpër nene. Në nenin 7, ku bëhet fjalë për një zonë zgjedhore, propozoj që tani të propozohet që t'i kemi 7 ose 8 zona zgjedhore për arsye të cilat i thanë disa kolegë më herët.

Kurse, në të njëjtën nen, pika 110.4 b), atje ku kërkohet që një votues t'i votojë 5 kandidatë, konsideroj se e udhës do të ishte të votohet një kandidat edhe këtë s' po e elaboroj më shumë se e elaboruan të tjerët dhe mendoj se kështu do të vijjnë ata që vërtet e kanë përkrahjen më të madhe të qytetarëve.

Në nenin 14, pika b, thuhet: "para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të KZAP-it, në rastet e jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi dhe ta urdhëroj KQZ-në t'i përsërisë votimet në një qendër votimi apo vendvotimi dhe mandej vazhdohet nëse konsiderohet se ka ndikim në rezultatin final. Mendoj se kjo pjesë, nëse e konsiderohet se ka ndikim në rezultatin final, duhet të hiqet, sepse autoritet në këtë vend, nuk ka të drejtë t' ia mohojë qytetarëve të drejtën e votimit dhe duke anuluar vota dhe mos përsëritur ato, një pjesë të qytetarëve u anulohen me pa të drejtë vota edhe pa bazë kushtetuese, kështu që edhe një herë po e përsërisë, pjesa, nëse konsiderohet se ka ndikim në rezultat, është shumë subjektiv dhe kjo duhet të hiqet dhe këtë të drejtë nuk e ka askush.

Edhe dy çështje. Duke pasur parasysh përvojën e gjertanishme, se ka pasur shumë manipulime dhe vjedhje të votave, propozoj që në vendvotime të vendosen kamerat, kurse me ligj t'u ndalohet të gjithë atyre që shkojnë me votuar që me vete të sjellin aparate ose telefona me të cilët mund t'i votojnë fletëvotimet dhe t'u dëshmojnë atyre që i kanë kushtëzuar se kanë votuar për kandidatin në fjalë, sepse kështu shkelet një e drejtë jashtëzakonisht elementare e njerëzve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Më vjen mirë që janë serioz ata të Qeverisë, se u argëtuan deri tani.

Sa iu përket ndryshimeve të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, unë kisha filluar, zoti kryesues, nga ajo se është bërë me urgjencë që nuk ka qenë aspak e nevojshme, për arsye se Grupi Joformal i Grave para një viti i ka iniciuar këto ndryshime dhe 84 deputetë para një viti e kanë nënshkruar. Nuk ka pasur nevojë të vijë me këtë urgjencë dhe që ne sot t'i marrim ndryshimet, por gjatë këtij një viti është dashur të debatohet dhe të ketë debat jo vetëm brenda grupeve politike, partive politike të cilat do të arrinin natyrisht konsensusin, por edhe debat të mirëfilltë publik dhe cilësor, rezultatet e të cilit edhe do të ishin edhe më produktive. Ndërsa, isha ndalur pak te neni 8, se i pashë

shqetësimet e disa kolegëve pse është përfaqësimi i 30%, apo si i keni quajtur në këtë ndryshim të ligjit - gjini pakicë.

Tash unë po ndalem pak këtu se cilat janë praktikat e deritanishme, do të thotë, në qoftë se ju mendoni se më shumë se 50% të popullatës nuk duhet përfaqësuar në Kuvend, atëherë për çfarë demokracie po flisni? Unë nuk dua një burrë të më përfaqësoj mua, unë dua një grua t'i përfaqësojë interesat e mia. Do të thotë edhe 50% e ka të drejtën ta përfaqësojë vetveten.

Tjetra është se përvoja e deritanishme ka treguar se ligjet sa i përket avancimit të gruas, nuk janë zbatuar. Asnjëherë nuk është zhabur Ligji për barazhin gjinore që siguron 40% të gruas, por mos të ketë siguri në institucionet për përfaqësimin e grave, nuk do të ketë fare gra në institucione. Qeveria i ka pasur dy ministre, tani me gjysmë Qeverie e ka 1 ministre, Kryesia e Kuvendit nuk e ka asnjë grua në Kryesi. Vetëm po i flas argumentet praktike pse është i nevojshëm ky 30% që gratë të mund të përfaqësohen në Kuvend. Dhe, në fund të fundit jemi pajtuar për diskriminimin etnik që paraqesin 10%, atëherë pse nuk mund të pajtohen me, që nuk e quaj as diskriminim, realisht se jemi mbi 50%, pra 30% e përfaqësimit të gruas dhe në fund të fundit kjo e ruan edhe përfaqësimin e burrave.

Prandaj nenin 8 e mbështes, si dhe gjithë ndryshimet tjera dhe po ashtu më vjen mirë që e kanë hequr nenin i cili i gjobit organizatat joqeveritare të cilat bëjnë mbikëqyrjen e këtyre zgjedhjeve.

Kryeministër, ke diçka për të thënë?

KRYESUESI: Zoti Kuçi e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, kryesues!

Ndoshta, pasi po lidhet për grupin e përzgjedhur, unë kam qenë një prej atyre që kam qenë në grup për zgjedhje dhe mund të them që përfaqësuesi i juaj, zonja Sylja, ka votuar me konsensus, bile nuk ka votuar për votimin tim që të hiqet dënimi për OJQ-të, dhe votimi ka qenë publik në media. Ne edhe sot e mbështesim atë qëndrim që të hiqet dënimi që ka të bëjë me vëzhguesit e OJQ-ve.

Dhe e dyta, kisha dashur që ju të koordinoheni mirë me partinë tuaj politike dhe kur të vijmë këtu, të vini me një qëndrim. Ju faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, kryesues!

Propozimet e mia do të jenë të drejtpërdrejta dhe do të propozoj që të rishikohet prapë Ligji për zgjedhjet e përgjithshme. Konkretisht, ligji, neni 12, ku ka të bëjë me regjistrimin e partive politike, sepse nuk është mirë që të silltet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve para situatave të palakmuara, kur duhet të përballlet me vendime shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me partitë dhe mënyrën e funksionimit të tyre të brendshëm, me demokracinë e brendshme partiake.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si institucion i pavarur kushtetues, që është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve, sipas përgjegjësisë që janë dhënë me Kushtetutën e Kosovës. Në rastet e fundit, në kohën e fundit mund të përballlet me situatë kur nuk mund të certifikojë partinë më të madhe në

vend. Kështu që, meqenëse jemi gjatë ndryshimit të Ligjit, partia më e madhe i ka votat në Kuvend, mund të propozojë ndryshimin e nenit 12, që t'ia hapë rrugën veti që të certifikohet. Përndryshe, do të vijmë në një situatë me logjikën kush është më i forti, e bën ligjin vet. Ajo mund të jetë kush është më i forti e bën ligjin vet, por Kosova po ecë drejt rrugës së demokracisë dhe ne po bëjmë përpjekje që të vendosim ligjshmëri në vend edhe nuk është mirë që ligji apo Kushtetuta për dike të jetë njerë, për dike me qenë nënë, kështu që, por meqenëse kemi kohë, është leximi i parë i ligjit, propozojmë që t'i ofrojmë mundësi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të bëjë amendamentimin e rregullave të veta, konkretisht që të bëjë amendamentimin e Rregullës 12, 01-2008, ku ka të bëjë me mbikëqyrjen e organizimit të kuvendeve dhe që të shlyejë pikën 13.6, ku thuhet tekstualisht: partia politike e regjistruar, duhet ta ftojë komisionin komunal të zgjedhjeve, duhet, duhet, jo mund, duhet, obligative, ta ftojë Komisionin komunal të zgjedhjeve për të vëzhguar Kuvendin e degës të saj përkatëse. Dhe, në mos ftesën, mospjesëmarrjen e Komisionit komunal të zgjedhjeve, bënë që kuvendet të mos jenë legjitime dhe të bën që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, të refuzojë një parti politike dhe që mos ta lejoj të futet në zgjedhje përderisa nuk e mbanë Kuvendin e saj zgjedhor. Kështu që, ne e kemi kohën e edhe pak, e ndryshojmë sot ligjin, i lejojmë partisë më të madhe të marrë pjesë në zgjedhje edhe mbesim me ballëhapur, me fytyrë hapur edhe e mbrojmë edhe mbrojmë edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të mos përballet me Gjykatën Kushtetuese dhe që të mos krekosemi se po e mbrojmë Kushtetutën, sepse kjo mbasandaj i bie thuhet se po krekoset një gjel maje plehut, se nuk ka mundësi të krekoset për mbrojtjen e Kushtetutës kur ne po e thyejmë Kushtetutën dhe kemi hapësirën të dalim nga kjo zgjedhje sot e ndryshojmë dhe kaq. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Sylja do të bëjë replikë.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë, për hir të vërtetës, zëvendëskryeministri e dezinformoi opinionin kur tha se unë kam dalë kundër partisë. Pse po e mashtroni opinionin, apo nuk po dëgjoni mirë? Unë thashë, shumë mirë se pajtohemi me të gjitha nenet dhe propozimet ashtu siç është pajtuar Qeveria, siç është pajtuar partia ime, dhe po ju përsëris edhe një herë, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e cila do ta marrë pushtetin...

(Reagime nga salla...)

Po, me siguri nuk e ke kuptuar, zëvendëskryeministër. Po e përsëris, jam për të gjitha nenet e propozuara, por i ndava ose i shqyrtova sidomos dy nene për hir të asaj se disa prej kolegëve ishin kundër nenit 8 që kishte të bënte me përfaqësimin e 30%-it.

Zëvendëskryeministër, duhet të jesh i sinqertë dhe të tregosh të vërtetën, mos bëj fushatë.

KRYESUESI: Kundër replikë, zoti Kuçi, 1 minutë.

ZËVENDËSKREMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, Gjylnaze! Zakonisht tentojmë ta them të vërtetën, nganjëherë nuk e di atë të vërtetë. Nuk kam dilemë që ju flisni në emër Aleancës, bile nganjëherë e teproni duke folur në emër të Aleancës edhe mund të them që i ndihmoni shumë Aleancës. Vazhdoni.

KRYESUESI: Kështu, a po vazhdojmë me debatin?

(Reagime nga salla)

Mirë që po të favorizojmë, po të drejtë s' ke. Jo, jo, të drejtë nuk ke. Unë po ta jap fjalën prapë, por të drejtë nuk ke për fjalë.

Deputetja Gjylnaze Syla e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Edhe ti shumë po i ndihmon partisë duke ia thënë të pavërtetat, gjegjësisht duke i thënë rrenat. Ju faleminderit! Bëhu serioz!

KRYESUESI: Mendoj se replikat... Jo, jo është e tepërt kjo Hajredin, veç hajde. Zotit Kuçi.

HAJREDIN KUÇI: Ju faleminderit, Gjylnaze, zakonisht fjalën rrenë nuk e përdor as në shtëpi, as kurrkund, faleminderit që po e thua ti. Zakonisht në kulturën time nuk shtyhem me gra, por me burra. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Përfundoi, më nuk ia jap fjalën kurrkujt.
Deputeti Shkumbin Demaliaj.

SHKUNBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Pra, lidhur me këtë plotësim- ndryshim të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, kemi një konsensus të partive politike në Kosovë edhe ka ardhur kështu i amendamentuar në lexim të parë. Do të thotë, kemi, duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit, edhe një shmangie për të kaluar ky projektligj, që është thelbësisht me kërkesën e partive politike. Pra, i përkrah amendamentet e vendosura nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi. Diskriminimi i vetëm pozitiv që po ndodh në Evropë, është në Kosovë, në këtë rast në 30%-in për femra, në asnjë Parlament, në vendet më demokratike në botë, nuk jemi kundër femrave që ato të mos përfaqësohen, po le të punojnë që ta ngrisin autoritetin e tyre sepse jemi të gatshëm jo vetëm 30%-shin por edhe për 50%-shin dhe 60%-shin, po le të punojnë më shumë që ta ngrisin autoritetin e tyre, këtë e kemi përcaktuar me ligj 30%-shin dhe kjo është një demokraci shumë e madhe që i ka dhënë Kosovës rreth integritetit të femrës në shoqërinë kosovare. Është e pranueshme.

Ndërkaq, kur flitet për përqindjen, zoti kryesues, unë mendoj që të rritet më lartë sepse ka shumë parti politike në Kosovë, kemi vende me 5-600 milionë banorë, kanë 3 ose 4 parti politike. Neve sot i japim mundësi shumë themelimit të partive të ndryshme, të gjithë po thirrmi se jemi spektri i djathtë politik ndërkaq po them se programi ynë është më i avancuar. Të djathtë kanë program dhe bashkohen, askush nuk i ndalon koalicionet parazgjedhore për partitë politike se mendojnë që nuk do ta kalojnë këtë prag zgjedhor, le t'u bashkohen partive më të forta dhe t'i organizojnë programet e tyre të përbashkëta e të mos flasin për zbritje, sepse dalim shumë keq para opinionit publik dhe të qytetarit. Neve nuk jemi që dikush të hezitojë dhe të thotë se nuk do ta kalojë pragun, por i japim mundësi se neve me rregullore po edhe me ligje e kemi se për me mund me funksionuar dhe me qenë një grup parlamentar në Kuvendin e Kosovës duhet t'i ketë së paku 6 deputetë. Dhe ma merr mendja se po bëhet lojë e madhe atëherë kur deputeti nuk po ka mundësi për me ngrit një çështje ose një mocion kur s'është grup parlamentar ose është se vetëm i jepet e drejta që të paraqesë diçka ose në paraqitje para seancës ose me pyetje parlamentare, sepse s'po mund të funksionojë si grup.

Atëherë, i kishim lutur të gjithë ata që të shkrihen apo të krijojnë koalicionet parazgjedhore, mos të japin mundësinë që çdo ditë të dalë një parti politike e re në Kosovë. Nuk jemi kundër asaj por duke

kërkuar vetëm uljen e pragut sepse nuk jemi të fortë për momentin. Le të organizohet me dikë që është më i fortë dhe le ta shohim, ne kemi nevojë të ndryshim gjeneratave, në ngritje të gjeneratave apo brenda subjekteve, gjithmonë duke menduar që të kemi sa më pak parti politike në Kosovë që edhe numri dhe kostoja e shpenzimeve për parti politike të jetë më e vogël. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ramosaj, e ka fjalën!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe unë desha, për aq sa mundem me kontribuar në këtë debat lidhur me këtë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Së pari, si vërejtje principiele, nga ana ime, është se vërtet ky ligj ka ardhur si çështje shumë urgjente që nuk ishte dashur, sepse çdo vend i cili pretendon vërtet të respektojë edhe standardet ndërkombëtare por edhe demokracinë në vend, menjëherë pasi të kryhen zgjedhjet qoftë në nivel nacional, qoftë në nivel lokal duhet t'i hyjë procesit të rishikimit, të krijojë atë fit-beckun e mjaftueshëm, të shikojë çka kanë qenë dobësitë në zgjedhjet paraprake dhe çka mund të përmirësohet, kështu që neve nuk na arsyetohet vonesa trevjeçare, apo dyvjeçare me sjell edhe Parlamentin, edhe deputetët, në përgjithësi, edhe të gjithë akterët që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë fushë, të sjellin në këtë situatë që vërtet të vijnë në pozitë ose merr ose leje. E ne në fakt si deputetë kemi ardhur në këtë pozitë sot.

Unë vërtet jam pak i shqetësuar dhe i solidarizuar me shqetësimet e shoqërisë civile në lidhje me amendamentin 15, që ka të bëjë me nenin 120 pika 1 të propozuar nga Grupi punues për zgjedhje dhe i përkrahur nga Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi.

Amendamenti 15, i nenit 120 paragrafi c) parasheh shqiptimin e gjobave materiale për organizatat vëzhguese nga sektori i shoqërisë civile, të procesit zgjedhor.

Vërtet unë solidarizohem me një pjesë të shoqërisë civile që dëshiron të jetë participues në procesin zgjedhor respektivisht të kontribuojë në këtë dhe gjoba e tillë për organizatat e shoqërisë civile kur mirë dihet se baza materiale e këtyre organizatave është vërtet shumë modeste, është e nivelit shumë të lartë, andaj kisha kërkuar që ose të ulet me një amendament të veçantë ose të ulet kjo normë e gjobës për shoqërinë civile ose të gjendet një modalitet i cili vërtet të njëjtën kohë kishte edhe me ruajt respektimin e normës ligjore në pjesëmarrje në zgjedhje si vëzhgues, pa dyshim, ose si akterë në atë proces ose të gjendet ndonjë modalitet nga grupi punues që vërtet shoqëria civile të ruhet për aq sa ka mbetur shoqëri civile, duke mos përmendur rastet e fundit që përfaqësuesit e shoqërisë civile që vërtet kemi menduar se janë kah kontribuojnë, kemi rastin e fundit të kalimit të pjesëve të shoqërisë civile në partitë politike, që është gjë krejt normale, mirëpo jo të luajnë rolin vërtet të akterëve politikë e në anën tjetër të thirren në emër të shoqërisë civile.

Vërtet ne shpresojmë që do të hasim në mirëkuptim në këto çështje, edhe pse edhe shumë çështje tjera që i ngritën edhe kolegët tjerë deputetë vërtet jam tepër i okupuar.

Sa i përket çështjes së pjesëmarrjes së gjinisë femërore, vërtet mua më vjen keq që në këtë Parlament ende ne dallojmë gra e burra. Unë e di që në këtë Parlament ka deputetë, nuk ka diçka tjetër. Dhe, respekti duhet të jetë në këtë nivel. Pra, pa marrë parasysh a është i gjinisë femërore apo mashkullore ne jemi deputetë dhe t'i respektojmë si deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Manaj, e ka fjalën!

RAMË MANAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë,

Mbështes propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për zgjedhjet, në parim dhe shumicën e vërejtjeve dhe plotësimeve që u bënë nga deputetët.

Në këtë vazhdë, do të doja vetëm tri çështje t'i theksoj, që më duket nuk janë theksuar deri më tani.

E para, bëj vërejtje: nuk ka pasur nevojë të ofrohen konstatimet që kanë qenë edhe në Ligjin e që nuk janë ndryshime, qoftë çështja e pragut, qoftë çështja e përqindjes së gjinisë, sepse ato nuk janë ndryshime krahasuar me Ligjin ekzistues, por kjo nuk do të thotë se s'ka pasur mundësi dhe s'ka mundësi që të prezantohen këtu propozime për ndryshime.

E dyta, tek neni 8, nëse s'gabo, pika b) ku thuhet: duke zëvendësuar 118.4 me këtë, si në vijim, po e lexoj tekstin: "Mund të apelohe vendimi i KZAP-it sikurse që KZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar". Mendoj se pjesa, "apo edhe për shkak të vullnetit të mirë të treguar" duhet hequr sepse nuk është bazë që duhet të përfillet në kuptim të rishikimit të ligjit, respektivisht dispozitës.

Sido që të jetë, kërkohet një gjuhë më precize dhe më e saktë, është një gjuhë tepër fluide, "mund të apelohe vendimi i KZAP-it". Mund të thuhet, dhe do të duhej të thuhet "vendimi i KZAP-it mund të apelohe". Mandej, ai mund të rishikohet dhe pika vijuese nën c), duke zëvendësuar 118.5, me këtë si në vijim: "Vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja përveç në rast se apeli i lejuar parashtrohet brenda kohës së paraparë dhe Gjykata Supreme e përcakton ndryshe". Do të duhej thënë se "vendimi i KZAP-it është i detyrueshëm, kurse apeli e pezullon ekzekutimin e vendimit". Është më qartë, është më drejtpërdrejt dhe është gjuhë më shumë normative, gjuhë e normës.

Ndryshe, besoj se, me gjithë kohën e shpejtë, Komisioni për legjislacion dhe gjyqësi ka edhe pak punë edhe të harrë shtrimin normativ, juridik dhe profesional të tekstit, por edhe të përfshijë shumicën prej atyre vrojttimeve, atyre plotësimeve që kolegët i kanë prezantuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hyseni, Hydajet Hyseni e ka fjalën!

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë përshëndes këtë ligj edhe pse është e vërtetë, ne po na përsëritet ajo që thonë – kush vonohet kur duhet të ecë më shpejt, pastaj nxitohet kur duhet të ecë më ngadalë. Po e kam parasysh faktin që ky ligj në formën që ka ardhur tash është punuar me nguti dhe s'mund të mos përgëzojë ata që kanë punuar, marrë vesh që kanë punuar deri në orë të vona atë mesnatë e tjera dhe mendoj meritojnë respekt. Kjo më bën edhe të pamundshme të ndalem në vërejtjet që mund t'i bëhen, por që janë pasojë e kësaj pune vërtet nën presion të kohës.

E dyta. Është punuar ky ligj po ashtu me marrëveshje për shkak të situatës së krijuar dhe mendoj që këtë duhet ta kemi parasysh, prandaj edhe nuk do të lëshohem në dilemat, vërejtjet që janë lidhur me sistemin tonë zgjedhor. Ka shumë për të ndryshuar, lë shumë për të dëshiruar sistemi ynë zgjedhor.

Po theksoj vetëm për parim: Ne nuk po e respektojmë parimin një qytetar – një votë. Ne nuk kemi bazë elektorale. Për pasojë, po feudalizohet, po partizohet edhe legjislativi dhe kjo nuk është mirë për demokracinë.

Po për këtë, besoj, do të kemi rast edhe ndonjëherë tjetër të debatojmë dhe besoj të ketë rast me kohë, kur është që nuk jemi në nguti.

Më lejoni mua që të bëj vetëm dy vërejtje, që besoj, janë të natyrës konsensuale dhe besoj që do të kenë edhe mirëkuptimin e Komisionit në fazën e më pastajme.

Në nenin 7 të Ligjit për ndryshimet, që i referohet nenit 110 të Ligjit, paragrafit 7, është përdorur gjithkund shprehja: “Subjektet politike”, duke nënkuptuar gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje. Për partitë politike edhe s’mund të ketë emër tjetër, por për listat e qytetarëve, për kandidatët e pavarur nuk është emër adekuat. Subjekti politik është subjekt politik, po do të ishte më mirë, dhe ky është propozimi im, të zëvendësohet kjo shprehje me “subjektet elektorale”. Kur flasim për zgjedhjet kemi të bëjmë me zgjedhjet dhe subjektet duhet të cilësohen si subjekte zgjedhore. Besoj se pajtohen të gjithë.

Dhe vërejtja e dytë, ka të bëjë me këtë një apo pesë vota. Unë mbetem i bindur se kjo pesë vota është ndoshta 50% më pak abuzive se ajo që e kishim përpara, por vërtet siç është thënë disa herë, votimi i 10 kandidatëve ka krijuar mundësi për masakër zgjedhor elektorale. Dhe, s’duhet të lejohet qoftë as gjysma e saj. Mirëpo, nëse partitë politike janë marrë vesh, unë s’mund ta kontestoj, por dua të them vetëm se do të ketë pasoja.

Për të evituar eventualisht mundësinë e lojës me 5 vota dhe për t’i shpall të pavlefshme, siç u tha nga disa këtu, unë nuk pajtohem me atë kërkesën që të shpallen të pavlefshme se edhe ajo është një mënyrë e abuzimit. Një listë tepër dhe ishte një propozim... ju lutem! Një votë më shumë, do të thotë ishte një propozim që të shpallen të pavlefshme...

Por, propozoj një zgjidhje tjetër. Që të jetë një rubrikë në fund të listës, sa vota janë votuar dhe çdo votues t’i shënojë, nëse ka votuar një kandidat të shënojë një. Tre – tre, pesë – pesë dhe nuk ka mundësi dikush të shtojë emra tjerë dhe në këtë mënyrë t’i bëjë votat, qoftë të pavlefshme qoftë t’ia delegojë pastaj partisë, dhe në këtë mënyrë pastaj të bëhet ai inxhinieringu tjetër.

Dhe propozimi vijues, që mendoj mund t’i ndihmojë kësaj, është që në hartimin e listave të përdoret alfabeti ose shorti dhe kjo do ta reduktonte mundësinë e abuzimit sepse nëse nuk janë të përzgjedhurit në krye të listave atëherë më pak do të ketë edhe motiv për të luajtur pastaj lojën me vota të pavlefshme, jo të tepruara, me kandidatë e tjera. Besoj që do të has në mirëkuptimin tuaj? Ju falënderoj!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Zylfi Merxha e ka fjalën!

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Ju përhëndes juve dhe stafin tuaj! Përhëndesim ministrat që janë lartë!

Zonja e zotërinj deputetë,

Unë nuk di, sot e dëgjova prej zotëri profesor Smakës, një njeri shumë i respektuar te unë, jurist, akademik, thotë: gratë me qenë njëjtë si burrat, e ne kurrsesi s'po mund t'i gjejmë gratë me mbush 33% të cilat duhet, se Bashkësia Evropiane nuk na pranon Parlamentin kështu. Një.

E dyta, ka thënë, të kalojmë. Po nuk di ku ia zëra rrugën jaranit tim, ish ministrit Dugolli, mu kap me ne pakicat. Neve zoti edhe kështu na ka vra, tash ai s'po do me na pa edhe në Parlament, pse jemi pakicë.

Le ta korrigjojë pak veten. I lutem kur t'i thuash dikujt, duhet kur të pish ujë e kur të hash bukë, me lënë vend edhe për ujë. Unë s'di, më duket se ne me ligj e kemi. Kurr gjë, s'po lypim prej kurrkujt individualisht por qysh po na jep ligji ne po e pranojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

U tha shumë herë këtu që në momentet e fundit s'është problem me i shqyrtuar ligjet dhe me pas mundësi që diçka së paku të mirë të nxjerrim nga to, megjithatë unë do të përqendrohem vetëm në një çështje, është te neni 120 pika 1, paragrafi c) duke e vlerësuar se sa është i nevojshëm monitorimi i zgjedhjeve nga ana e vëzhguesve jo partiakë. Konsideroj se paragrafi, ku flitet për gjoba, për organizatat joqeveritare që merren me monitorim të zgjedhjeve që të largohet nga ligji, për shkak se kështu edhe do të pamundësojmë veprim të drejtë të vëzhguesve të OJQ-ëve, por po ashtu do të ketë mundësi që pastaj partitë politike përmes organizatave të shoqërisë civile të përpiqen që ato t'i degradojnë. Rekomandoj dhe propozoj që ky paragraf të hiqet nga ligji në mënyrë që të kenë mundësitë edhe OJQ-ët pavarësisht problemeve që mund t'i kenë të monitorojnë zgjedhjet pa u frikësuar paraprakisht se ato do të mund të gjobiten. Edhe ashtu manipulimi me vota është vepër penale, kështu që konsideroj se kjo do të duhej të hiqej, në mënyrë që të garantohet dhe të sigurohet një monitorim prej vëzhguesve jo partiakë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Sanije Aliaj e ka fjalën!

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra të nderuar,

Përsëritet ardhjen e Projektligjit për zgjedhjet në këtë seancë plenare sepse edhe me procedurë të ngutshme na është ofruar dhe në mënyrë obligative duhet ta bëjmë vlerësimin dhe amendamentimin e këtij ligji sepse jemi në prag të zgjedhjeve.

Nuk e kam pas ndërmend të marrë fjalën, por vlerësimet e disa deputetëve për këtë projektligj më kanë shty që edhe unë të jap opinionin tim në një të mirë të përgjithshme të shtetit tonë.

Kolegë të nderuar, deponimin që e ka bërë Grupi i grave deputete, për plotësim-ndryshimin e nenit 110 në Ligjin për zgjedhjet është bërë para zgjedhjeve lokale, por nuk ka hasur në mirëkuptim dhe nuk është shqyrtuar dhe kërkesa jonë ka ardhur deri më sot që pas një pune që është bërë me insistimin tonë që të ndryshohet ky nen dhe në listat kandiduese të subjekteve politike të votohen 5 kandidatë e jo ashtu siç ka qenë më parë. Interesimi ynë ka qenë shumë i sinqertë sepse në një listë

ku votohet një kandidat pak kush do ta votonte gjininë femër prandaj insistimi ynë ka qenë që femra të shkojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës me votën e saj të miratuar.

Edhe reagimin tjetër, 30%-shin në listat kandiduese, është kategori kushtetuese. Kolegë të nderuar, në mandatin e parë kemi miratuar Ligjin bazik për barazi gjinore që në thelbin e vet ka 40%-shin në përfaqësimin e institucioneve të Kosovës. Parlamenti që do të dalë nga zgjedhjet duhet të insistojë që edhe Ligji për zgjedhjet, edhe Ligji për partitë politike duhet të jetë në harmoni me Ligjin për barazi gjinore, sepse jemi dëshmitarë që në institucionet qendrore, por edhe ato lokale, në qendrore femra është e përfaqësuar me 14.34% në atyre lokale me 34%. Pra jemi larg zbatimit të ligjeve që vetë po i miratojmë. Prandaj, mos t'i vijë nxehtë askujt, që femra është pjesë e barabartë e shoqërisë dhe përpjekjet e saj për një trajtim të barabartë është një përpjekje normale për një jetë më të mirë dhe për një demokratizim më të mirë të Kosovës. Pra, kur miratohen ligjet ato duhet të zbatohen dhe nuk është fer, nuk është demokratike që zëri i disa deputetëve të vijë në kundërshtim me synimin tonë të sinqertë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Me sa kam dëgjuar, jeni keqkuptuar ju, për raportin që është kërkuar. Megjithatë fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Ligji aktual për zgjedhje ishte joefikas dhe për këtë të gjithë ne i kemi dhënë vërejtjet tona, për këtë arsye edhe është formuar grupi punues që të reformohet ose të amendamentohet ky ligj.

Është jo e saktë të thuhet që plotësim-ndryshimi i ligjit për zgjedhje është bërë me konsensus të partive politike. Mund të them që në këtë grup nuk ka marrë pjesë një numër i madh i partive politike të cilat janë parlamentare dhe jo parlamentare. Andaj, edhe kemi të drejtë që t'i themi vërejtjet tona, në mënyrë që në amendamentim të këtij ligji, në lexim të dytë, të mirren parasysh.

Përcaktimi i pragut zgjedhor duhet të jetë në proporcion me numrin e votuesve. Kjo që është bërë në Kosovë, vërtet është bërë ndoshta nga një qëndrim ad-hok i një personi ose i dy-tre vetëve, sepse është menduar që ndoshta në këtë formë do të tregojë se sa do të jetë forca e tij. Kemi vende ku numri i votuesve është rreth 50.000.000 dhe pragu është 5%. Kemi gjithashtu edhe 20.000.000 votues, pragu është 5%, kemi vende ku janë 10.000.000 pragu është 3%.

Unë mendoj që pragu zgjedhor duhet të hiqet krejtësisht, për dy arsye:

Arsyeja e parë, përderisa ne 20 vende – ulëse të Parlamentit i kemi të siguruara për minoritetet që është e drejtë kushtetuese, dhe përderisa të gjitha subjektet politike të partive pakicë nuk kanë prag zgjedhor, nuk është mirë që të bëhet pragu zgjedhor derisa të kalojë kjo kohë. Kjo ka qenë edhe me kornizën kushtetuese, ju të gjithë e dini, që pragu zgjedhor nuk ka qenë as 1%, andaj unë mendoj se duke u munduar me qenë shumë demokratë jemi duke shkelur demokracinë dhe jemi duke i cenuar të drejtat e subjekteve politike të cilat vërtet dëshirojnë me qenë pjesë e institucioneve të shtetit dhe dëshirojnë me dhënë një kontribut për qytetarët e vendit.

Edhe një herë po them, ky ndryshim i këtij projektligji nuk është në konsensus të partive politike, por është në marrëveshje të disa subjekteve politike, andaj kërkojmë që vërejtjet tona të merren parasysh.

Sa i përket dënimeve që janë dhënë. Unë mendoj që dënimet për subjektet politike të cilat i keqpërdorin votat duhet të jetë shumë më i lartë, jo 50.000 por të jetë edhe më i lartë sepse jemi dëshmitarë të zgjedhjeve të fundit çfarë masakre është bërë në keqpërdorimin e votave në të gjitha komunat. Andaj, nuk është ndoshta në rregull që të dënohen organizatat joqeveritare megjithëse këtu nuk ekziston ashtu qysh unë po e shoh, nëse e kam kuptuar, por flitet për subjekte politike të cilat keqpërdorin, të mos jetë 50.000 por të jetë shumë më i lartë.

Mendoj se këto vërejtje të cilat i dhamë, i dhanë edhe kolegët e mi, duhet të merren parasysh sepse kjo do të ishte në të mirë të një demokracie të vërtetë në vend dhe jo demokraci e cila flitet që është demokraci, sepse kemi deputetë në Parlament që nuk i ka marrë 100 vota është deputet, ndërsa ka deputetë me 8.000 vota kanë mbetur jashtë bankave të Parlamentit, jashtë ulëseve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani lista po shtohet çuditshëm! Danush Ademi e ka fjalën!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket Ligjit të zgjedhjeve, edhe ne do ta votojmë këtë ligj, edhe pse kemi kërkuar edhe me shkrim nga Grupi punues që bartësi i listës të jetë, të mos largohet nga lista e votuesve, të votohet për 5 por të ketë edhe bartës të listës për një arsye sepse ka probleme te partitë e vogla, kanë probleme sa i përket kësaj çështjeje, kurse te partitë e mëdha nuk është e ndjeshme.

Te neni 116 pika 1, nuk është e definuar mirë, thotë: përbëhet nga 10 anëtarë, përfshirë edhe kryesuesin që na në 3 legjislatura i kemi pasur këtu deputetë nga PDAK-ja dhe asnjëherë nuk kemi pasur mundësi ta dërgojmë njërin, një anëtar në KQZ të jetë anëtar i Partisë Demokratike të Hashkalinjve. Kjo vazhdimisht na është mohuar kjo e drejtë. Kërkoj që në nenin 116 të definohet kjo pak më qartë se së paku te komunitetet se cila parti e komunitetit do të kishte më shumë vota ajo parti ta dërgojë personin në KZAP e jo partia e cila ka marrë, edhe pse janë vendet e rezervuara, jo partia që ka marrë ndoshta 100 vota apo 50 vota ta ketë personin e vet në KZAP kurse partia që ka marrë deri në 6.000 vota nuk do ta ketë të drejtën me pas personin në KZAP. Prandaj kërkojmë që ky neni 116 të ndryshohet e jo t'i lihet hapësirë vetëm disa grupeve këtu që vazhdimisht t'i qojnë të njëjtit njerëz por të merret përsipër edhe vota e qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Buçinca e ka fjalën!

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, kolegë të nderuar,

Unë u lajmërova për të diskutuar vetëm për dy çështje: çështjen e pragut zgjedhor dhe përfaqësimin e femrave në Parlamentin e Kosovës.

Sa i përket pragut zgjedhor, kërkesat për uljen e pragut zgjedhor po më duken të pajustificueshme, të paarsyeshme në pikëpamje të funksionimit të sistemit në përgjithësi në Kosovë.

Nëse ne do të ulnim pragun zgjedhor dhe do të kishim 40 parti në Parlament me nga 1 përfaqësues ose 50, shtrohet pyetja si do të funksiononte Parlamenti dhe çfarë qëndrueshmërie institucionale, çfarë qeverie do të nxirrej nga ky Parlament.

Duke u nisur edhe prej faktit që ne, si shqiptarë jemi familje të mëdha, çdo familje kishte mund me krijuar një parti politike dhe me miqtë e vet dhe farefisën e vet me futë një deputet në Parlamentin e Kosovës.

Prandaj, këto kërkesa janë absurde, nuk mundemi ne, për hir të një parimi demokratik, të përfaqësimit të gjitha grupeve etnike, të gjitha partive dhe subjekteve politike, që ne të rrezikojmë funksionimin e sistemit në tërësi dhe mos të kemi një qeveri stabile, nuk kemi institucione stabile por vazhdimisht na paraqitet problemi i fargjilitetit të funksionimit të institucioneve demokratike. Pra, u tha edhe më herët, nga kolegët këtu, që ato parti të cilat dëshirojnë të jenë të përfaqësuara mund të bëjnë koalicione parazgjedhore dhe të futen në Parlament.

Do të thotë ky është një mendim i imi, nga pikëpamja e funksionimit të sistemit në tërësi.

Kurse, sa i përket përfaqësimit të femrave. Ma merr mendja se ne duhet të heqim dorë nga kjo dispozitë, që me çdo kusht duhet Parlamenti t'i ketë 30% femra. Unë mendoj se 30% femra duhet të jenë të përfaqësuar në listë, por jo që të diskriminohen dhe të formohet vullneti i qytetarëve që femra të futet në parlament me 100 vota kurse një mashkulli i duhen 10.000 vota. Ky është deformim i vullnetit të qytetarëve. Mundësi të barabarta, por jo diskriminim pozitiv me vullnetin e qytetarit. Ne duhet t'i pyesim qytetarët, a kanë dëshiruar ata që të deformohet vullneti i tyre në përfaqësimin e Kuvendit të Kosovës. Vazhdimisht kam qenë dhe jam që t'i mbrojmë femrat, t'u japim mundësi të barabarta, por jo privilegj dhe ofise në dëm të vullnetit të qytetarëve. Politika është ambient mjaft i ashpër dhe të gjitha ato femra që dëshirojnë të futen në politikë duhet të ballafaqohen me këtë ambient. Ambienti politik nuk është hiq i favorshëm as për meshkuj. As për meshkuj nuk është! Është natyra e vetë politikës së tillë dhe padyshim kërkohet që edhe femrat të tregohen më të zhdërvjellshme dhe të hyjnë në parlament me votë. Vota e ka vetëm një vlerë. Numërohet 1. Dhe nuk mund të deformohet vota.

Unë nuk them se duhet kësaj radhe me ndryshuar këtë dispozitë, mirëpo në të ardhmen duhet të kemi parasysh: mundësi të barabarta, por jo edhe privilegje në emër të vullnetit të qytetarëve, deformim të vullnetit të qytetarëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lus që të paraqiten të gjithë ata që donë të diskutojnë, që tani dhe më nuk ua jap fjalën tjetërkujt, përveç për replika. Paraqituni, po ju jap afat tani. E keni shkruar emrin, kush do të flasë, le të regjistrojë emrin. Fjalën e ka deputetja Njomza Emini! Me kartelën e Sanije Aliajt!

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Nuk desha me marrë fjalën por po e marr fjalën sepse unë po ashtu edhe kolegët e mia kanë hyrë këtu me vota, jo pse jemi femra, dhe jo pse deri tani ka qenë mendimi që femrat janë vetëm kukulla në Parlamentin e Kosovës, por ne kemi ardhur këtu me vota dhe nuk kemi nevojë privilegje sa kemi nevojë për përgjegjësi më shumë.

Unë do të ndalem vetëm te roli i përfaqësimit të grave. Dihet shumë mirë që në ekzekutiv sa gra kemi. Dihet shumë mirë se sa në Kuvend kemi gra të zonja dhe kanë ardhur me vota dhe nuk kanë ardhur pse kemi pasur dikë të farefisës apo diçka tjetër. Unë po e marr këtë guxim me folë sepse unë

këtu kam ardhur me vota të qytetarëve të Kosovës dhe nuk kam ardhur këtu me kuotën si ka qenë deri më tash. Atëherë, mendoj që duhet ta keni....

(Ndërhyrje)

Mirë, unë po flas, kolegë i nderuar dhe këtu po shihet se sa është respekti i koleges, do të thotë e deputeteve, sepse nuk është kjo hera e parë. Nëse e merr këtu një deputete fjalën, menjëherë dalin tjetër dhe shihet reagimi i tyre. Unë konsideroj që duhet të ndryshohet kjo qasje. Unë konsideroj se nuk duhet të shikohet femra vetëm si është shikuar deri më tani dhe prej kolegëve të tyre, por konsideroj se ne jemi të zonja dhe këtu kemi ardhur me përgjegjësinë e plotë dhe kemi ardhur këtu jo me privilegje.

Andaj, unë konsideroj se për rolin e përfaqësimit të grave në politikë, ta zbatojmë këtë ligj dhe mendoj se kjo është më e mira që do të duhej të kishte një vend demokratik.

Unë nuk do të kisha shtuar më shumë, sepse këtu dihet roli i grave, sa të zëshme kemi qenë dhe sa kemi qenë kontribuuese në proces të politikës. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Hundozi, e ka fjalën!

ZYLFIJE HUNDOZI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Edhe unë s'desha të flas, por u fol mjaft. Po kjo çka sot po dëgjohet këtu për barazi gjinore është vërtet dëshpëruese. 30% është vënë për shkak të mentalitetit ballkanik, se jo për shkak të vullnetit të popullit. Me u vet populli 50% jemi gra dhe me siguri që kishin me lypur që 50% me qenë edhe në Parlament.

Kjo çka tha zëvendëskryeministri, i cili ësh profesor në fakultet. Sa e di unë, i ka dy a tri vajza të shtëpia. Thotë, unë nuk matem me gra! Kjo e tregon mentalitetin e tij. Domethënë, kur një person i cili është prej një instance më të lartë e thotë këtë fjalë, këtu s'kemi çka të debatojmë për vullnetin e popullit. Këtu kemi të bëjmë me një mentalitet të mbrapambetur.

Kështu që, unë po propozoj, jo 30% po kjo me u rritë në 40% përfaqësimi i grave në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Hoti e ka fjalën! Edhe një herë po e lyp, s'di çka po do me thënë?

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Dritëro Agolli thotë: "për grua dhe tokën, lë kokën". Leni, leni gjininë e bukur rahat, sepse ato kanë të drejtë të përfaqësohen në 50%. Fare nuk ka mirëkuptim për njerëz që vërtet këtu duan të bëjnë diskriminim dhe nuk e kuptojnë se vetë janë ata që nuk kanë arritur ta edukojnë vetveten për t'i përfaqësuar 50%. Në qoftë se duan, e bëjmë një ndërrim. 30% i bëjmë burrat, 70% gratë, pastaj e bëjmë me vota të barabarta. Prandaj, ky ishte propozimi i parë.

Sa i përket propozimit të dytë, dhe shumë shkurt. Ju lutem keni konsideratë për uljen e pragut. 3% është i nevojshëm për Kosovën. Partitë e vogla me 3% arrijnë deri në 40.000 votues. Këta nuk janë të vegjël. Ky është një koncept shumë i madh politik, jepuni shans frymëve të reja që të prezantohen në Parlament dhe do të kemi më pak tregti. Faleminderit!

KRYESUESI: Në fund, deputeti Bahri Hyseni e ka fjalën!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari ju falënderoj që Ligjin e kemi lexuar në parim dhe do të kemi mundësinë që me kaq pak kohë që kemi të bëjmë ndonjë amendament eventual nga diskutimet që dolën.

Por para se gjithash është mirë vetëm t'i qartësojmë disa nga çështjet të cilat i kemi në plotësim-ndryshim dhe unë e kuptoj se ka qenë një kohë shumë e shkurtër dhe deputetët ndoshta nuk kanë pas mundësi as me i pa, por t'i qartësojmë.

Së pari, të gjithë kandidatët në listë janë të barabartë, duke filluar nga liderët politikë. Janë të barabartë dhe votat e partisë nuk i shkojnë askujt. Mendoj se kjo çështje u propozua nga disa mirëpo në plotësim ndryshim votat nuk i shkojnë askujt.

Çështja tjetër. Ne kemi diskutuar shumë. Në ligjin ekzistues kanë qenë partitë politike dhe me konsensus jemi marrë vesh që të shkruhen subjekte politike, subjekte politike për shkak të arsyeve sepse ata që po garojnë munden me garuar edhe me iniciativa të ndryshme, por me pas karakterin e subjektit politik që po dëshiron me marrë pjesë në zgjedhje. Domethënë, e kemi bërë me konsensus. I treti sqarim, që nuk do t'i përmendi me emër, mirëpo nuk është me rëndësi a janë 10 gjyqtarë apo jo. Nëse keni lexuar mirë, gjyqtarët do të punojnë në 3 grupe nga 3, kurse kryesuesi do ta ketë mundësinë që t'i përfaqësojë të 3 grupet në raste të caktuara në takime të ndara, apo në vendimin përfundimtar dhe nuk do të ketë do të thotë mundësi që 10 gjyqtarë të punojnë për një çështje, duke marrë parasysh, nëse e keni pa, afatet janë shumë të shkurtra. 72 orë janë me dhënë vendimin e fundit për një çështje të caktuar.

Sa i përket ndarjes së zonave. Ne me konsensus, edhe një herë po them, të gjitha partitë parlamentare, por edhe partitë nga komuniteti pakicë, edhe përfaqësuesit e grave jemi marrë vesh, që nuk ka mundësi teorike me u nda në zona për shkak të jo regjistrimit, që s'e kemi, për popullsinë dhe për shkak të një situatë që ende nuk e kemi – edhe decentralizimin në të gjitha komunat, dhe kjo do të marrë shumë e shumë kohë. Domethënë është e pamundur, dhe për këtë jemi pajtuar.

Çështja e pragut zgjedhor. Të bëjmë të qartë, për Kuvendin. Ne si Kuvend e kemi votuar Ligjin me pas pragun 5%. Nuk kemi ne duke e bërë propozimin tani, por ky Parlament ka votuar për Ligjin ekzistues që e kemi me pas pragun 5 zgjedhor. Unë nuk jam shumë efikas me marrë listën kush e ka votuar, por po më duket se të gjitha votat kanë qenë unanime dhe kurrkujt atëherë nuk i ka shkuar ndërmend që të ulë pragun zgjedhor. Prandaj, ne nuk kemi plotësim-ndryshim këtu por ai 5% ka qenë nga Ligji të cilin e kemi votuar në këtë Parlament. Dhe këtë ta bëjmë të qartë!

Kemi diskutuar për pragun, mirëpo konsiderojmë që një vend i vogël me 40 parti politike, nëse ulet edhe pragu, nuk e di a do të ketë dikush mundësi me formuar edhe qeveri. Këtë e kemi diskutuar edhe me ekspertë ndërkombëtarë. Nuk është çështje që nuk e kemi diskutuar.

Unë dëgjova edhe kolegë deputetë, dhe po më vjen mirë që duhet të respektohet gjinia e kundërt. Të gjithë jemi me respektuar gjininë e kundërt. Mirëpo, të ju vë në dijeni. Ka pasur propozime nga mekanizma ndërkombëtarë, duke u bazuar edhe në parimet më demokratike, që shkalla të ulet. E drejtë demokratike është me qenë të barabartë në pjesëmarrje. Por nuk është e drejtë e barabartë nëse

një deputet, i cili ka mbi 10.000 vota nuk zgjidhet deputet dhe zgjidhet një grua e cila i ka 5.000 vota. Mos më keqkuptoni. Prandaj, ju kisha lutur, se kemi diskutuar shumë, ka pasur propozime që të ulet ai 30%-shi. Por unanimisht jemi marrë vesh që të ruhet 30%-shi nga lista përfundimtare dhe mendoj se kjo nuk është diskriminuese por është një diskriminim pozitiv i cili është aktual vetëm në Kosovë, edhe ndoshta me ndonjë vend që ka dal nga lufta, në Bosnje e diku tjetër, por jo edhe në vendet tjera demokratike, sepse garohet në mënyrën më demokratike.

Dhe çështja tjetër, sa i përket pakicave. Konsideroj se i kemi pasur dy përfaqësues të pakicave. Është gjithçka në rregull, pakicat edhe në këtë mandat me Kushtetutë do t'i kenë vendet e rezervuara dhe do të garojnë edhe për vendet, 100 vendet drejtpërdrejtë. Nuk po di tash, a ka ma demokratike se 20 vende t'i kenë të gatshme dhe të garojnë prapë për 100 vende.

Dhe, krejt në fund. Pajtohem me deputetin tash, ish zëvendëskryeministrin, që ndoshta do të duhej që nga vullneti i mirë të amendamenteve, të kemi parasysh, ne kemi punuar natën, ka qenë një procedurë e shkurtër dhe mund të ketë ndonjë gabim, por ndonjë gabim eventual do ta përmirësojmë. Këto do të ishin që desha të them në pika të shkurtra. Unë ju kisha lutur që amendamentet që do të vijnë do të jenë konform marrëveshjes me përfaqësuesit e subjekteve politike dhe mekanizmave tjerë e të mos dalim tash që të ndërrojmë konceptin. Nëse e ndërrojmë komplet konceptin atëherë me siguri se nuk do t'i kemi votat e përfaqësuesve të subjekteve politike parlamentare, po flas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Jashari, e ka fjalën!

KAQUSHA JASHARI: Nuk kam diskutim, por reaguim në shpjegimin e zoti Hysenit. Ai tha që ky Kuvend ka votuar 5% dhe s'kemi çka të diskutojmë! Pse diskutojmë për ligjin? Për me ndryshuar diçka.

E ka dhënë shpjegimin e plotësimit për shumë ndryshime, pse mos me pas edhe këtë kërkesë. Unë mendoj se amendamenti i cili është i përgatitur duhet me ardhur gjithashtu sikur edhe propozimet tjera në votim. Shumë vetë kemi propozuar 3% dhe s'po dua tash të shpjegoj pse. Ka arsye. Ende nuk jemi shoqëri me parti të profilizuara, prandaj ka nevojë edhe ky propozim me hy...

(Reagim)

E përmenda emrin e kryesuesit, por unë po reagoj pse merret si e kryer 5% se kemi votuar një herë. Po, edhe ligjin e kemi votuar një herë, por edhe po e plotësojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë thash edhe më herët që e drejta me bë amendamente në ligj është sot, sepse besoj se nesër duhet të vijë në lexim të dytë, meqë e kemi miratuar edhe procedurën e shpejtë. Andaj, duhet të ju njoftoj se në sallë janë 81 deputetë. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratim në parim të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tani:

Konstatohet se me 76 vota "për", asnjë "kundër", asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

Në rend dite kemi pikën e pestë, meqë e kemi kapërcyer radhën:

5. Shqyrtimi i rekomandimit të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës për shkarkimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 41 të Ligjit Numër 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 tetor 2010, i ka rekomanduar Kuvendit shkarkimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës Hashim Rexhepi.

Tani lidhur me këtë, kërkoj që të deklarohen në fillim kryetarët e grupeve parlamentare dhe pastaj nëse deputetët dëshirojnë, ta marrin fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Buja e ka fjalën, edhe pse e ka thënë fjalën edhe më herët, por sipas rregullave...

RAMË BUJA: Nëse duhet me ri-thënë fjalën time, po e ri-them, por problemi është që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është për ta votuar këtë shkarkim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, është OK!

Grupi Parlamentar i AAK-ës – OK.

Grupi Parlamentar i AKR-ës – OK.

Grupi Parlamentar i LDD-ës – OK, nuk ka të paraqitur.

Grupi Parlamentar 7+, s'ka të paraqitur.

Grupi Parlamentar SLS, s'ka të paraqitur.

Grupi Parlamentar për integrim, s'ka të paraqitur.

Për të diskutuar është paraqitur deputeti Skumbin Demalijaj!

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Është qëndrim i imi personal që kjo të shtyhet deri me marrjen e verdiktit apo aktgjykimit në gjykatat e Kosovës, për shkak se

(Reagim)

Unë nuk marr pare për këtë, po flas për ligjet që janë në fuqi, dhe kërkesa juaj si Grup parlamentar dhe koalicion qeverisës me dhunë e keni bërë guvernator, por kur ju ka dëgjuar jashtëligjshëm po mundoheni me interpretuar para qytetarëve dhe me shkatërruar institucion. Sot ka krizë financiare. Guvernatorin e keni në burg, kjo ka qenë rrjedhoja e qeverisjes tuaj.

Duhet të merret vendimi gjyqësor. Vetë guvernatori ka kërkuar që të suspendohet përkohësisht deri në marrjen e vendimit. Në Kuvend ka ardhur e njëjta kërkesë më herët që të shkarkohet. Nuk ka mund Kuvendi me bërë një gjë të tillë pa ia plotësuar kushtin tremujor që është me ligj, sepse edhe me

vetë ligjin, kur është hartuar për Bankën Qendrore, ia keni dhënë mandatin pesëvjeçar duke e shtyrë jashtë mandatit që ka qenë i përkufizuar nga vetë votimi i Projektligjit.

Kam qenë kundër që ai të bëhet guvernator, në fillim, me disa deputetë, por keni insistuar, është edhe vetë forma e veprimit dhe dihet kush ka votuar dhe kush jo. Është kërkesë pra e imja personale që të merret vendimi gjyqësor dhe atëherë të bëhet kjo, sepse jo tash ta shkarkojmë një njeri që ka kërkuar vetë suspendimin nga Bordi, derisa përfundon gjykimi. Neve kemi pasur rastin në media ta shohim gjyqin si po zhvillohet. Katër pika të aktakuzës iu kanë hequr, janë në pyetje edhe tri dhe në qoftë se ai del i pastër nga aty, mendojmë se duhet ta vazhdojë punën ose të fillojë një proces tjetër i zgjedhjes apo i shkarkimit, ekzistojnë procedura ligjore. Në këtë rast, them se, jo për atë që t'i drejtohet një deputeti dikush se a ke marrë pare për këtë çështje, por po e them se vetë guvernatori kur e ka paraqitur raportin këtu personalisht i jam drejtuar se ai vetëm e ka lexuar raportin dhe kur e kemi shqyrtuar ne, nuk ka qenë prezent dhe kemi pasur kërkesa pse ai të mos jetë prezent deri të japë përgjigje para deputetëve të Kuvendit. Dhe, vetëm keni qeshur dhe ia keni kaluar të gjitha raportet herë pas herë për derisa ai e paska pas drejtuar Bankën Qendrore aq dobët, e ka menaxhuar aq keq. Jam kah flas nga parimet bazë, reale që ta shtyjmë për një kohë të caktuar deri sa të jetë verdikti, se patëm raste edhe në sekretar permanent në Ministrinë e Shëndetësisë e shkarkuan dhe e suspenduan e të gjitha por sot është në vendin e tij të punës dhe vazhdon me punën. Është pra qëndrim imi personal. Faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Rrustem Mustafa e ka fjalën!

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë shpreh habinë time pse deri sot nuk është bërë ky shkarkim. Më vjen keq dhe e ndjej veten keq kur në vendin tim, me kapacitetet e vendit tonë, qofshin ato financiare, qofshin në pasurin e vendit, njerëzit sikur ky kanë ardhur në shprehje me udhëheq, siç është Banka Qendrore e vendit tonë. Kam drojën se ai person që nuk është dashur me kanë, unë jam edhe prej deputetëve që hapur kur është miratuar kërkesa për me qenë ai drejtor, jam kanë kundër. Por unë shpreh dyshimin se ai ka lidhje me strukturat tjera

që i drejtojnë këto punë dhe deri tash është mbrojtur.

Kërkoj nga deputetët që sa më shpejt të heqin dorë nga përkrahja e tyre dhe të mos lejojnë më që të vijnë kësi njerëz të udhëheqin kapacitetet tona as financiare, as edukative sepse jemi në shekullin XXI, i njohim të gjithë, njihemi mirë shumë në mes veti dhe të mos lejojmë sepse është lehtë me ardhur deri te informatat që të vijnë kësi njerëz me kapacitete të dyshimta edhe në të kaluarën, edhe në sotmen, edhe me mundësi që në të ardhmen të krijojnë dëm vetvetes së tyre, familjes së tyre dhe vendit tonë.

Unë thërras të gjithë që sa më shpejt ta kryejmë këtë punë dhe të votojmë për shkarkimin e njerëzve të tillë dhe shumë të tjerëve, dhe uroj që sa më shpejt, nga detyra e tyre që padrejtësisht i mbajnë, kurse neve pa vetëdije ose me qëllim i kemi qitur aty. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Smaka e ka fjalën!

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryesues!

Ministra,

Deputetë, të respektuar,

Në këtë etapë çështja Hashim Rexhepi është çështje juridike. Nuk ka më këtu politikë. Prandaj, do të duhej të flisnim me gjuhën juridike, kësisoj. Unë plotësisht akordohem me pikëpamjet e zotëri Shkumbin Demalijajt që i prezantoi sipas gjykimit tim në mënyrë korrekte. Kjo është një.

Dy. Tani për tani, janë krejt hipoteza se është apo s'është. S'ka aktgjykim, prandaj mund të ndodhë, mund të ndodhë pra që do të lirohet. Kjo është kjo. Dhe, ne do të duhej gjithmonë të jemi konsekuentë dhe konsistentë me dispozitat ligjore aplikative, në këtë rast, valide, sipas standardeve ndërkombëtare. Është i suspenduar personi, prandaj të presim. Nuk është në marrëdhënie pune, nuk i gëzon privilegjet nga puna as në punë, prandaj edhe në funksion e kështu me radhë. Vlen për ta thënë këtë. Unë kam qenë kundër dhe atëherë kam votuar kundër. Për këtë kam mjaft për të thënë, ngjashëm me diçka çka tha zotëri Remi. Mirëpo, kjo nuk është akute. Është akut parimi. Ju lutem!

Tash e ngris një çështje: ku janë ata dhe ato që me aq ngulm e suportuan, e stipuluan, e stimuluan atëherë kur u zgjodh. Kishte vërejtje shumë serioze. Ku mbetet fytyra e tyre? Ju lutem, ku është ndërgjegjshmëria, ku është moraliteti dhe ku është përgjegjshmëria? Kjo nuk është në rregull absolutisht, që nga motivet politike të bëhen si me thënë seleksionime, shpeshherë negative.

Tani për tani, zotëri kryesues dhe deputetë të nderuar, unë angazhohem që çështja juridikisht të trajtohet dhe të kalojë më tutje. Të presim aktgjykimin nga gjykata kompetente. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nait Hasani e ka fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për dy ministrat!

I falënderoj edhe deputetët ish ministra tash që kanë ardhur këtu që po na marrin pjesë në seancë drejtpërdrejt dhe falënderoj edhe kolegët që dalin në mbrojtje të një veprimi të një njeriu që ka qenë dhe ka bërë vepër, mund të them, kriminale. Është mirë, pikërisht, po ashtu nga deputetët që pas disa muaj ose një viti a dy gati u bënë kur e kemi votuar, që kemi qenë kundër me këmbëngulje që njerëzit e tillë të cilët i kanë shkaktuar dëme Kosovës që ngaherë, jo vetëm sot të zgjidhen në këto pozita ndërsa tash deputetët po edhe Qeveria, po edhe ministrat dhe të gjithë e kanë kuptuar se kanë gabuar atëherë kur e kanë zgjedhur këtë njeri.

Ky është një nga vlerësimet pozitive që në fund të mandatit ky Kuvend e kupton që këta njerëz nuk duhet të zgjidhen.

Kjo është e mirë që në mandatin e ardhshëm kur parlamenti i ardhshëm do të zgjedhë guvernatorë, ministra, edhe deputetë të mos i zgjedhë njerëzit e tillë sepse janë turp i Kosovës, janë njerëz të cilët i kanë shkaktuar dëme Kosovës, janë njerëz të cilët e kanë torturuar Kosovën për vite – vite të tëra, në mënyrën më të tmerrshme, ndërsa tash edhe në mënyrë financiare e terrorizojnë Kosovën.

Kurrkush nuk di cili është kapitali i tij, apo cilët janë transaksionet që i ka me njerëzit e tij. Unë e kam dosjen komplet të tij, të hershme dhe të tashmen si guvernator i bankës. Nga të dyat...

(Ndërhyrje)

E ka prokurori! Edhe për ju e ka... kështu që secili duhet ta ketë parasysh që ata që do të votojnë për njerëz të tillë ta kenë një ndërgjegje të pastër se votojnë për të ardhmen e fëmijëve tanë. Pra, të

bëjmë përpjekje që ta ndërgjegjësojmë veten dhe tjerët se po votojmë pikërisht për njerëz të cilët i kanë shkaktuar dëm dhe vuajtje këtij populli.

Kërkoj që të paktën ky parlament dhe parlamenti i ardhshëm t'i ketë parasysh pikërisht sepse presidenti i shkarkuar, i cili me vetëdije apo pa vetëdije, zoti Fatmir Sejdiu na zgjodhi prokurorët e gjykatësit të cilët na kishin torturuar për vite të tëra dhe i bëri përsëri gjykatës, i bëri përsëri prokurorë, të cilët prokurorë dhe gjykatës do ta dënojnë tash Fatmir Sejdiun për veprat e veta që i ka bërë herët dhe tash. Pikërisht ata do t'i dënojnë edhe këta njerëz që tash janë nëpër burgje. Unë mendoj që ky Kuvend, është vonuar në shkarkimin e tij, por më vjen mirë që sot e ka kuptuar drejt këtë shkarkim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismet Beqiri e ka kërkuar fjalën!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Unë ju kisha lutur juve si kryesues me respektuar rendin e ditës, sepse nuk jemi në këtë rend dite dhe realisht të gjithë po apelojmë mos me bë fushatë dhe po bëjmë fushatë. Po ju lus, domethënë që si kryesues, me mirëkuptim edhe ndaj kolegëve, mos me u marrë me punët të cilat as nuk janë tash në rend dite, as nuk është ndonjë kompetencë shumë e madhe me dit, nuk i ka bërë individ për zgjedhjen e dikujt. Ky Kuvend e ka bërë zgjedhjen edhe të këtij guvernatori. Nëse kemi përgjegjësi, kemi si Kuvend, por edhe tjerat që u përmendën, nuk zgjedhin një individ institucionet por janë procedurat dhe nëse ka pasur vërejtje është vendi ku me i thënë, prandaj po ju lus që të mos keqpërdoren, do të thotë, minutat tonë në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur nuk ka. Në sallë janë 80 deputetë. Vazhdojmë me votimin e rekomandimit të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Hashim Rexhepi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Faleminderit! Konstatoj se me 67 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi rekomandimin e Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Hashim Rexhepi.

Vendimi për shkarkimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i dërgohet presidentit të Republikës për veprim të mëtejshëm. Faleminderit!

Po vazhdojmë. I kemi shkurt edhe... Urdhëroni! Po, doni pushim për drekë. Atëherë, deri në ora 14,30 bëjmë pauzë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

Drejtimit të seancës e merr z. Ibrahim Gashi, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Të nderuar, kolegë deputetë,

Ju lutem t'i zëni vendet dhe po vazhdojmë!

E kam një njoftim. Anëtarët e komisioneve funksionale që duhet të punojnë në amendamentimin e Ligjit zgjedhor do të tubohen në orën 17 për shkak se s'kemi kuorum për të proceduar votimin në lexim të dytë të ligjeve që i kemi në rend dite.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës.

Lus deputetët që janë këtu afër, le të kthehen në sallë që të mund të fillojmë me punë.

Në sallë kemi 60 deputetë dhe na duhet edhe 1 deputet për të filluar punën.

Tani në sallë kemi 61 deputetë, vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për punë të jashtme, nëse do, që të marrë fjalën, ose përfaqësuesin e grupit punues.

Fjalën e ka deputeti Alush Gashi!

ALUSH GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin, ka analizuar debatin që është zhvilluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ka shprehur pikëpamjet e veta në dy amendamente të cilat i ofron për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Atëherë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raport.

Mirë, atëherë në emër të Komisionit për buxhet, fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Është rendi, prandaj edhe e kërkoja fjalën.

Vërtet amendamentet dhe Ligji nuk përmban implikime buxhetore dhe Komisioni ka rekomanduar që të miratohet këtu dhe ka një rekomandim të veçantë që nuk është i shkruar këtu që ishalla ata që duhet ta respektojnë protokollin e respektojnë tamam ashtu si duhet. Nga këto që i shohim, ne kemi pasur edhe një ligj përpara por nuk është respektuar në asnjë institucion.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës, të paraqitur në raport.

Në sallë ka numër të mjaftueshëm të deputetëve për të hyrë në votimin e amendamenteve. Shkojmë me amendamentin e parë:

Amendamenti 1.

Regjia dhe deputetët gati për votim.

Në sallë janë 64 deputetë.

Votojmë tash:

Konstatohet se me shumicë votash u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se miratohet amendamenti 2.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 1 “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për protokollin e shtetit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për rezervat shtetërore të mallrave dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e komisionit funksional për ekonomi, tregti, industri, Muzejene Selmani, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, nëse e do fjalën.

Atëherë, ftoj kryetarin e Komisionit për buxhet e financa, deputetin Gani Koci të marrë fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit!

Më duhet ta marr, për disa ligje, kështu amendamente dhe ligjin në tërësi, fjalën dhe kërkoj fjalën në qoftë se bëhem i tepërt, se po thonë s’ka dhe unë po ju them se amendamentet vërtet nuk përmbajnë implikime buxhetore, por Ligji si tërësi edhe në shqyrtimin e parë është konstatuar se përmban implikime buxhetore por nuk ka një kosto sepse nuk është bërë një planifikim nga ana e Qeverisë ose ministrive përkatëse lidhur me koston e këtij projektligji.

Komisioni për buxhet e financa e ka shqyrtuar edhe kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe as korniza afatmesme e shpenzimeve ose koston e këtij buxheti nuk e përmban në kuadër të vetvetes prandaj e mora fjalën që vërtet për derisa ne nuk e kemi shqyrtuar akoma në Kuvend kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetin për vitin 2011 që Qeveria të parasheh mjete sepse ky ligj nuk do të thotë se do të ndan mjete të njëhershme por është ligj në vazhdimësi që kërkon të mbahen rezerva shtetërore, por këto të futen si njësi të veçantë në kuadër të kornizës afatmesme të shpenzimeve. Kjo ishte arsyeja për të cilën e mora fjalën dhe ju kërkoj falje në qoftë se e marr edhe herëve tjera fjalën, për ligje tjera, dhe do ta marr.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Meqë nuk kemi diskutues tjerë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, sipas radhës së paraqitur në raport. Vazhdojmë me amendamentin e parë:

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7, të fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 7.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi 64 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të Projektligjit në tërësi dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 6 abstenime dhe 1 “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për rezervat shtetërore të mallrave. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për administratë publike, pushtet lokal dhe media apo raportuesin nga komisioni, që të marrë fjalën. Do të thotë, nu ka të paraqitur për diskutim.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 23 amendamente nga komisioni.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport.

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë amendamentin e parë:

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 9.

Amendamenti 10.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 22.

Amendamenti 23, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 23.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi 75 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 67 vota “për”, 5 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/33 për blegtorinë e Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/33 për blegtorinë e Kosovës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentin e propozuar.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për bujqësi, pylltari, zhvillim rural dhe planifikim hapësinor i cili nuk është këtu dhe nuk është paraqitur askush në emër të komisionit dhe as komisionet tjera nuk janë paraqitur, andaj vazhdojmë me votimin e amendamentit të vetëm në këtë projektligj të propozuar.

Amendamenti 1.

Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se u miratua amendamenti i parë dhe i vetëm në këtë projektligj.

Ju ftoj të votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentin e miratuar.

Në sallë kemi 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Ligjit në tërësi dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, 5 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 2004/33 për blegtorinë e Kosovës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për legjislacion dhe gjyqësi, nëse do ta marrë fjalën. Nuk ka të paraqitur. Atëherë, në Projektligj janë propozuar gjithsej 5 amendamente nga komisioni funksional.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport. Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e amendamenteve dhe fillojmë me amendamentin e parë.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 5.

Tani ju ftoj të votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentin e miratuar.

Në sallë kemi 77 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Projektligjit në tërësi dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri, dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e komisionit funksional për punë të brendshme dhe siguri, zotin Rustem Mustafa, nëse e do fjalën që të paraqes raportin me rekomandime. Atëherë, nuk e ka kërkuar fjalën. Atëherë, ftoj komisionin për buxhet e financa, kryetarin e tij zotin Gani Koci, i cili e ka kërkuar fjalën, le ta merr fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është e njëjta çështje që thash edhe për një ligj tjetër paraprak rreth kostos buxhetore dhe meqë është ministri i Punëve të Brendshme këtu, unë desha të them se vërtet në dy vitet e para të implementimit të këtij ligji, ka një kosto diku prej afër 2 milionë eurove, nga të cilat 1.500.000 për shpenzime kapitale, që parashihet ndërtimi i një depoje qendrore për mbajtjen e armëve, municioneve dhe pajisjeve me municion, si dhe për depo lokale për të njëjtin qëllim dhe ajo çka është e rëndësishme është se as në kornizën afatmesme të vitit 2010-2012 nuk kanë qenë të parapara këto mjete buxhetore, po siç e thash edhe më parë, edhe tani po e përsëris, edhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve të vitit 2011-2013 nuk janë të parapara për implementimin e këtij projektligji, prandaj për deri sa ne si Kuvend nuk e kemi shqyrtuar akoma kornizën afatmesme të shpenzimeve, dhe buxhetin për vitin 2011, mendoj që ka kohë që Qeveria respektivisht ministria përkatëse të parashih këto mjete në mënyrë që ky ligj të jetë i implementueshëm pas miratimit këtu në Kuvend.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për diskutim është paraqitur edhe deputeti Basri Musmurati.

BASRI MUSMURATI: Unë vetëm do të flas në emër të Komisionit për punë të brendshme dhe siguri. Është shqyrtuar ky projektligj, disa herë dhe duhet falënderuar posaçërisht sponzoruesin, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në këtë ligj kanë kontribuar mjaft shumë edhe institucionet që ndërlidhen me sektorin e sigurisë, siç është Policia e Kosovës, Doganat, Organizatat ndërkombëtare, UNDP-ja, EULEX-i, OSBE-ja si dhe grupet tjera të interesit dhe kanë dhënë kontributin e tyre që ky projektligj të jetë shumë, shumë i kompletuar.

Andaj kërkoj nga deputetët që ta votojnë në tërësi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Unë nuk e di në fillim se do të flisni në emër të komisionit. Sidoqoftë faleminderit! Për diskutim është paraqitur deputeti dhe anëtari i Kryesisë Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: U paraqita shpejt, se e di që vjen neni 1, e unë e kam fjalën për nenin 1, nëse s'ka tjerë parimisht për ligjin, nëse s'ka tjerë të interesuar.

E pra, amendamenti 1, thotë që për nenin 1.1 shtohet edhe "Inspektoriati policor i Kosovës në renditjen e institucioneve të autorizuar të sigurisë". Po edhe vazhdimi ku thotë: ndërsa te pika 1.2 fjala "armatimin" zëvendësohet me fjalën "municionin". Nuk është studiuar mirë teksti, të cilit i mbi vihet sepse është "armët", masandej është edhe "municioni", kështu që nuk ka saktësi çka kërkohet.

Me siguri, kur e kanë ndërtuar amendamentin, ai - kush e ka ndërtuar, s'është kujdesur shumë për tekstin. Kështu që, duhet të shpjegohet çka po do, ai që e ka bërë.

Nëse nuk ka ndonjë shpjegim, unë do të përpiqem ta jap formulimin, por le ta shpjegojë ai që e ka bërë këtë. Është pjesa e dytë e amendamentit. Ajo që ka të bëjë me pikën 1.2.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti deputet, e doni fjalën? Atëherë, fjalën e ka kryetari i komisionit, deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Nuk jam i sigurt, se a e kam kuptuar drejt zotin deputet, Sabri Hamitin, mirëpo po përpiqem me shpjeguar.

(Ndërhyrje e Sabri Hamitit...)

Teksti, nëse është saktësim i drejtpërdrejtë, “armatimi” nënkupton armë, “municioni” është pjesë e armëve. Domethënë, kjo është dashur të jetë. Domethënë nuk ka kurrëgjë tjetër, më shumë profesor.

Janë edhe do tjera. Që në Ligjin për armë, mos me ndodh me pas shkëputje nga nenet tjera, sepse janë nenet tjera që e plotësojnë një nen tjetër, kështu që për këtë ligj, ju them me përgjegjësi të lartë, përveç kapaciteteve të Ministrisë, e të komisionit, janë angazhuar edhe kapacitete tjera ndërkombëtare që ne iu besojmë dhe janë duke na ndihmuar për ngritjen e krejt kapaciteteve ligjore për infrastrukturën ligjore, dhe nuk do të ketë problem.

Eventualisht, ndonjë problem teknik, ose gjuhësor, nëse del, aty mund të ndërhyhet pa ndonjë problem. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Edhe zoti Mustafa dhe, kush do qoftë në këtë Parlament, duhet me ditë që unë formalisht s’paraqitem, se s’kam kurrfarë leverdie të studioj tekste që s’e kam një arsye.

Ky amendament thotë: Fjala “armatimin” zëvendësohet me fjalën “municionin”. Dhe, më së pari, në tekst “armatimin” s’ekziston hiq. Domethënë i referohet një fjale inekzistente.

E dyta, ekzistojnë armët, ekziston municioni. Nëse armatimi zëvendësohet me municionin atëherë bëhet dy herë municioni. Unë po dua saktësim: Çka po donë këta? A po donë me thënë që “armët” hiqet por jo me “municionin” se atëherë do të kemi, nënkupton “municionin”, “municionin”, pajisjet e tjera. Ky është problemi. Që tekstin ku e keni.

KRYESUESI: Faleminderit! Për këtë pikë është... Nëse keni diçka, zotëri Mustafa mund të merrni fjalën.

RRUSTEM MUSTAFA: Është gabim gjuhësor. E falënderoj profesorin.

Me siguri është gabim gjuhësor. Pra, është gabim teknik dhe do të përmirësohet besoj, dhe janë komisionet parlamentare dhe të Kryesisë së Kuvendit që i autorizon për ta ndryshuar.

(Ndërhyrje: Sabri Hamiti...)

KRYESUESI: Mirë, faleminderit, të dy deputetëve për kontributin. Është paraqitur edhe deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Mendoj që u krye, zoti kryesues. Hiqet te pika 1.2 në amendament fjala “armatimi” dhe zëvendësohet me fjalën “municionin”, se nuk ka kuptim, mbetet qysh është në ligj.

KRYESUESI: Atëherë, për amendamentin e parë, me këtë korrigjim që e bëri bashkërisht edhe kryetari i Komisionit edhe diskutuesit e hedhim në votim këtë propozim me këtë ndryshim të vogël në formulim, amendamentin e parë.

Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Faleminderit! Konstatoj se u miratua amendamenti 1.

Vazhdojmë me amendamentin e dytë.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 2.

Vazhdojmë me amendamentin 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua edhe amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 10.

Amendamenti 11.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 11.

Amendamenti 12.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 12.

Amendamenti 13.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 13.

Amendamenti 14.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 14.

Amendamenti 15.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 16.

Amendamenti 17.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 17.

Amendamenti 18.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 18.

Amendamenti 19.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 19.

Amendamenti 20.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 20.

Amendamenti 21.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 21.

Amendamenti 22, i fundit.
Votojmë tash:
Konstatoj se u miratua amendamenti 22.

Dhe, tani ju ftoj të votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.
Në sallë kemi 78 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e Projektligjit në tërësi dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, 3 abstenime dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për pajisjen me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologjinë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për metrologji, dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin që në emër të komisionit funksional, të marrë fjalën. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit që më dhatë fjalën, kryesues!

Atëherë po i referohem mbledhjes së komisionit, që kemi pasur, komisionit funksional dhe e kemi shqyrtuar edhe në grupin e punës këtë projektligj. Kemi vendosur disa amendamente shtesë, me të cilat mendojmë se i kemi kontribuar asaj që është kërkuar nga seanca e debatit në parim, bashkë me anëtarët e Qeverisë tjerë që kanë marrë pjesë, për ato ndryshime dhe plotësime që mendojmë se i bëjnë mirë këtij projektligji, prandaj e kenë dhe mund të votoni këto amendamente.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Atëherë lus deputetët që të vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Votojmë amendamentin e parë. Regjia dhe deputetët gati për votim, votojmë tash:

Amendamenti 1.

Konstatohet se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 8.

(Ndërhyrje)

Për cilin amendament, deshët të flisni? Me kohë, sekretar, nuk e kemi vërejtur ndoshta!

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 9.

Amendamenti 10, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 10.

Tani ju ftoj të votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi 70 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për metrologjinë. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në emër të komisionit funksional, nuk kemi të paraqitur për diskutim. Fjalën e ka kërkuar tash më në fund deputetja, kryetare e Komisionit Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Përhëndetje për ministrat dhe të gjithë të pranishmit!

Do të kërkoj ndjesë se gjatë lidhjes së ligjit një faqe e Ligjit mungon dhe këtu amendamenti numër 3 nuk është, ndërsa në çështjen e debatimit të komisionit, në mbledhjet e komisionit memorandumit shpjegues është ajo faqe e ligjit mirëpo kur është lidh ligji në shpejtësi, me sa duket 1 faqe e kanë harruar, kështu që të kemi kujdes se janë 4 amendamente. Kërkoj ndjesë. Nuk di qysh ka mund të lëshohet, ndoshta është gabim teknik mirëpo në përgjithësi Projektligji i ka 4 amendamente.

KRYESUESI: Ne këtu i kemi, zonja deputete 5 amendamente, nuk e di si qëndron puna te deputetët. Atëherë, siç dëgjuam, për këtë projektligj janë propozuar gjithsej 5 amendamente nga komisioni funksional. Ftoj që të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Amendamenti 1.

Konstatohet se u miratua amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se u miratua edhe amendamenti 5.

Tani ftoj deputetët që të votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë janë prezentë 71 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër” 2 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për tregtinë e mallrave strategjike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetaren e komisionit funksional për tregti, ekonomi, industri, zonjën Muzejene Selmani që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se parëz, ndoshta më keqkuptuat, mirëpo në ligjin tim mungonte një faqe dhe për atë arsye edhe e dhash arsyetimin.

Nëse e marrim çështjen e amendamentimit të Projektligjit për mallrat strategjike, mund të them se është ligj shumë me rëndësi, të cilin është dashur komisioni në mënyrë më të përshpejtuar të procedojë për arsye se Kosova duhet të jetë e përgatitur në anën e legjislacionit për hyrje në OKB dhe për këtë arsye lus deputetët e Kuvendit që t'i votojnë këto amendamente.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Meqë diskutues tjetër të paraqitur nuk ka, vazhdojmë me votimin e amendamenteve, sipas radhës të paraqitur në raport.

Shkojmë në votimin e amendamentit të parë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Amendamenti 1.

Konstatoj se u miratua amendamenti

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5, të fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se u miratua amendamenti 5.

Tani ju ftoj të votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi të pranishëm 76 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 1 abstenim dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Ligjin për tregtinë e mallrave strategjike. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar

Komisioni funksional për punë të brendshme dhe siguri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e strategjisë për ri-integrim të personave të riatdhesuar, dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pra, strategjia për ri-integrim është një ndër dokumentet kryesore edhe për me marrë strategjinë për liberalizimin e vizave dhe po ashtu në implementimin e ri-integrimit të personave të ri-pranuar dhe shikohet si nën llupë edhe nga Komisioni Evropian se na sa jemi seriozë, natyrisht se ka implikime buxhetore të cilat janë paraparë në kornizën afatmesme, por arsyeja pse është prurë me u votuar prapë në Parlament është që të fuqizohet, që dinamika buxhetore të respektohet dhe natyrisht se kjo e fuqizon edhe mundësinë e organizimit të një konference të donatorëve në mënyrë që të kemi lehtësime dhe kosto që janë për ri-pranimin dhe ri-integrimin e qytetarëve që kthehen dhe të jetë sa më i qëndrueshëm dhe të ofrohem sa më afër gjendjes kur do të udhëtojmë pa viza. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Në emër të komisionit funksional, fjalën e ka deputeti Rustem Msutafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Duke pa se ju jeni efektiv dhe po e drejtoni seancën shkurt dhe mirë, unë do të jem i shkurtër.

Ministri foli për strategjinë dhe ne në komision kemi konstatuar nevojën e domosdoshme që strategjia duhet të implementohet në disa faza dhe se determinojnë nevojën e hartimit të planeve të veprimit.

Konsiderojmë se ky dokument ka elemente të duhura për mbështetjen e personave për integrim të tyre në Republikën e Kosovës, andaj ju rekomandojmë që ta përkrahni dhe miratoni këtë strategji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i komisionit! Një sqarim të shkurtër, dëshiron ta japë edhe një herë ministri. E keni fjalën, ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Vetëm një sqarim, se edhe Plani i veprimit është i kryer, që në mënyrë precize tregon cili agjencion, cili element duhet t'i implementojë detyrat e veta, është i harmonizuar edhe me Komisionin Evropian, prandaj Plani i veprimit është një dokument edhe më i mirë sa strategjia. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Në emër të Komisionit për legjislacion dhe gjyqësi, fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo, unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Natyrisht se e kemi shqyrtuar me vëmendje propozimin e Qeverisë së Kosovës dhe njëkohësisht edhe rekomandimin e Komisionit për punë të brendshme dhe konsiderojmë se propozimi që ka dalë nga Qeveria e Kosovës është konform ligjit aktual në fuqi dhe kandidatët e propozuar, meqë në rekomandim të komisionit nuk janë shkruar kandidatët, po e lexoj atëherë në vendim të Qeverisë i plotësojnë të gjitha kriteret me u emëruar në këto detyra, duke filluar nga mbikëqyrësi kryesor...Në cilën pikë?

(Ndërhyrje deputetësh)

KRYSUESI: Atëherë, vazhdojmë me deputetët. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës, deputeti Armend Zemaj. Jemi në pikën e pesëmbëdhjetë tashti...

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Zotëri ministër, edhe Grupi Parlamentar i LDK-ës e ka shqyrtuar këtë rekomandim të komisionit funksional dhe ne e mbështesim, dhe e mbështesim edhe Vendimin i cili ka dalë për zbatimin e strategjisë, sepse ky është vendim për ndarjen e mjeteve apo për ri-alokimin e mjeteve që kjo strategji të zbatohet.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-ës e mbështetë. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit, zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës, nuk kemi të paraqitur. Në emër të Grupit të PDK-ës, nëse ka? Ramadan Avdiu e ka fjalën!

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë të respektuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet rekomandimin e Komisionit parlamentar për punë të brendshme dhe siguri për miratimin e vendimit të Qeverisë Numër 13-146 lidhur me zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të ri-atdhesuar.

Deputetë të nderuar,

Ne të gjithë e dimë se kemi një numër të konsiderueshëm të qytetarëve tanë të cilët jetojnë, kanë jetuar apo kanë bërë përpjekje që të gjejnë strehë në vende të tjera. Një pjesë e tyre riatdhesohen në mënyra të ndryshme vullnetare, por ka edhe të tillë që detyrohen të riatdhesohen nga autoritetet e vendeve pritëse.

Deri në vitin 2006 pranimin dhe ndihmën për ri-integrim të personave të riatdhesuar e ka bërë UNMIK-u, IOM-i dhe UNDP-ia, por nga viti 2006 kjo çështje ka kaluar në kompetencë të institucioneve tona, ndërkaq nga ky vit, veçanërisht pas aprovimit të Ligjit për ri-pranim dhe pas nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale në mes të Qeverisë së vendit tonë dhe vendeve tjera pritëse, përgjegjësinë më të madhe në zbatimin e programit për ri-integrim të personave të riatdhesuar e bartë Ministria e Punëve të Brendshme.

Personat që riatdhesohen, e që nuk janë të paktë, duhet të priten, të ndihmohen për ri-integrim në shoqëri duke iu krijuar mundësi që të mos ndihen inferior në shtetin e tyre, prandaj Zyra e programit për ndihmë në riatdhesim duhet të ketë mjete të nevojshme për t'u siguruar të kthyerve integrim të plotë dhe krijim të kushteve për sigurinë e tyre fizike dhe socio-ekonomike.

Prandaj, të nderuar deputetë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e fton Kuvendin që të miratojë rekomandimin e Komisionit për punë të brendshme dhe siguri lidhur me vendimin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës fjalën tash e ka kërkuar Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

E pata kërkuar fjalën dhe u ndez mikrofonin por nuk e ke pa. Realisht, shumë shkurt: Aleanca e mbështet këtë propozim-vendim për strategjinë për ri-integrim. Mendojmë që është obligim shtetëror i Kosovës dhe nuk beson se do shumë koment. Mendojmë se prapëseprapë është e vonuar, mirëpo nuk është arsye për të mos qenë “pro”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-ës nuk kemi të paraqitur. Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-ës, fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e mbështet këtë projekt-strategji sepse është një nga kriteret kyçe që plotësohen testet tutje pas ligjit për ri-pranim apo riatdhesim, kjo strategji është një nga parametrat matës që në njëfarë forme e matë suksesin e këtij procesi dhe dua të besoj se institucionet e Republikës së Kosovës do të jenë të përgjegjshme që t’i plotësojmë këto kriteret sa më shpejt dhe t’i afrohem procesit të liberalizimit të vizave ashtu siç e kanë bërë edhe vendet tjera të regjionit. LDD, e mbështet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar 7+, fjalën e ka kërkuar deputeti Zylfi Merxha.

ZYLFI MERXHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I përshëndes ministrat,

Zonja dhe zotërinj, edhe ne 7+ e mbështesim këtë ligj, se është ligji shumë në rregull dhe duhet të kalojë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet, nëse ke mbaruar!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk kemi të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar për integrim, deputeti Numan Baliq e ka fjalën.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Ovo je jedna strategija koja je neobično važna s obzirom da se tiče reintegraciji vraćenih osoba, s obzirom da u svim zajednicama ima puno vraćenih... Mi u principu podržavamo takođe, međutim mislim da je u toku implementacija u toku svih narednih perioda koji se budu ticali ove teme, mora se posvetiti dužna pažnja reintegraciji svih zajednica, pripadnika svih zajednica koji su u pitanju i takođe moram da kažem da sredstva koja su izdvojena su veoma mala, da ne kažem, simbolična, da gotovo svima nama se obraća veliki broj građana koji su vraćeni od nekuda, koji nemaju osnovnih uslova za prvi prihvata, prema tome mislim da treba da se ozbiljnije u narednoj budućnosti pozabavimo

i implementacijom strategije, da ne bude ponovo jedan od onih strategija koja je samo doneta a nije izvršena. Hvala lepa!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Tash deputet të paraqitur për diskutim kemi vetëm një. Fjalën e ka deputeti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, kryesues!

Unë do të kisha lutur Qeverinë, ndoshta edhe qeverinë e ardhshme që këtë çështje ta trajtoj me më seriozitet. Unë e kuptoj se tani ka humb një durim dhe nuk dihet se çfarë veprime politike do të merren, por kjo çështje është e ndjeshme. Në rast se çështja e debimit të romëve është bërë një problem që diskutohet në qarqe më të larta evropiane, konsideroj se Kosova, si shtet i ri, shtet i dalë frik nga lufta bartë problemet e veta sa i përket problemeve financiare për t'iu siguruar një atdhesim apo një akomodim të duhur pakicave të cilat janë zhvendosë për arsye të njohura.

Unë do të kisha lutur edhe ministrin apo kushdo që të jetë ministër edhe në të ardhmen që të kihet kujdes me nënshkrimin e marrëveshjeve me shtetet evropiane sa i përket riatdhesimit. Mos të ngutet, për shkak se Kosova nuk është e përgatitur të pranojë të larguarit, ta quaj, nga disa vende, edhe me dhunë, njerëz të cilët u shkelen të drejtat e njeriut dhe dëbohen në vende të origjinës pa iu krijuar kurrfarë kushtesh.

Ne nuk jemi të përgatitur për të bërë një riatdhesim qysh mund të kërkojnë disa vende evropiane. Të paktën, Kosova duhet të ndihmohet financiarisht për këtë çështje. Nën një.

Dhe, e dyta. Duhet të krijohet edhe një klimë politike. Konsideroj se ngutja për të bërë vetëm memorandume duke premtuar se do të jepet udhërrëfyese për liberalizim të vizave nuk është real sepse faktet flasin... Kosova tani është një vrimë e zezë në rajonin e Ballkanit sa i përket këtij procesi, edhe të liberalizimit të vizave, edhe procesit integrues evropian. Ju vëreni tani se si dëshirohet të shpërblehet qasja vetëm për të biseduar me Kosovë – autoriteteve serbe për t'iu dhënë mundësia dhe aplikimi për një proces të integritimit evropian, ndërsa Kosova është në margjina apo nuk bëhet fjalë fare... Pavarësisht diskutimeve pozitive, që i dha zonja euro-deputete Fajon ku ishte në Kosovë por mendoj se edhe në këtë çështje nuk duhet të ngutemi sepse nuk kemi kushte si vend, si Kosovë... Kjo strategji që është bërë duhet të mbështetet, por me 200.000 euro sa do të arrijë ministri apo Qeveria të ndihmojë dhe për këtë qëllim kërkohet një përkrahje evropiane për këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Duke konsideruar të shteruar diskutimin lidhur me këtë pikë, kalojmë në votimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Në sallë kemi 73 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 2 abstenime dhe 1 “kundër” Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e strategjisë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë të rendit të ditës:

16. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale

Komisioni funksional për punë të brendshme dhe siguri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, nëse dëshiron? Do të thotë nuk dëshiron përfaqësuesi të marrë fjalën. Atëherë, në emër të Komisionit për punë të brendshme dhe siguri, fjalën e ka deputeti Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Ne, Komisioni për punë të brendshme dhe siguri kemi përkrahur dhe kemi votuar me konsensus të plotë lidhur me propozimin e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe kemi rekomanduar dhe i rekomandojmë Kuvendit edhe sot që të votojë për propozimin e këtyre anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Tash në emër të Grupit Parlamentar të PDK-ës, ftoj deputetin Bahri Hyseni ta ketë fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që gati sa isha në përfundim të asaj, por po shihet se kemi një efikasitet të jashtëzakonshëm dhe po i kalojmë më shpejt se që duhet.

Natyrisht, se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i mbështetë në parim propozimet që kanë ardhur nga Qeveria e Kosovës. Ne përshëndesim edhe rekomandimin që ka ardhur nga Komisioni për punë të brendshme, edhe pse nuk kanë shkruar emrat dhe ndoshta do të ishte e rrugës që t'i lexojmë emrat si Grup Parlamentar. Mbështesim, do me thënë propozimin që për mbikëqyrës kryesor shtetëror të Këshillit të propozohet:

zoti Ylber Topalli, kurse për mbikëqyrës shtetëror propozohet zoti Abdyl Behrami; zoti Rasha Saviq, zoti Shkodran Manaj dhe zoti Ruzhdi Jashari.

Grupi Parlamentar kërkon që deputetët e Kuvendit të Kosovës t'i mbështesin dhe t'i votojnë kandidatët e propozuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-ës, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar biografitë e të propozuarve. Njëherit mbështesim edhe rekomandimin e komisionit funksional sepse kështu e obligon edhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin e kemi miratuar kohë më parë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-ës do të mbështesë këtë propozim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-ës fjalën e ka kryetari i Grupit Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në kohë të mëparshme, kur dikush e gabonte pikën e rendit të ditës, i thoshim mungesë e koncentrimit, tash po i themi efikasitet, domethënë se kemi kaluar më shpejt. Është e çuditshme kjo punë. E po kthehem në pikë, se u ngut, domethënë përfaqësuesi i PDK-ës me shpjeguar.

Nëse i keni lexuar materialet, e shihni që personi i cili do të jetë kryesues i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është ish kryetar i Grupit Parlamentar ose kuvendor të PDK-ës në Ferizaj. Është një njeri, i cili, realisht është tipik partiak dhe tani neve na ka ardhur puna që... S'po kaloj te të tjerët, se gati njëjtë del situata, por po flas vetëm për atë që është propozuar për kryesues... del që Partia Demokratike e Kosovës tash, përpos institucioneve që i ka deri më tani do me na kontrolluar edhe të dhënat personale, me i pas njerëzit e vet.

Çështja tjetër është se ky person do të thotë ka qenë kryetar i Bordit, ose kryesues i Bordit të KRUK bifurkacionit, domethënë që është institucion rajonal i ujërave dhe kanalizimit dhe është ende, e ka pru me nënshkrim, përderisa njërin dokument e ka lënë vendin e zbrazët të vitit, do të thotë se është prapë një sistem i kamuflimit të dhënave, pak-ngapak, qysh jemi mësuar ne në Kosovë në këto 3 vjetët e fundit...

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk mund ta përkrahë këtë propozim. Mendojmë se nuk është propozim i mirë, nuk është propozim i mirë tani. Njerëzit që i kanë në parti kishte qenë mirë me i vendosur nëpër pozita politike se kanë mjaftueshëm, kanë shumë vende të lira nëpër pozita politike që nuk i kanë mbush deri më tani dhe nuk kanë nevojë me i sjell në institucione të cilat, për hir të korrektesës, për hir të Kushtetutës, për hir të ligjit, për hir të frymës demokratike duhet me qenë të paanshme.

Mendoj se Kuvendi i Kosovës, nëse edhe në seancat e veta të fundit, vazhdon me punuar kësisoj, vazhdon me instaluar një sundim të partive, tipik, do të thotë pa asnjë barrierë, pa asnjë mbrojtje... domethënë krejt pastër, atëherë dikush në të ardhmen ka me i pa njerëzit se çka kanë bërë.

Mendoj se në politikë, përpos punës aktuale, gjithë njerëzit duhet me pas një konsideratë se qysh kanë me u mbajtur mend një ditë kur dikush kthehet mbrapa dhe e sheh, e sheh historinë. Njerëzit normalë, në politikë i kushtojnë shumë kujdes asaj se si do të mbahen mend në të ardhmen. Njerëzit e përgjegjshëm mbahen përgjegjës edhe para vetvetes dhe para asaj që vijnë. Unë nuk e di qysh dikush, në këtë Kuvend, nëse e voton këtë propozim edhe një herë, edhe në seancën që ndoshta është e fundit ose e parafundit, ka me menduar qysh kanë me i pa në të ardhmen gjeneratat që vijnë kur kanë me i lexuar transkriptet dhe kanë me i pa vendimet të cilat i kemi marrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për replikë është paraqitur deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Jo vetëm sa për të replikuar ndoshta për atë çështje, por po më vjen mirë që i nderuari deputet tash është koncentruar për në fund të mandatit, sepse gjatë gjithë kohës ka qenë i pakoncentruar, kurse logjika që të mos propozojmë kandidatë pse kanë detyra publike është logjikë e mbrapsht. Pikërisht vendin për me propozuar në institucione publike dhe në vende në institucione me përgjegjësi pikërisht duhet të propozohen njerëzit të cilët kanë një të kaluar të pastër, kanë një biografi të pastër dhe kanë një profesionalizëm të cilët e kanë treguar nëpër detyra dhe organizime qofshin ato edhe politike dhe profesionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, një minutë, Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Faleminderit shumë! Mua nuk më ka ndodhur me ngatërruar pikën e rendit të ditës, sikur kolegut Hyseni dhe unë kam qenë i koncentruar gjithë kohën dhe nuk kam bërë kualifikime dhe ai ngatërrim ka ardhur si pjesë e frikës për kamuflimin që e bënë. Duhet me u ngut ky, duhet me u ngut shpejt e shpejt me i kaluar.

Dhe çështja është tjetër. Nuk thash që nuk bën me pas funksione publike. Të jemi të qartë, po jo funksione partiake. Unë fola për funksion partiak, nuk fola për funksion publik, të qenunit udhëheqës të partisë politike ngushtë, nuk është vetëm funksion publik, është funksion edhe partiak, edhe i ngushtë partiak bile. Faleminderit!

KRYESUESI: S'ka më... Po pastaj, s'ndalet më, zoti Hyseni! Unë kisha thënë të vazhdojmë në emër të Grupit Parlamentar të AKR-ës...

(Ndërhyrje)

Vazhdojmë me rendin e ditës, sepse u shterua... Mirë, mendoj se duhet të vazhdojmë dhe vazhdojmë me radhën e diskutuesve në emër të Grupit Parlamentar të AKR-ës deputetja Muzejene Selmani e ka fjalën.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-ës ka shqyrtuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencionit për Mbrojtjen e të Dhënave personale dhe Grupi Parlamentar i AKR-ës nuk i përkrah këta anëtarë të cilët i ka propozuar Qeveria me vendim të vetin për arsye se vijnë në aspektin nga vija politike, të cilës i takon vetë Qeveria. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-ës, fjalën e ka deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Vërtet është shqetësuese që agjencione të tilla, të pavarura, që votohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës e në veçanti Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, na propozohen njerëz ekskluzivisht militantë partiakë, bile që i kanë nga 2-3 dhe poste tjera edhe në organizata klandestine.

Mua po më çudit Lidhja Demokratike e Kosovës qysh e përkrah këtë propozim-liste! A jeni çkumuar me këtë koalicion apo nuk jeni çkumuar? Dhe, mos luani lojë dyfishë. Ju lutem këtu kemi militantë partiakë që i dimë, domethënë janë 3 militantë partiakë që nuk kanë lidhje me Agjencionin me këtë çështje, për mbrojtjen e të dhënave personale. Nuk kanë kurrfarë eksperience. Këtu është dashur të jenë ekspertë të kësaj lëmie, kanë mund dy partitë, që ende po vazhdojnë me këtë kumari, që e fundosën këtë vend e këtë shtet, dhe Grupi Parlamentar i LDD-ës nuk do t'i votojë. Edhe kishte me qenë e kulturuar politikisht, racionale dhe e moralshme që kjo listë të tërhiqet, të priten zgjedhjet e reja dhe vërtet për këtë agjencion kaq të rëndësishëm të vijnë njerëz kredibilë. Vërtet marrja kurrkujt copë s'po i hiçka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Nga grupet tjera parlamentare nuk kemi të paraqitur. Në fakt e kemi nga Grupi 7+, tash deputetin Sadik Idriz. E ka fjalën!

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Mi smo razmatrali i ostaje na savesti poslanika da li će glasati, ali ponavlja se po stoti put da nema kandidata iz drugih zajednica, opet, osim iz Srpske i većinske zajednice. I zato će glasati naši po svojoj savesti.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Vazhdojmë me radhën e diskutuesve të paraqitur. Fjalën e ka deputeti Nait Hasani, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Syla.

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryesues!

Kolegë deputetë edhe pse janë lodhur, po më duket iu ka ardhur pak... Falënderoj kolegët deputetë që u morën me militantët e partisë. Ne këtu zbatojmë ligjin dhe jemi për ligjin. Nëse ata janë në kundërshtim me ligjin, që nuk e lejon atëherë është krejt në rregull, por nëse nuk e lejon ligji, nuk ka nevojë me u marrë me të por duhet me u marrë me pikën më të rëndësishme të cilën e kemi pikërisht këtu nga emrat të cilët janë përfolur, ku edhe ne kemi shqyrtuar në Grup parlamentar dhe nuk jemi pajtuar me këtë çka u tha. Po e përmendën që edhe kumaritë dhe çkumaritë, vërtet është interesant këtu se ne kemi – një nga ata janë militantë të shërbimeve, më mirë të them të shërbimeve se të partive, se kemi njerëz të dëshmuar në parti, Ylber Topalli është një i dëshmuar me veprën e vet për çlirimin e Kosovës, ndërsa kemi njerëz tjerë që kanë luftuar pikërisht kundër Ylberit për me robëruar Kosovën, me mbajt edhe më gjatë. Ndër ta kemi edhe policë, edhe policë... Për shembull Avdi Ibrahim... Behrami, thotë është postëkomandanti i stacionit të milicisë. Tash llogaritni kur u kanë udhëheqës, organizimi, komandimi dhe kryerja e detyrave tjera. Viti 1981/82, kur i ka rreh, i ka shkatërruar në Skenderaj. Planifikimi... Të lutem! Ky ka planifikuar dhe ka organizuar dhe i ka mbikëqyrur rrahjet në Skenderaj. Ka ndërmarrë masa lidhur me disiplinën, i ka koordinuar aktivitetet në 82-tën për rrahje dhe dhënien e ndihmave qytetarëve, kuptohet iu ka dhënë ndihmën. Pozitat tjera që i ka pasur 1982-86, kryeshefi i drejtorisë së punëve të brendshme. Ka organizuar, planifikuar, kontrolluar dhe zbatuar të gjitha. Tjetra është 1986-89, sekretar për punë të inspeksioneve, domethënë sekretar, hala ma lartë tash ka ecur, ka avancuar, se prej Skenderajt ka mbërrit tutje. Zakonisht ne i kemi kështu. Dhe, ka bërë kontrollin në zbatimin e ligjshmërisë nga punonjësit. Dhe, thotë, i kam të kryera të gjitha këto shkolla të tjera.

Unë kërkoj nga deputetët, nga kolegët, po edhe nga Qeveria, që tani jemi çkukmaruar...

(Ndërhyrje)

Na jemi çkukmaruar kështu, pikërisht, ne s'kemi punë të bëjmë me ta, po unë kam qenë kundër edhe atëherë por e kam ditur që do të vijë në ditën e sotme, do të çkumarohej. Prandaj, kësso listash që kanë ardhur dhe me këta njerëz që i kanë prurë këtu, unë kërkoj që deputetët mos t'i votojnë. Dosjet tona, dokumentet tona, të dhënat personale, të gjitha ato, kush do të na ruajë, personat të cilët kanë punuar tërë kohën si zoti Avdi Behrami dhe të tjerë.

Prandaj, duke i pasur të gjitha këto, koalicioni është mbyll, është prishur, kanë ikur prej koalicionit, i kemi mbajt dhe i kemi ruajt dhe jemi kujdesur për ta. Po kanë ikë! Tash pasi është prishur koalicioni duhet t'i themi: stop. Kjo listë nuk duhet të kalojë, pikërisht sepse ne, nëse do të vjen një ligj nesër, për lustrimin apo rezolutën që jemi të detyruar nëse duam të hyjmë në Evropë, se e di se një grupacion i partive politike, domethënë janë, flasin vazhdimisht për Evropë, për Evropë. Nuk kemi qare pa e miratuar Rezolutën e Bashkimit Evropian kundër diktaturave dhe krimeve të komunizmit. Nëse i miratojmë këtë, pikërisht e kemi ligjin për lustrimin. Ligjin për lustrimin nuk na lejojnë këtë njerëz, të cilët kanë punuar tanë kohën kundër popullit të vet, të jenë prapë ruajtës të dhënave,

pa marrë parasysh a është i Drenicës apo të cilit vend tek është. Kemi respekt për kontributin, por nuk do të thotë çdo gjë e mirë ka qenë edhe në Drenicë. Prandaj, kërkoj që t'u tregohet një herë edhe mirë, sot e përgjithmonë që njerëzit që kanë punuar me pushtetin, që ka në bagazh politikë të ish titizmit dhe të jugosllavizmit t'ju thuhet stop, sepse nuk jemi për të krijuar Kosovën edhe në herë jugosllave.

Ne nda duhet t'ju themi qëndroni jetoni, por jo të merrni pjesë në pozitat politike, pozitat zyrtare të cilët janë përgjegjësi me rëndësi të veçantë. Ne, nëse e miratojmë këtë, të dhënat tona do t'i ruajë Beogradi, përsëri, sepse është njeri i zgjatur i tij. Njeri që ka punuar me 30 vjet për ta, tash lë ta votojmë përsëri, kjo për mua është e papranueshme edhe për shumicën e deputetëve, por edhe për qytetarët e Kosovës, është e papranueshme të zgjidhen njerëzit e tillë. Prandaj, kërkoj nga Kuvendi t'ia kthejë prapë Qeverisë. Nëse nuk ka kohë kjo Qeveri, vjen Qeveria tjetër e bën se nuk bëhet kiameti që e shtyjme edhe dy- tre muaj për t' u bërë zgjedhjet, kështu që kërkoj që të shtyhet kjo, të hiqet nga rendi i ditës dhe kësi njerëz mos të na vijnë për votim se është turp për Kuvendin e Kosovës të votojë edhe një herë njerëzit që kanë punuar me Jugosllavinë, me Titon e me Millosheviqin e me krejt kundër nesh. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!
Vazhdojmë me deputeten Gjylnaze Syla.
Regjia fjalën deputetes, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë kisha dashur vetëm të thirrem në Ligjin, t'i bëj të vetëdijshëm deputetët se sa janë të rëndësishëm njerëzit të cilët me të vërtetë do të kujdesen dhe do t'i kenë në duar të dhënat personale dhe po nisem nga dokumentet të cilat i ka dhënë vetë Qeveria. E para është se lidhur me njeriun i cili është mbikëqyrësi kryesor shtetëror, e që është një pozitë shumë e rëndësishme, te studimet posdiplomike, ku thotë se është kryesues i Bordit në Kompaninë regjionale të ujërave dhe kanalizime bifokarcion Ferizaj, nuk është i cekur fare viti, por shkruan vetëm 200, kurse në deklaratën të cilën e ka bërë ai vetë për prejardhjen dhe gjendjen e pasurisë zyrtarëve të lartë, dhe cilën e ka nënshkruar vet, data e dorëzimit të këtij formulari është më 31.3.2010, që do të thotë se ky njeri i cili propozohet nga Qeveria është ende kryesues i Bordit.

Tjetra, sa i përket përkatësisë së tij partiake, që e përmendi zotëri Gjini, se ka qenë i Grupit Parlamentar, kjo përkatësi partiake pengon që ai të kryejë në mënyrë të pavarur punën e tij, sepse kërkesa ligjore e Ligjit për të dhënat personale, neni 31, kërkon që të jetë një organ i pavarur dhe po lexoj, gjegjësisht neni 35, në kryerjen e detyrave të tyre, anëtarët e Këshillit veprojnë plotësisht të pavarur. Nuk mendoj se duke i përkitur një partie, të jetë një partiak, do të kryejë në mënyrë autonome ose të pavarur punën e tij.

Kjo është e para. Unë dëshiroj të sqaroj se ai është ende anëtar i këtij Bordi, aktualisht e ka nënshkruar njeriu deklaratën për prejardhjen dhe gjendjen e pasurisë vetë me 31.3. të këtij viti. Tjetra, sa i përket personit të dytë, të cilin e propozon Qeveria e që është mbikëqyrësi shtetëror, ky nuk i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 32 dhe po e lexoj, se cili është edukimi i tij. Është shkolla fillore, e shkolla e mesme, shkolla e lartë për punë të brendshme, Fakulteti i Sigurisë dhe vetëmbrojtjes shoqërore, kursi themelor për milicioner, kursi për udhëheqje dhe komandim me njësi të milicisë dhe po e lexoj kërkesën e Ligjit, që thotë që personat të cilët kanë diplomë universitare dhe tri vjet përvojë pune profesionale, mund të caktohen si mbikëqyrës shtetëror, do të thotë edhe më lartë thirret gjithashtu në mbikëqyrësin kryesor shtetëror, i cili duhet të ketë

diplomë universitare dhe 5 vjet përvojë pune profesionale. Unë ju ftoj që të mos votohet kjo listë, sepse nuk i plotëson thjesht kërkesat ligjore të cilat kërkojnë nga Ligji mbi të dhënat personale, dhe duhet të jeni të vetëdijshëm se është një ligj shumë i rëndësishëm, po flasim për njerëz të cilët do të kenë qasje në dokumente shumë të rëndësishme siç janë të dhënat personale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete. Edhe unë, si deputet, tash do të distancohem nga roli i udhëheqësit të seancës, do t'i them vetëm pak fjalë, për dy-tre raste që i pash në CV të kandidatëve.

E para, kam vërejtje të institucioni që i kërkon këta që nuk ka dhënë një standard të CV-së, se si të shkruhet. Te disa kemi të dhëna të plota, te disa kemi të dhëna gjysmake, te disa nuk kemi fare të dhëna për kualitetet e tyre, pikërisht, sepse formati i CV-së, është, nuk është i standardizuar. E para. E dyta. Me gjithë respektin që mund të kemi për këta njerëz si persona të cilët as nuk i njoh, kualitetet që na vijnë përmes përmes CV-ve të tyre këtu, me të vërtetë janë të diskutueshme në çdo aspekt.

Për shembull, disa kanë notën mesatare minimale, dhe të diplomuar në kohë, domethënë kur kriteriumet kanë rënë, domethënë, në kohë gati lufte e paslufte menjëherë, të tjerë ka edhe gjatë viteve të '90-ta, e kam fjalën për një kandidat i cili thotë se ka pasur universitet, unë nuk e di që në Shtërpçë ka pasur ndonjëherë koleg që ka dhënë diploma bachelor, atje mund të ketë pasur një shkollë të mesme, por ai e quan, thotë titulli i tij është ... bachelor dhe shkolla ku e ka kryer është një koleg në Shtërpçë, do të thotë, me të vërtetë janë në SIV-i janë të dhëna mjaft të dhëna mjaftë të diskutueshme për kualifikimet e kandidatëve, duke i shtuar edhe ato që thanë parafolësit edhe për, po mendoj funksionet që kanë kryer në të kaluarën që janë, ne po mëtojmë që përmes kësaj liste, një funksion tepër të rëndësishëm, tepër senzitiv dhe fundamental të ruajtjes të dhënave të shtetit, për ta, ta lëmë në duar të njerëzve duke pasur një përvojë të hidhur që pikërisht ai institucion, në një moment na i ka rrjedhur të dhënat dhe ne për këtë e kemi fajësuar një autoritet ndërkombëtar që ka qenë, por tash ne po bëjmë autoritetin tonë i cili nuk po garanton me cilësitë e dëshmuara këtu se do të jetë më mirë dhe do t'i ruajmë më mirë.

Prandaj edhe unë distancohem përkatësisht mbaj qëndrimin e kundërt të votimit të kësaj liste.

Vazhdojmë me diskutuesit e radhës.

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputeti Rexhep Hoti. Meqë deputeti Buçinca doli, fjalën e ka deputeti Hoti.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Desha vetëm të mbështes diskutimin e deputetit Hasani, dhe unë kujtoj se sot ai në dy diskutimet, si deputet na ka kujtuar se ne nuk duhet të jemi kundër njerëzve personal, por megjithatë ky Kuvend ka arritur në një shkallë ku duhet ta ndërtojë të ardhmen e vet, duke i marrë parasysh edhe disa procese të cilat të kaluarës, në të kaluarën i kanë shkaktuar bukur dhimbje të mëdha popullit shqiptarë të Kosovës, prandaj, duhet të jemi të kujdesshëm me lista. Në anën tjetër kisha me dhënë vërejtje të shefat e grupeve parlamentare, të cilët në fakt nuk i argumentojnë si duhet ndonjëherë mospajtimet e veta, por rroken pas problemeve se një person a i takon një partie politike apo një partie tjetër.

Përfundimisht nga ajo që u tha këtu, u pa se të gjitha shërbimet e mundshme ekskluzivisht edhe shërbimi i Serbisë, i ka kandidatët e vet dhe tash ne duhet t'ia votojmë. Unë kujtoj se duhet të jemi të kujdesshëm në Kuvend me këso gjëra dhe në të ardhmen të mos i sjellim lista të pa verifikuara mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputetë! Dhe deputeti i fundit i paraqitur për diskutim lidhur me këtë pike, Shkumbin Demaliaj.

SHKUNBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Unë besoj se neve nuk duhet të kthehemi në të kaluarën, sepse çdo kthim në të kaluarën është humbje kohe. Në qoftë se dikush ka dokumentacion apo dosje që fliten për njerëzit, ekzistojnë mekanizmat institucional le t'i ofrohen Prokurorisë edhe gjykatave të ndryshme apo paraqitjet para organeve që janë të thirrura me ligj për këtë çështje.

Mirëpo, është shumë shqetësuese se për një mekanizëm të tillë institucional ku është mbrojtja e të dhënave personale, po ajo që thatë ju, për atë dokumentacion, në qoftë se ata kanë ofruar të dhëna ilegale dhe të ndërtuara personale për të mundur për të hyrë në një institucion të tillë, në radhë të parë duhet të verifikohen të dhënat e tyre në këtë rast e mos të pranohen edhe të shikohet mirë edhe rrjedhshëm kush janë këta njerëz që donë të hyjnë në një institucion dhe jashtëligjshëm kanë ofruar dokumentacion për t'u punësuar në këtë institucion e lere më të vijnë në Kuvendin e Kosovës si institucioni më i lartë i vendit dhe ta qesin në lajthim me dokumentet e falsifikuara, në qoftë se janë ato ashtu. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Të faleminderit!

Meqë nuk kemi diskutues tjetër të paraqitur, në të vërtetë, në momentin e fundit, kryetari i Komisionit për Siguri, zotëri Rustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Ju faleminderit, kryesues!

Unë po flas në emër të Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Në Komision asnjë çështje nuk është lidhur për njerëzit që po flasim. Unë personalisht njoh vetëm Ylber Topalli edhe të tjerët nuk i njoh, por brengosem shumë që po flasim me një dozë të frikës nga njerëzit tanë.

Unë dhe ju bashkë, të gjithë deputetë të nderuar, duhet të gëzohemi që i takojmë një qytetarie, njerëzve ku me qindra vjet kemi qenë të okupuar dhe nuk kemi bashkëpunuar me armikun. Në popullin tonë nuk ka as ashtu me atë sy çfarë po donë disa për t' i parë. Ata njerëz që 10 vjet na jemi të lirë, i kemi kthye sytë edhe krejt po mundohemi ta ndërtojmë vendin, ju lutem nuk bënë për t' i etiketuar njerëzit. Ata njerëz nuk guxojnë të jenë të këqij, sepse kanë ardhur nga Qeveria e vendit tonë edhe nga njerëzit që e përfaqësojnë vendin tonë. Mos bëni humor dhe mos flisni për njerëz se nuk bënë, ne i përfaqësojmë njerëzit, e përfaqësojmë unitetin e tyre. Nëse dikush nga ju dëshiron për të qitur njerëz në taborë tjerë, e ka gabim, nuk bënë, e keni keq.

Unë në emër të Komisionit edhe një herë është votuar pa kundër, pa asnjë votë kundër, thërras të votohet kjo listë edhe pse nuk jemi të detyruar për t' i njohur personalisht njerëzit edhe mos u mësoni me fol për njerëzit ashtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Është paraqitur në ndërkohë edhe deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Ju faleminderit!

Unë vetëm një çështje kështu për mua ishte brengosëse. ajo çka u tha në adresë të zotit Ylber Topalli, është e vërtetë, unë e kam koleg dhe personalisht mburrem me të, sepse kudo që ka qenë, ka treguar një performancë jo në frymën partiake, por ekskluzivisht në frymën e zbatimit të ligjeve dhe e ka një vetëdije të tillë, ku ndahet vija partiake, ku ndahet vija e ligjit dhe ajo shtetërore. Prandaj njerëz të tillë në të vërtetë janë vlera dhe jam i bindur që në krye me Ylber Topallin, ky agjencion do të jetë një prej më të mirëve në Kosovë. Është njeri i sakrificës, është njeri që kudo që ka qenë ka treguar vërtetë performancë ekskluzivisht në përputhje me Ligjin.

Desha të them se nuk guxojmë ne si deputetë ta privojmë dike pse po i takon një partie kur në anën profesionale, ai është jurist dhe ka treguar performancë që jam i bindur se ne këtu, ose kolegët tjerë që do të jenë në këtë vend, kur të vijë raporti vjetor ka për të marrë vetëm mirënjohje, sepse është njeri që mbi të gjitha e zbaton ligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Duke konsideruar se u shterua diskutimi edhe lidhur me këtë pikë, ftoj që të votojmë propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të dhënave personale.

Në sallë kemi të pranishëm 81 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatoj se Kuvendi me 32 vota “kundër”, 25 vota “për”, 11 abstenime, nuk e miratoi propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e 17-të:

17. Shqyrtimi i Propozim - strategjisë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025.

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, ka shqyrtuar propozim strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025 dhe Kuvendit i ka rekomanduar që këtë propozim strategji të mos e miratojë në mbledhjen plenare.

Për diskutim, në emër të Komisionit funksional, është paraqitur deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zotëri kryesues!

Në bazë të nenit 62 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me datën 25. 10.2010 e shqyrtoi dhe nuk e miratoi propozim strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025 dhe nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Kuvendi i Republikës së Kosovës, të mos miratojë Propozim - strategjinë e minierave të Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025.

ARSYETIM

Qeveria e Republikës së Kosovës, Propozim strategjinë e minierave të Republikës së Kosovës, për periudhën 2010-2025 të datës 17.12.2009, e ka proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Kosovës me datën 20.9.2010.

Kryesia ia dedikon Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, që të shqyrtojë Propozim-strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për këtë periudhë dhe Kuvendit, t'i paraqesë raportin me rekomandime.

Komisioni në bazë të nenit 62 të Rregullores së punës së Kuvendit Kosovës, ka shqyrtuar Propozim- strategjinë e Kosovës në periudhën 2010-2025, në mbledhje të rregullta, me datë 4.22.10.2010, ndërkaq me datën 20.10.2010, ka realizuar një dëgjim publik ku ka ftuar dhe ka prezantuar sponsorët dhe aktorët relevantë të kësaj strategjie. Ndërsa me datën 25.10.2010, në mbledhjen e tij të rregullt, Komisioni konstatoi se Propozim-strategjia minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025, si e tillë nuk mund të miratohet, sepse ka nevojë të ndryshohet dhe plotësohet në përgjithësi dhe në veçanti në fushën e legjislacionit që rregullon çështjen e minierave në vend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Vetëm t'ju informoj se nga Ministria, përkatësisht nga përfaqësuesit e Qeverisë nuk ishte paraqitur dhe nuk është askush këtu. Tani fjalën, sipas radhës të grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, deputetja Salë Berisha - Shala.

SALË BERISHA -SHALA: Ju faleminderit, kryesues!

Unë nuk jam paraqitur në emrin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, flas në emrin tim personal, si inxhinier e fushës së gjeologjisë, edhe dua të tregoj se unë nuk jam pajtuar me Komisionin dhe më lejoni veç ta them sa për informacionin tuaj, strategjia e minierave i mungon Republikës së Kosovës. Ka ardhur fillimisht më 2009, në dhjetor, dhe është shtyrë për t'u përmirësuar dhe për të mos e zgjatur shumë me histori, ne si komision parlamentar, e kemi shqyrtuar katër herë me radhë në Komision dhe çuditërisht, në herën e fundit kur e kemi shqyrtuar, dikush ka pa ëndërr diçka dhe e qiti propozimin se duhet t'i kthehet Qeverisë kjo strategji.

Janë mbajtur dëgjimet publike. Këtu në arsyetimin nga Komisioni, thuhet se dëgjimi publik është mbajtur më 20 dhjetor, që është shumë e vërtetë dhe kanë prezantuar sponsorët dhe aktorët, por nuk i përmend edhe ekspertët shumë të shquar të fushës të minierave në Kosovë. Se kjo ka domethënien e vet, e përmendët se edhe ekspertë ka pasur aty me propozimet e të cilëve janë pajtuar të gjithë në Komision parlamentar, me ndonjë mospajtim shumë të vogël që mund të plotësohet strategjia.

Dhe arsyetimi për mua është tepër në terma abstrakt, ku thuhet se i kthehet Qeverisë, në veçanti që të plotësojë fushën e legjislacionit që i rregullon çështjet minerare në vend. Unë dua t'ju përkujtoj, kolegë deputetë, plor edhe të gjithë ata që na përcjellin, se legjislacioni bazik veç ekziston në Kosovë, pas një viti e sa Komisioni që ka punuar në Ligjin për miniera dhe minerale, në shtator të këtij viti është aprovuar dhe ai ligj është shumë voluminoz i cili lirisht ka mundur të ndahet në katër ligje që rregullon së pari fushën e hulumtimeve minerare, pastaj themelon

Komisionin e pavarur, themelon shërbimin gjeologjik, bën licencimin e lëshon licenca për hulumtim dhe shfrytëzim të mineraleve, merret me çështje të ambientale, merret edhe me çështje tjera, obligohet me ligj që Qeveria të bëjë strategjinë e minierave, është kapitull i veçantë që Qeverinë e obligon që ta sjellë strategjinë e minierave në Parlament. Pastaj i kemi edhe ligjet tjera që e kompletojnë dhe e bëjnë më të zbatueshëm Ligjin për miniera dhe minerale siç është Ligji për partneritet publiko-privat. Është edhe koncesioni, Ligji për shpronësim e kështu me radhë që mos t'ju lodhi me të gjitha këto ligje.

Unë do ta pranojë votën me të cilën vendos Kuvendi, por kisha një sqarim nga kryetarja e Komisionit se për cilën legjislacion është fjala, i cili duhet të plotësohet dhe është pengesë që kjo strategji të mos votohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Tash kryetarja e Komisionit, po ju keni qenë në Komision dhe besoj jeni sqarua, kështu që s'po e shoh të udhës ju tash të bëni këtu polemikë, atëherë kryetarja e komisionit e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Jo, me shumë mirëkuptim zoti kryesues se është e vërtetë gjatë gjithë kohës zonja Sala- Berisha ka qenë në Komision dhe e dinë mjaftë mirë që gjithë kemi qenë të mendimit që të japim mundësitë më të mira që kjo strategji të ecën, mirëpo edhe kjo është e njoftuar cila pjesë e legjislacionit mungon që kjo strategji duhet t'i kthehet Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë me diskutimet. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së deputeti dhe shefi i Grupit, Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar kryesues,

Unë jam i prirur të respektoj mendimet personale të kujt do qoftë. Sala foli në emër të vetë dhe tha mirë që foli në emër të vetin. Grupi Parlamentar i partisë Demokratike ka mendim tjetër dhe qëndrim tjetër, dy anëtarë të Komisionit e kanë tumirë, e kanë mbështetur, e kanë aprovuar këtë qëndrim që edhe i kanë aprovuar rekomandimet e Komisionit që kjo strategji për arsye që ata i dinë më mirë dhe në mënyrë më profesionale t'i kthehet Qeverisë për ta përplotësuar.

Andaj, Grupi Parlamentar i mbështet rekomandimet e Komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputetë!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë për hir edhe të asaj që të kompletoj mendimin lidhur me rekomandimin e Komisionit, me që edhe në grupin parlamentar i mbeta për borxh sot po ju them 2 – 3 fjalë se grupi parlamentar megjithatë e përkrah arsyeshmërinë të cilat kanë të bëjnë me mos shqyrtimin e sotshëm të kësaj strategjie dhe sigurisht që dy arsye kanë dominuar që kjo strategji të lihet për shqyrtim në një afat ose në një moment tjetër kohor.

E para që është vendos në momentin e fundit që e ka ndërruar mendimin e Komisionit kanë qenë zhvillimet politike dhe këtë po e dëshmon edhe tash se veç mospjesëmarrja e Qeverisë për një strategji kaq të rëndësishme në debat në atë çka i takon një Qeverie për peshën dhe rëndësinë të madhe që ka një strategji, pra ajo e arsyeton edhe këtë mendim politikë që e ka dhënë Komisioni

mbi bazën e së cilës mbështet Komisioni dhe grupi parlamentar. Po në anën tjetër, pra është edhe një arsye që na është afruar ditën e fundit pas gjithë asaj kohe dymujore që kemi bërë debate në komision që ka rrjedhur nga informacione të tjera se ka nevojë për plotësime të tjera të natyrës që kanë të bëjnë, sidomos me shqyrtimin që mos bijë në kontradiktë kjo strategji me disa mundësi që lidhur me asetet që kanë të bëjnë me resurset e sidomos të “Trepçës” për të cilat pra janë dhënë mendime të ndryshme se duhet shikohet, sepse ka pas pretendime të ndryshme në rrethana dhe kohëra të ndryshme për shfrytëzimin dhe për të drejtën ndaj këtyre aseteve. Prandaj, i kemi lënë një mundësi një hapësirë që në një kohë tjetër që ky të jetë kapitulli që duhet të zhvillohet debati, përndryshe pjesa tjetër e parë që ka të bëjë me strategjinë ne kemi qenë të pajtimit pra me atë kontribut të madh që kanë dhënë inxhinierët, ekonomistët dhe ata që kanë marrë pjesë në këtë debat për strategjinë, për peshën e madhe, rëndësinë që ka ky potencial i resurseve në zhvillimin ekonomik të vendit dhe për “Trepçën” për të cilën kemi kërkuar që mos të ndodhë të fillojë privatizimi sikur që ka filluar privatizimi në KEK apo në PTK pa u bërë ristrukturimi apo korporatizimi i kësaj ndërmarrje dhe të gjitha ato ndërmarrje që kanë afarizëm dhe bilanc pozitiv duhet të shkojnë pra në tregun tjetër të hyjnë partneritet privat- publik, ndërsa ato të tjerat që nuk mund të punojnë pra është procesi i falimentimit i cili po ashtu është një proces për të cilin duhet të mendohet sepse nuk është i lehtë nuk ka të bëjë vetëm me mbylljen po ka edhe shumë gjëra të tjera që po ashtu lidhen me asete të atyre. Pra, kjo ka qenë ajo temë bosht e debatit për të cilën kemi debatuar dhe unë mendoj që mirë është që është dhënë një kohë shtesë, sepse janë projekte të mëdha, kërkoher seriozitet nga Qeveria që mungon por edhe nga Parlamenti që po mungon, prandaj e lëmë për një kohë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi ynë parlamentar po ashtu kërkon që ky dokument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit tonë që të shtyhet dhe t’i kthehet Qeverisë për ta rregulluar, sepse ka të bëjë me një periudhë të gjatë kohore 2010 – 2025, do të thotë është dokument që determinon zhvillimet e politikave në sektorin e energjisë dhe duke ditur se zhvillimet e fundit politike pamundësojnë që ky dokument të miratohet në këtë seancë, atë që e tha edhe kolegu më herët.

Dhe problemi i dytë është mungesa e infrastrukturës ligjore dhe përmes këtij dokumenti ne nuk e funksionalizojmë zhvillimin e minierave në Kosovë po përmes këtij dokumenti i cili ka mjaftë zbrazëtira mund të vijë në shprehje që të kemi investime të cilat realisht e bëjnë të pamundur funksionalizimin e plotë të kompleksit mineral të “Trepçës” dhe sektorëve të tjerë. Qeveria është vonuar që nga 2007 përcjell një dokument i cili duhet të ishte bazë e zhvillimit ekonomik të Kosovës dhe tani ky dokument mendojmë edhe një herë që duhet të kthehet për plotësim dhe kolegët të cilët kemi punuar në Komisionin parlamentar e dinë shumë mirë se cilat pjesë të ligjeve duhet të plotësohen. Është duke u punuar edhe Ligji për “Trepçën,” janë duke u punuar edhe disa ligje të tjera që kanë të bëjnë kthimin e rregullores së UNMIK-ut në ligje për funksionalitetin, prandaj, edhe ne si grup parlamentar kërkojmë që ky dokument të kthehet dhe të punohet në Qeverinë e ardhshme e cila Qeveri duhet të bazon zhvillimin ekonomik në sektorin e Energjisë dhe në sektorin minierarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit të AKR-së, deputetja Myzeje Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar strategjinë minerale dhe duke marrë parasysh se edhe vetë jam kryesuese e këtij komisioni jemi munduar që të bëjmë më të mirën për këtë strategji mirëpo duke marrë parasysh kohën në të cilën është ardhur strategjia dhe shumë probleme tjera që janë në këtë strategji për mungesë të një infrastrukture dhe të disa rregulloreve të UNMIK-ut që t'ia mundësojmë të gjithë aktorëve që kanë qenë në dëgjimin publik që u para fol se kanë qenë edhe ekspertë edhe njerëz të cilët atakohen direkt me këtë strategji që t'ia mundësojmë një punë më të lehtë për arsye se politikat bëhen që çdo kompani e cila ka zhvillim në sektorin minerar të ketë mundësi më të lehta deri te arritja e profitit. Grupi Parlamentar e AKR-së përkrah propozimin e Komisionit dhe sugjeron që Qeveria të ndryshojë këtë draft-strategji minerale në të mirë të zhvillimit ekonomik të Kosovës. ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Me që kemi mendimin dhe rekomandimin e qartë të Komisionit si duket deputetët tjerë të paraqitur për diskutim nuk kemi, atëherë kalojmë në votimin e propozim strategjisë minerare të Republikës së Kosovës përkatësisht votojmë Rekomandimin e Komisionit për t'ia kthye Qeverisë këtë projekt-strategji .

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të Rekomandimit të Komisionit.

Në sallë kemi 67 deputetë.

Regjia përgatitemi për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 9 abstenime dhe 2 vota “kundër”, Kuvendi e miratoi kthimin pra që Propozimin e Komisionit që projekt- strategjia minerare t'i kthehet qeverisë për ripunim. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetëmbëdhjetë të rendit të ditës.

18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin e qytetit të Prishtinës

Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka shqyrtuar Projektligjin për qytetin e Prishtinës dhe Kuvendit i ka rekomandua që ky projektligj të mos miratohet dhe t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Lus Komisionin apo raportuesin e Komisionit funksional që ta merr fjalën, është paraqitur kryetari i Komisionit deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për p Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, me një përkushtim të veçantë, me një angazhim, do të thosha shumë specifik si thuash e ka trajtuar në vazhdimësi për këta dy muajt e kaluar Projektligjin për Prishtinën duke qenë të vetëdijshëm edhe për rëndësinë që ka projektligji. Në fakt që në fillim është parë se ky projektligj është shumë i mangët, është shumë i thatë dhe nuk i jep atributin kryeqytetit të Republikës sonë ashtu siç do të duhej. Pavarësisht prej kësaj komisioni iu ka rrekur një angazhimi të jashtëzakonshëm dhe ka organizuar dëgjime publike ku pjesëmarrës kanë qenë të gjitha palët si thuash gjithë grupet e interesit duke përfshirë edhe komunën e Prishtinës, duke ftuar kryetarët e grupeve parlamentare në Kuvend, shoqërinë civile, mediat, në mënyrë që të

marrim sa më shumë mendime në lidhje me këtë projektligj. Të them të drejtën të gjithë kanë pas rezervat e tyre të konsiderueshme dhe ne kemi shkuar më tutje, kemi ftuar kryetarët e komunave përreth që edhe ata t'i dëgjojnë, sepse atje kemi të bëjmë me Prishtinën metropolitane, pastaj kemi pasur disa seanca të komisionit, kemi ftuar ekspertë të cilët i falënderoj shumë për kontributin që kanë dhënë në komision. Dhe me që komisioni përbëhet nga të gjitha partitë politike, mbase karshi këtij projektligji komisioni ka pasur qëndrimin më unanim që t'i rekomandohet Kuvendit të Kosovës që t'i kthehet Qeverisë për ripunim, dhe atë duke veçuar vetëm dy gjëra. Projektligji realisht ka mangësi të shumta, ne mendojmë se duhet të bëhet një projektligj i ri për kryeqytetin e Prishtinës dhe atë neni 2 dhe neni 5 i projektligjit janë vlerësuar nga ekspertët, nga shoqëria civile se janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Dhe dy, Qeveria të definojë qartë se çfarë statusi të njësisë administrative duhet të ketë qyteti i Prishtinës? Mendojeni është fare e paqartë se çfarë projektligji ose çfarë ligji do të bëjmë, do të bëjmë për qytetin e Prishtinës, me kufijtë administrativ të qytetit apo do të jetë një projektligj i cili do të përfshijë edhe hapësira që përbëjnë fshatrat rurale dhe përreth saj. Domethënë, nuk është e qartë në projektligj se kemi të bëjmë vetëm me kufijtë administrativ të qytetit të Prishtinës apo të komunës së Prishtinës që ka një shtrirje tjetër gjeografike. Sido që të jetë, ne jemi munduar jashtë masës dhe mënyrën më racionale të gjithë anëtarët e grupit ose të komisionit që përbëhet nga të gjitha partitë politike kanë qenë unanim që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Ndërkohë neve na kanë ardhur gjatë kësaj faze të punës edhe disa amendamente dhe ato i kemi respektuar dhe jemi munduar që ta shpëtojmë disi projektligjin duke qenë të interesuar që të ketë kryeqyteti një projektligj, por me të vërtetë nuk ishte e mundur për të nxjerrë një materie më të mirë dhe të bëhej një projektligj i meritave për kryeqytetin e Kosovës.

Komisioni në mënyrë unanime ka kërkuar që projektligji t'i kthehet Qeverisë për miratim dhe mendoj se ka funksionuar në mënyrën më racionale të mundshme.

Nëse i lejmë anash interesat, grupacionet, unë mendoj se as kryeqytetit nuk do t'i bënë tender një projektligj i tillë, i cili do të ishte i pazbatueshëm në shumë pika të veta, edhe ashtu është një ligj prej 10 neneve gjithsej. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet, për prezantimin shumë të qartë të Komisionit..
Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah rekomandimin e Komisionit, pasi që janë shterrur të gjitha mundësitë dhe pasi edhe ekspertë e shoqëria civile dhe gjithë grupet e interesit dhe gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë mbështetur këtë rekomandim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues i Kuvendit,
Kolegë të nderuar,

Fjala themelore është që Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e përkrah rekomandimin e komisionit. Kjo është themeloria dhe unë do ta arsyetoj pse?

Ne kemi një rekomandim më të pazakonshëm prej të gjitha rekomandimeve të komisionit prej se jam në këtë legjislaturë.

Rekomandimi thotë: I rekomandohet Kuvendit të Kosovës të mos miratojë Projektligjin për qytetin e Prishtinës, përkatësisht t'i kthehet Qeverisë për shqyrtim. Menjëherë në arsyetim, fjalinë e parë e ka - Projektligji për qytetin e Prishtinës është miratuar në Kuvendin e Kosovës. Ju lutem shumë, kurrfarë fuqie nuk ka në këtë fazë komisioni i Kuvendit, cilido qoftë në këtë rast, ky komision t'i rekomandojë Kuvendit të mos e miratojë ligjin sepse ligji është miratuar, në parim, domethënë ka kalua kjo fazë. Për t'u ç' miratuar ose për t'u plotësuar është leximi i dytë, lexim të dytë këtu nuk ka. Arsyetimi është krejt rigid, thotë i ka 2 nene që është kundër kushtetutës, atëherë kanë mund të amendamentohen ato dy nene, të mos mbetet kundër kushtetutës. Domethënë, proceduralisht është i ndërtuar raporti gabimisht, se në këtë fazë, natyrisht, qeveria e Kosovës mund ta tërheq këtë ligj, nëse do, edhe në këtë fazë thotë sponzoruesi, po Kuvendi nuk mund ta tërheq, ta zhbëjë leximin e vetë të parë pa e pas bërë një lexim të dytë dhe komisioni na thotë - mos bëni lexim të dytë. Kjo është ajo themeloria pse ne jemi kundër këtij mendimi të komisionit.

Arsyeja e dytë është që, ju të gjithë e dini që ky ligj, i mirë apo i keq, e ka bërë një histori më shumë politike se sa konstitucionale në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës. Ju e dini që është bërë më e padurueshme të bisedohet për të, sa që të gjitha grupet e Parlamentit të Kosovës, me datën 15 korrik, kur është bërë në leximin e parë, të gjitha e kanë mbështetur parimisht këtë ligj. Ju merrni fjalët që i keni thanë vetë. Është e vërtetë që janë bërë dy vërejtje themelore për dy çështje, por në leximin e parë të gjitha grupet e kanë mbështetur ligjin dhe s'ka arsye Kuvendi të bëjë mbresa kthehu mbas 3 muajsh dhe të thotë jo, se kemi mbështetur. Ky është një ligj, unë as atëherë s'kam thënë që është i shkëlqyeshëm as tash, po është një ligj që ka pretenduar të kryhet si një ligj obligim, një ligj kushtetues i Kosovës. Është thjeshtëzuar, është ngrirë, është shkrire, ka hyrë në shtirak, përfundimisht tash duhet hiqet dorë. Unë mendoj që ky mendim sot më as s'është mendim profesional, po është një mendim politik. Edhe nëse në mënyrë konsesuale të vetëdijshme apo të pavetëdijshme komisioni e ka dhënë këtë mendim, ky është një mendim politik, s'është konstitucional. Edhe një herë, për këtë shkak, unë personalisht mendoj që nuk duhet të votohet ky mendim dhe natyrisht Grupi i LDK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, shefi i grupit, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

U përmendën këtu edhe një herë, si shumë herë tjera, vendimet unanime të komisioneve dhe mendoj se është shndërruar në një klishe jo shumë ndihmuese për Kuvendin, kur kryetarët e komisioneve vinë edhe na thonë neve - 5 herë ose 6 herë e përsërisin atë që në komision janë marrë vendime unanime. Sikur të ish ai vendim unanim i komisionit aq i rëndësishëm, atëherë nuk kish për të ardhur në seancë plenare. Seanca plenare e ka shqyrtimin e vet dhe nuk ka lidhje hiq nëse komisioni në mënyrë unanime apo jo unanime e ka marrë një vendim, se po duket më që është pak si e çuditshme kjo përsëritje me qindra herë e vendimeve unanime të komisioneve dhe qortimit të deputetëve pse po dalin kundër komisioneve, çështja e parë.

Çështja e dytë, është se e tha profesor Hamiti, Qeveria ka të drejtë ta tërheqë këtë ligj, po sikur edhe në rastin e mocionit për shkarkimin e Qeverisë, qeveria nuk do vetë t'i marrë fajet, se i ka gjetur disa kujdestar në Kuvend të Kosovës që do ata ta marrin fajin në vend të Qeverisë. Çuditshëm, shumë

çuditshëm, pse po bëjnë kështu deputetët, pse vazhdimisht duhet t'ia heqin një barrë Qeverisë për faj të vetin.

Çështja e tretë, është se që tri vjet ka pasur për t'u bërë diçka me këtë ligj. Krejt kjo legjislaturë, kjo Qeveri e ka pasur obligim të bëjë diçka për Prishtinën dhe nuk ka bërë. Tash, në seancën e fundit, kur gati jemi para momentit kur ka mund me kalojë ligji, tash kërkohet mos të votohet në Kuvend edhe prapë u gjet dikush që thotë - mos të kalojë në Kuvend përmes komisionit, prapë Qeveria e Kosovës e hedh gurin dhe e fsheh dorën dhe gjen njerëz që ia fshehin gurin. Po çka ka për të pritur për 3 vjet kjo Qeveri, 3 vjet një ligj, po për 3 vjet tabelat e veturave s'kanë mund t'i bëjnë, 3 vjet mbas pavarësisë.

Çështja tjetër, është se po i përmendin ekspertat këtu, unë po mendoj ndoshta prapë atë farë zotin Bill e kanë thirr. Po ju pyes, a mos e keni zotin Bill edhe një herë, mos ju ka thënë zoti Bill që është shkel kushtetuta. Nëse është shkel kushtetuta në dy pika, mund të amendohen ato dy pika, nuk ka nevojë të kthehet krejt ligji pasi që ka kaluar në lexim të parë në Kuvend.

Mendoj se është gabim, qasja është e gabueshme, edhe në mbledhjen e fundit ose të parafundit të Kuvendit ka prapë qasje të gabueshme. Mendoj se nuk bën në këtë mënyrë të nënshtrohet Kuvendi. Deputetët duhet të kenë kujdes, mos të lejojnë, bile pak të kenë konsideratë për vetveten dhe për ata që na kanë zgjedhur. Pse po doni ta nënshtrojnë Kuvendin edhe një herë, pse edhe në ditën e fundit.

Grupi Parlamentar i Aleancës nuk e mbështet propozimin e komisionit parlamentar, mendon se është gabim i madh kjo që po ndodhë. Mendon se ka faj Qeveria e Kosovës, po është mbështetur prej deputetëve të Kuvendit të Kosovës të cilët nuk po lejojnë të procedohet ashtu si duhet. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Realisht, unë as s'kam qenë ndonjëherë në këtë legjislacion partizanë i fjalëve të mëdha, i fjalëve që denigrojnë personalitetin e kolegëve, i fjalëve që thuhet të fryra për ta fshehur mungesën e njohjes së materies për të cilën mund të bisedohet. Realisht, unë u mundova të fokusohem në një punë që e ka bërë komisioni rreth këtij projektligji. Sigurisht që pa i përmendur aktorët pjesëmarrës në projektligj që kanë ndihmuar, nuk do të ishte e ndershme të mos përmenden. Jo për të treguar se kemi qenë më shumë serioz se sa që kemi qenë. I dëgjova kolegët me shumë respekt. Sa i përket formulimit të rekomandimeve, unë nuk i formuloj rekomandimet, kryetari i Komisionit i piketon çështjet kryesore në një rekomandim, që thotë, në bazë të tyre duhet të kthehet apo të kalojë tutje një projektligj dhe mund të ketë devijime këtu, nuk e marrë përsipër njohjen e thellë të kësaj fushe. Dhe, në rekomandim thuhet - i rekomandohet Kuvendit të Kosovës të mos e miratojë projektligjin, domethënë Kuvendit të Kosovës, po njëkohësisht edhe të debatohet mbi këtë çështje. Nuk është e thënë që Komisioni nëse ka rekomanduar diçka, gjithsesi duhet të jetë. Hajde, i ballafaqojmë argumentet. Unë ju betohem se nuk dëgjova argument i cili do ta zhbënte rekomandimin. Po kursehem shumë, sepse si natyrë jam i tillë që të mos them se mbase mungesa e njohjes së problemeve që ka projektligji, është rezultat i qëndrimeve të njerëzve shpeshherë.

Projektligji për Prishtinë, çfarë ka ardhur në Kuvendin e Kosovës, miqtë e mi, është një projektligj i cili nuk e zgjidh dhe nuk e avancojnë qytetin e Prishtinës në statusin e një kryeqyteti. Kishte shumë

probleme dhe unë mund t'ju servoj gjithë materialin, edhe të komisionit, edhe të ekspertëve, që i kemi bërë me dhjetëra rekomandime, i kemi shtjerrë duke i ripunuar, përpunuar për ta shpëtuar projektligjin dhe nuk kemi arritur dhe sugjerimi i të gjithëve ka qenë që të kthehet, më mirë të bëhet një projektligj i mirë, se sa të kalohet dosido dhe të mos jetë nesër i implementueshëm.

Çfarë dua të them përfundimisht? Edhe partitë tjera, miqtë, të cilët, kolegët folën tani, bile kanë qenë më të zëshmit që ky projektligj të kthehet prapa. Nuk e them këtë që të kapi vegëza koti, por unë mendoj që grupet parlamentare duhet të komunikojnë mes veti për projektligjet dhe t'i raportojë secili deputet grupit të vetë parlamentar se ku është problemi. Sido që të jetë, e quaj për ndërgjegje se i jam kushtuar dy muaj e sa këtij projektligji me qëllimin më të mirë që ta shpëtojmë, ta kalojmë tutje, por nuk jam partizan i asaj që për kalkulime të ndryshme duhet të kalojë projektligji.

Dy çështje të cilat kanë qenë problem në këtë projektligj akoma pa ardhur në Kuvend, e që kanë të bëjnë me grandin dhe Pallatin e Rinisë, sinqerisht nga komisioni nuk janë paraqitur fare si problem. Edhe aty, po them tash unanimisht, kemi qenë që këto dy çështje duhet të jenë në projektligj, pra Pallatin e Rinisë ta menaxhoj Prishtina, komuna, dhe grandit t'i ndahet gjithashtu, me një të drejtë të padiskutueshme. Problemi është - ku dhe çfarë përthekon projektligji për Prishtinën nga ana territoriale e kufijve administrativ dhe sikur t'i hynim kësaj pune ne si komision, do të duhej shumë më gjatë kohë me ekspertë që të qartësohej kjo punë dhe të bëjë një ligj rishtazi. Për të bërë ligj rishtazi, ne si kapacitete nuk kemi pasur mundësi si komision, zoti Lajçi veç e pohon këtë gjë, se ka qenë në rrjedhë gjithmonë dhe nuk kemi qenë të sigurt se mund ta bëjmë ndonjë projektligj më cilësorë se sa është, për shkak edhe të afateve kohore që duhet të sillej në Kuvend rekomandimi, për shkak të një klime që është bërë, tash unë nuk hy në komente dhe unë mendoj që kemi bërë një punë të mirë, hajde burra i debatojmë gjërat, po pa tendencën qëllimkeqe. Faleminderit, shumë!

SABRI HAMITI: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet,
Unë mendoj që... të partisë foli, po dha sqarimet që iu kërkuan.

SABRI HAMITI: (Pa mikrofon, nuk dëgjohet për transkriptim)

KRYESUESI: Mirë, e doni fjalën, zoti Brajshori? Jo, atëherë vazhdojmë me diskutues të radhës. Sipas grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, shefi i grupit, deputeti Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, gjatë miratimit në parim e kemi dhënë votën, duke konsideruar se në procesin e amendamentimit do të korrigjohen ato të cilat kanë qenë substanciale dhe kërkesa të vazhdueshme dhe ajo ka qenë: Duke u përfshi menaxhimi i Pallatit të Rinisë, si e drejtë ekskluzive e Kuvendit Komunal të Prishtinës dhe duke u përfshirë edhe grandet të cilat duhet t'i gëzojë si kryeqendër e Prishtinës, si kryeqendër administrative, kulturore dhe shtetërore e vendit. Mirëpo, kur na ka ardhur ky dokument që e kemi për bazë, atëherë vetvetiu shfaqet një dozë e abstenimit prej asaj se çka është duke ndodhur. Prapa nesh, para nesh nuk e kemi ekzekutivin e vendit që ta japë një përgjigje, që është ekskluzive e ekzekutivit të vendit t'i sqarojë disa çështje.

E para, përfaqësuesja jonë në komisionin funksional vazhdimisht ka raportuar për një çështje se a është e mundur që dispozitat e këtij ligji të bien në kundërshtim me kushtetutën dhe unë, si çështje shakaje kam thënë - po Kushtetuta e Kosovës është shkelur vazhdimisht, le të shkelet edhe në këtë rast. A është kjo zgjidhje? Unë mendoj se nuk është zgjidhje për arsye se 3 vjet partnerët e koalicionit qeverisës e kanë maltretuar opinionin publik dhe këtë seancë plenare, kuvendet, duke shantazhuar me buxhet, me Projektligjin për Prishtinën dhe me projekte të tjera, të cilat dihet si kanë përfunduar. A do të biem pre e këtyre shantazheve dhe lojërave politike, ne si LDD? Jo, për arsye se konsiderojmë se kjo është pjesë e korrupsionit politik, i cili është adresuar në Kuvendin e Kosovës vazhdimisht. Nëse mendoni se një projektligj duhet të kalojë nëpër seancë plenare, ta marrë miratimin në fund të mandatit të vet, edhe ashtu të përgjysmuar, unë mendoj se nuk i bën nder as Prishtinës, as seancës plenare, as diçka tjetër. Ajo çka duhet theksohet me këtë rast, është se ekzekutivi i vendit duhet ta ketë një përgjigje. Në qoftë se një projektligj i tillë, që është imediat, shumë i nevojshëm për kryeqendrën e Kosovës bie ndesh me kushtetutën, cili do të jetë mendimi përfundimtarë i Kuvendit të Kosovës?

Ne, si Grup Parlamentar abstenojmë, duke konsideruar se është lojë politike, e cila ka qenë prej fillimit të mandatit dhe e ka përfunduar këtë mandat me këtë lojë politike. Ne nuk guxojmë t'ia krijojmë vetes atë komoditet dhe nëse mendoni se ne do votojmë kundër kushtetutës, i cili parashikon me këtë ligj të krijohet një pushtet i tretë, që nuk e njeh kushtetuta, atëherë ju lutem votoni, se edhe ne nuk do të jemi pengesë. Mirëpo, po shihet se njëra parti është mësuar ta shkelë kushtetutën, tjetra është mësuar të kontrabandojë dhe në këtë formë ne nuk do të jemi pjesë e lojërave të cilat do të jenë të dëmshme për shtetin e Kosovës, por edhe për perspektivin e vendit.

Si grup parlamentar, nëse mendoni si grupe parlamentare, nëse mendoni të krijoni politikë në fund mandatit, unë besoj se e keni vonë. Është dashur në fillim të qartësohen disa pozicione edhe të PDK-së, edhe LDK-së. Nëse mendoni kësi soji që në fund të mandatit të manipuloni me opinionin, ky është mashtrim dhe nuk do të shitet. Si grup parlamentar, ne nuk pajtohemi dhe distancohem nga një politikë e tillë, e cila është krejtësisht kundër kushtetutës dhe kundër institucioneve.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Të nderuar deputetë, e di që jeni lodhur, por vazhdojmë që ta përfundojmë. Në emër të Grupit Parlamentar "7+", nuk kemi të paraqitur, as në emër të Grupit SLS. Në emër të Grupit për Integritet, deputeti Numan Baliq.

NUMAN BALIQ: Faleminderit, zoti kryesues!

Očigledno je da je fakat da postoje krupna i mimoilaženja, najpre između dve najbrojnije političke grupacije, da ne kažem najjače, nikad se ne zna ko će biti najjači na narednim izborima i da je očigledno da i druge političke snage imaju takode svoje stavove i rezerve vezano za ovo pitanje.

Mi, kao parlamentarna Grupa za Integraciju, imajući u vidu zaista ono što jeste komisija uradila, ali takode i to da je cjelo vreme bila na tragu svih ovih stavova koje smo čuli, mislim da bi trebalo da se Parlament izjasni o ovom pitanju, neka zastupnici glasaju i ono što parlamentarci izglasaju, toga se trebamo održavati. Hvala lepo!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Vazhdojmë me radhën e deputetëve të paraqitur. Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, pastaj le të përgatitet deputeti Sabri Hamiti.

GANI BUQINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Si jeni, a jeni mirë, a jeni lodhur? Veç vazhdoni.

Dëgjoni, a di pse u paraqita? Nuk dua të politizoj për arsye se edhe ashtu do të kemi kohë mjaftë për të bërë propagandë politike, zgjedhjet po na vinë dhe shumë prej jush edhe kanë për t'u lodhur, edhe kanë për t'u mërzhitur duke i përsëritur të njëjtat gjëra që i keni përsëritë që 3 vjet me tautologji, po fundin e keni aty ku jeni, prapë mbas zgjedhjeve, nuk ka problem. Unë kam shumë respekt edhe shumë konsideratë për miqtë e opozitës.

Miqtë e opozitës, dëgjoni! Tani po kaloj në temë. Më 15 korrik, unë pata deklaruar se ligji nuk është bërë për Prishtinën, as për qytetarët e Prishtinës, por për kryetarin e Prishtinës. Megjithatë, unë e pata votuar ligjin dhe ju pata thanë të gjithë kolegëve këtu që nuk është mirë të mundoheni ju ta monopolizoni qytetin se s'e keni pronë të juaj qytetin e Prishtinës. Ka qenë një nga ligjet, i cili është aprovuar në parim po thuaj se unanimisht nga të gjitha grupet parlamentare dhe unë tash e kam një farë satisfaksioni. Po më vjen mirë që ligji po iu kthyeqa Qeverisë, se për t'u bërë ligj ky, i cili i shërben qytetarit të Prishtinës, është dashur 99% të ndryshohet dhe në rast se Komisioni do të ndryshonte 99%, ai nuk do të ishte ligj i Qeverisë. Do të thotë, nga kjo logjikë, unë them që më mirë është t'i kthehet qeverisë ligji dhe të bëhet një ligj i mirë, i cili është në shërbim të qytetarëve.

Tash vetëm desha t'i përkujtoj disa kolegë të nderuar këtu, shefin e Grupit Parlamentar të Aleancës, se 3 vjet ka qenë ministër i një qeverie dhe nuk ka bërë kurrëgjë për qytetin e Prishtinës, edhe profesorin e nderuar, Sabri Hamitin, ka qenë në koalicion dhe ka qeverisur 3 vjet me AAK-në dhe nuk e kanë bërë Ligjin për Prishtinën. Kush i ka ndalur, çfarë pengesash kanë pasur? Edhe ti Lul, ke qenë në atë kohë pjesë e LDK-së dhe ty s'të ka ndalë askush ta bësh Ligjin për Prishtinën. Duhet të bëhemi të sinqertë, të kritikohet ligji më 15 korrik, e tash të abstenohet, çka i bien kjo, a i bien manipulim me vetveten a me emocionet e qytetarëve, a i bien propagandë politike. Ti je djalë i mençur edhe këto gjëra i dinë shumë mirë. Unë po ju them me sinqeritetin më të madh, nuk ka ekzistuar në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike asnjë arsye për të mos u aprovuar ligji. Ne e konsiderojmë Prishtinën qytet tonin, po aq sa e konsideron LDK-ja dhe ju partitë tjera. se këtu jemi rritur, këtu i kemi fëmijët, këtu i kemi emocionet tona, e kemi nostalgjinë për këtë qytet, edhe pse kemi ardhur nga regjionet e ndryshme, nuk ka pengesë të asnjë natyre dhe nuk është mirë të politizohet ky ligj.

Kurse, sa iu përket parave që i mungojnë kryeqytetit, nuk është e vërtetë. Kryeqyteti ka aq para, sa që nuk mund t'i harxhojë paratë, po nëse i shtohen paratë edhe më tutje, është mendim personal, do të masakrojë edhe më shumë këtë qytet dhe ashtu qysh kemi ardhur me dashuri të madhe në Prishtinë, do të na detyrojë kjo qeverisje e Prishtinës që ne të ikim nga Prishtina, për arsye se jeta ka për t'u bërë e padurueshme, e padurueshme në këtë qytet nëse vazhdohet kështu. Para ka qyteti, po ka nevojë edhe për më shumë para për arsye se qytetarët e Prishtinës kanë halle të mëdha, ju mungon infrastruktura, mungon infrastruktura rrugore e tjera, e tjera. Mirëpo, para se gjithash, ka nevojë për një ligj të mirë, i cili i shërben qytetarit e jo një individit ose një grupi të interesit në Prishtinë, një grupi të interesit në Prishtinë, i cili është i interesuar vetëm të krijojë parakusht për investime në mënyrë jo racionale në ndërtimtari dhe, si duket, krejt problemi është si të futet në dorë sa më shpejtë Pallati i Rinisë dhe aty të hyhet në partneritetin publiko - privat edhe të fillojnë ndërtimet pa leje edhe të ngulfatet edhe kjo pjesë e qytetit. Ky është mendimi im, domethënë më vjen mirë që Ligji po i kthehet Qeverisë dhe parashikimet e mia ishin të sakta. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për replikë është paraqitur Ardian Gjini, por ju kisha lutur, e kemi rekomandimin e komisionit dhe kjo krejt çështjen e Prishtinës. Prandaj, zoti deputet, e ke fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë shkurt, mendoj se është mirë që në fund të fundit zoti Gani Buçinca e ka pranuar që Qeveria e Kosovës nuk po di të bëjë ligje, e ka bërë keq dhe duhet t'i kthehet. Edhe e kam një farë pyetje, me sa duket ia kanë gabuar biografisë zotit Buçinca, se tha jam le jam rritur në Prishtinë, e në biografi shkruan në Zabel të Ulët, komuna e Gllogovcit. Do të ishte mirë të na sqarojë a ia kanë gabuar biografisë, a me të vërtetë është le e rritur në Prishtinë.

KRYESUESI: Për kundër replikë, zoti Buçinca.

GANI BUÇINCA: Dëgjo, zoti Gjini! Nuk thashë që kam lindur dhe jam rritur në Prishtinë, po që nga mosha 14 vjeçare kam jetuar në Prishtinë, një.

E dyta, sa i përket Zabelit tim, e kam shumë për nder dhe është fshati më i bukur në botë. Jam shumë krenar, po të them edhe diçka, domethënë, që ndoshta s'e ke ditur. Babën e kam pasur analfabet, edhe nënën analfabete dhe jam shumë krenarë që jam djalë i dy prindërve që s'kanë ditur shkrim lexim, po më kanë edukuar mua dhe më kanë arsimuar, se mësimet e para i kam marrë në familjen time. Këtë e bëra për shkak të opinionit, kurse me ty nuk dua të hyjë në polemika dhe në debat, se ta kam thanë, nuk dua. Mirëpo, po përfundon mandati. Sikur të ishte mbushur kupa, t'i kisha thënë edhe disa gjëra të tjera, që ti ndoshta nuk e kishe pritur që unë i di për ty.

KRYESUESI: Vazhdojmë me deputetin dhe anëtarin e Kryesisë, Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues, kolegë Gashi!

S'kam as farë interesi që të ngreh fjalë më të egra se polemika, unë po flas në parim duke i njohur rregullat, se ju e dini shumë mirë që edhe kur është paraqitur në Kryesi, është ditur edhe është thënë që ky formulim nuk ecë, po kemi dashur të jemi parlamentarë të vërtetë dhe le të diskutohet këtu.

Edhe njëherë le të merren juristët e Kuvendit, po ju them që ky formulim nuk mund t'i drejtohet Kuvendit kështu dhe Kuvendi s'ka çka merr vendim për te, nën një.

Nën dy, m'u tha, dikush më tha - pse koalicionet e para, le t'i lënë këto përralla e formula, se unë nuk lodhem, koalicioni ky ose ai, s'ka të bëjë me këtë. Ky ligj është obligim kushtetues, Kushtetua e Kosovës është e qershorit, ju e dini cilit vit, s'ka të bëjë me legjislatura të tjera.

E dyta, ju e dini shumë mirë që analiza ose progres raporti që po e quaj evropian, është një prej dy ligjeve sistimore që i ka thënë vjet Kuvendit të Kosovës - je i obliguar ta bësh. Dhe, pikërisht për këto, të gjitha grupet parlamentare u deklaruan këtu, e kanë pranuar draftligjin. Nuk ka kurrfarë arsye Kuvendi të bëjë salto mortale me vetveten rreth këtij ligji. Nuk është në lexim të dytë, vazhdon, kur të vjen në lexim të dytë, e bënë Kuvendi, po në këtë fazë, nëse sponzoruesi s'e tërheq, Kuvendi s'ka kurrfarë arsye në këtë formë të luaj me vetveten dhe kjo është fjalë ime e fundit për këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti!

Diskutuesi i fundit, deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Për fillim, për sqarim do të dua t'i sqaroj disa kolegë deputetë që unë nuk kam qytet tjetër rezervë, as në Gjakovë, as në Prevallë. Unë jam i lindur në Prishtinë dhe i rritur këtu. Që nga fillimi i hartimit të këtij projektligji, unë jetësisht jam interesuar për ecurinë dhe zhvillimin e hartimit të këtij ligji në të gjitha etapat. Ka pasur probleme, sepse grupi i punës i cili është krijuar nga Qeveria, gjegjësisht nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bashkë me komunën e Prishtinës kanë bërë një ligj të dobët dhe pa nevojë është politizuar në mënyrë sistematike ky ligj gjatë procedurës së tij dhe ashtu i dobët ka ardhur dhe është aprovuar në parim në seancën plenare në korrik të këtij viti. Tani komisioni, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme, duke involvuar në proces edhe ekspertë nga kryeqyteti, mbase disa prej tyre të lindur këtu në Prishtinë, të cilët janë të interesuar dhe janë shumë do të thotë të angazhuar që Prishtina ta ketë ligjin e vetë dhe të plotësohet ai obligim kushtetues, të them, sepse është obligim kushtetues që Prishtina ta ketë ligjin, por nuk do të duhet që ne ta aprovojmë një ligj i cili vetëm do ta vulosë kollapsin dhe kaosin e madh që e ka kapluar Prishtinë, veçanërisht vitin e fundit. Në rast se në drejtim të angazhimit të autoriteteve lokale për ta zhvilluar qytetin dhe për të krijuar një rend dhe një rregull në qytet, ne me këtë ligj do të shkonim dhe të bëjmë edhe një kolaps ligjor. Është shumë evidente që ai ligj nuk ka qenë i denjë për qytetin e Prishtinës dhe unë e mbështes rekomandimin e komisionit. Është tjetër procedura, mirëpo ai ligj vërtet nuk është dashur që të procedohet për aprovim në Kuvend, sepse është në kundërshtim me të gjitha standardet e të gjitha ligjeve që i kemi aprovuar deri më tash, pra nuk është edhe i standardizuar. Unë jam jetësisht i interesuar që Prishtina ta ketë ligjin, do të insistoj mbase edhe në mandatin tjetër, qoftë edhe si qytetar, që Prishtina ta ketë ligjin e vet, por jo që të shkojë në kolaps ashtu siç ka shkuar në kolaps këtë vitin e fundit në drejtim të zhvillimit dhe të menaxhimit të qytetit. Prandaj, është për t'u përshëndetur edhe angazhimi i atyre ekspertëve prishtinas, të cilët e kanë parë që pa nevojë ka qenë i politizuar gjatë një viti ky ligj dhe në një farë mënyre është përdorur si instrument shantazhi dhe përmes atij presioni është sjellë i papërgatitur në Kuvend, sikurse që është i panevojshëm edhe sot angazhimi dhe dalja në binë për të bërë fushatë elektorale dhe për të kërkuar, domethënë, që në Prishtinë të ketë mbështetje dikush i cili vërtet në Prishtinë ka ardhur pas lufte ose për herë të parë ka ardhur kur i ka filluar studimet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Duke ju falënderuar të gjithëve për kontribut me diskutimet në këtë pikë, kemi ardhur në momentin që të hedhim në votim Rekomandimin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin e Prishtinës, pra me propozimin që t'i kthehet Qeverisë për ripunim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Në sallë kemi 73 deputetë dhe votojmë tash Rekomandimin e komisionit.

Konstatoj se me 31 vota "për" 25 "kundër" dhe 11 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe media që projektligji për qytetin e Prishtinës t'i kthehet Qeverisë për ripunim. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e fundit të sotme të rendit të ditës.

19. Formimi i Organit të Pavarur Përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me nenin 96.4 të Ligjit për prokurim publik dhe me kërkesën e Kryesisë së Kuvendit ka propozuar 3 gjyqtarë për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Propozimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me emra të 3 anëtarëve u është shpërndarë deputetëve. Nuk kemi të paraqitur, edhe pse mund të deklarohen, por nuk kemi të paraqitur për diskutim.

Atëherë, lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim të Organit Shqyrtues të Prokurimit, dhe votojmë tash:

Në sallë kemi 69 deputetë.

Konstatohet se me 38 vota “për”, 12 “kundër” dhe 8 abstenime, Kuvendi formoi Organin Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit, në këtë përbërje.

1. Shukri Sylejmani, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës,
2. Rasim Rasimi, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, dhe
3. Nehat Idrizi, gjyqtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Duke ju falënderuar për kontributin në seancën e sotme, ju ftoj që nesër në ora 11:00 të mbahet seanca e re e Kuvendit të Kosovës, me rendin e ditës të cilin e keni të bashkangjitur me ftesën. Faleminderit dhe shihemi nesër!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve